

RAPORT VJETOR I AKTIVITETEVE GJYQËSORE TË GJYQTARËVE TË EULEX-IT 2010

Përmbajtja

Parathënie nga Silvio Bonfigli, Shef i Komponentit të Drejtësisë së EULEX-it

Parathënie nga Gjyqtarja Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

Lista e akronimeve

Hyrje

Kapitulli 1: Procedura e përzgjedhjes dhe marrjes së lëndëve sipas Ligjit mbi kompetencat (analiza e vendimeve dhe të dhënave statistikore)

- I. Bazat për përzgjedhjen dhe marrjen e një lënde**
- II. Procedura e përzgjedhjes dhe marrjes së një lënde**
- III. Lëndët e marra në vitin 2010**
 - A. Lëndët penale të marra në vitin 2010**
 - B. Lëndët civile të marra në vitin 2010**

Kapitulli 2: Gjykimi i lëndëve penale (rastet studimore dhe statistikat)

- I. Lëndët e krimeve të luftës**
- II. Korrupsioni, dhe veprat tjera penale që lidhen me krimin e organizuar**
- III. Lëndët e dhunës në familje**
- IV. Lëndët e caktuara të Gjyqtarët e EULEX-it për t'iu shmangur keqpërdorimit të drejtësisë**
 - A. Lëndët që kanë të bëjnë me veprat si duket të motivuara në baza etnike**
 - B. Lëndët që përfshijnë presion politik dhe publik mbi gjyqësorin**
 - C. Lëndët me vrasje**

Kapitulli 3: Gjykimi i lëndëve civile (rastet studimore dhe statistikat)

- I. Kolegji për Ankesa i Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Pronës**
- II. Lëndët që kanë të bëjnë me pronën**
 - A. Lëndët e dëbimit**
 - B. Lëndët e pronësisë**
 - C. Kontratat**
 - D. Lëndët e posedimit**
 - E. Lëndët që përfshijnë presion politik të palës në procedurë ose kërcënimet e marra nga Gjyqësori i Kosovës**

Kapitulli 4: Gjykimi i lëndëve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për lëndët që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (rastet studimore dhe statistikat)

- I. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme: baza ligjore, kompetencat dhe sfidat**
- II. Lëndët e përzgjedhura**

Përfundim: të arriturat dhe sfidat para nesh

Parathënie nga Shefi i Drejtësisë së EULEX-it

Kam kënaqësinë t'ju paraqes Raportin Vjetor të Njesisë së Gjyqtarëve të EULEX-it për vitin 2010. Në kuadër të Komponentit të Drejtësisë së EULEX-it, Njësia e Gjyqtarëve është më e madhja sa i përket stafit dhe më e larmishmja në aspektin e funksioneve. Gjyqtarët e EULEX-it merren me një fushë të gjerë të lëndëve, duke filluar nga kontestet civile mbi të drejtat pronësore civile deri te procedurat penale në lëndët e ndjeshme që kanë të bëjnë me krimet e rënda.

Raporti nënvizon të arriturat e Njesisë së Gjyqtarëve të EULEX-it në kapacitetin e tyre ekzekutiv gjatë vitit 2010. Përveç ndikimit të drejtpërdrejt në jetën e palëve individuale, aktgjykimet dhe vendimet gjyqësore të marra nga Gjyqtarët e EULEX-it japin kontribut pozitiv në avancimin e zbatimit të drejtësisë në Kosovë. Në mënyrë që ky kontribut të jetë i qëndrueshëm nevojitet bashkëpunimi dhe pjesëmarrja e vazhdueshme e gjyqësorit të Kosovës. Përkitazi me këtë, kam kënaqësinë të shoh se është mbajtur një numër i konsiderueshëm i gjykimeve nga kolegjet e përziara të përbëra nga gjyqtarët e EULEX-it dhe gjyqtarët vendorë.

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për punën që është bërë nga Njësia e Gjyqtarëve të EULEX-it nën udhëheqjen e Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Gjyqtares Maria Giuliana Civinini. Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it ka ndihmuar forumet në të cilat Gjyqtarët e EULEX-it dhe Gjyqtarët vendorë janë takuar për t'i diskutuar zgjidhjet për çështjet ligjore dhe menaxhimin e Gjykatave të cilat kanë përfunduar me rezultate të menjëhershme dhe më e rëndësishmja është se kanë ndihmuar sistemin e drejtësisë së Kosovës për ta bërë të besueshëm dhe të vetë-qëndrueshëm.

Silvio Bonfigli
Shef i Drejtësisë
EULEX Kosovë

Parathënie nga Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

Në vitin 2010, gjyqësori i EULEX-it ka gjetur vetën në një pikë kthese. Gjyqësori i Kosovës ka bërë progres të qëndrueshëm në rrugën e tij për të pasur një gjyqësor të paanshëm dhe të pavarur. Prandaj, Gjyqtarët e EULEX-it në mënyrë progresive kanë fuqizuar Gjyqtarët vendorë në vendimmarrje si anëtarë të barabartë në një sistem gjyqësor të integruar, dhe mandatit tonë për monitorim, udhëzim dhe këshillim ka filluar t'i jepet përparësi ndaj funksioneve tona ekzekutive, çdoherë që kjo ishte e mundur. Në të njëjtën kohë, gjyqësori i EULEX-it është konsoliduar dhe ka arritur fazën e pjekurisë në implementimin e mandatit të tij ekzekutiv. Më lejoni ta shtjelloj në hollësi.

Së pari, viti 2010 ka vërë themelin për transformime të mëdha në gjyqësorin e Kosovës. Në korrik të vitit 2010, është miratuar Ligji mbi Gjykatat duke e riorganizuar sistemin gjyqësor dhe duke i përcaktuar të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të gjyqësorit të Kosovës. Për më tepër, në tetor të vitit 2010, ka përfunduar procesi i (ri-) emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve i ndërmarrë nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Ky proces i bazuar në merita, i cili i është përmbajtur rregullores së punës, metodologjisë operationale dhe shqyrtimit të kujdesshëm në pajtim me standardet Evropiane, ka rezultuar në emërimin e më shumë se 300 gjyqtarëve dhe prokurorëve qoftë të emëruar të rinj (mbi 60%) ose të riemëruar nga Kryetari i Kosovës në të gjitha Gjykatat dhe Zyrat e Prokurorëve në tërë Kosovën.

Përfundimi i këtij procesi të gjatë dhe sfidues konfirmon gatishmërinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në angazhimin e plotë dhe të mëtutjeshëm për reforma në këtë fushë. Gjithashtu, është shoqëruar me një vetëbesim dhe siguri të shtuar të Gjyqësorit dhe Prokurorisë së Kosovës që si rezultat ka forcimin e përjetshëm në pajtim me Kushtetutën e Kosovës si dhe me ngritjen e pagave të gjyqtarëve. Këto zhvillime së bashku përforcojnë pavarësinë e gjyqësorit në të dy nivelet atë institucional dhe individual si dhe të sundimit të ligjit.

Momentumi i Gjyqësorit të Kosovës i vetëdijes së ngritur mbi rëndësinë e rolit të tij për një shoqëri dhe shtet të bazuar në sundim të ligjit udhëhiqet nga vizionarët e jashtëzakonshëm të cilët drejtojnë Gjykatën Supreme të Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Institutin Gjyqësor të Kosovës. Ata shoqërohen për së afërmi nga një numër i Kryetarëve të Gjykatave të Qarkut shumë kompetent dhe dinamik të cilët, sipas legjislacionin aktual, janë akoma përgjegjës për përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve për secilin Qark. Këtu duhet nënvizuar një përmirësim të madh: kriteri esencial për transparencë dhe objektivitet është duke u zbatuar. Ky zhvillim pozitiv ka mundësuar një fuqizim progresiv të gjyqësorit vendorë në kompetenca të EULEX-it përmes shfrytëzimit të shtuar të mekanizmit të paraparë me Ligjin mbi kompetencat e EULEX-it sipas të cilit mund të formohen kolegje të përziera nga shumica e Gjyqtarëve të Kosovës apo vetëm nga Gjyqtarët e Kosovës.

Së dyti, prioriteti i misionit për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit reflektohet në mënyrë të qartë në numrin e shtuar të lëndëve në këto fusha të ndërthurura ngushtë. Përderisa mbledhja dhe vlerësimi i provave vazhdon të paraqes vështirësi, të errësuar nga sfidat për mbrojtjen efektive të dëshmitarëve e cila bie nën mandatin ekzekutiv të EULEX-it, kapacitetet tona në lidhje me këtë janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, duke lejuar një veprim dhe funksionim të zgjeruar.

Së treti, përkundër vëmendjes së shtuar që i kushtohet veriut të Kosovës në regjion dhe ndërkombëtarisht, Gjyqtarët e EULEX-it të vendosur në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë vazhdojnë të kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në këtë pjesë. Më e rëndësishmja, ata kanë qenë në gjendje – përkundër rrethanave vazhdimisht të vështira – të merren me lëndët penale të pazgjidhura, ofrojnë drejtësi shumë personave të cilët janë mbajtur në paraburgim për një kohë të konsiderueshme.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, Gjyqtarët e EULEX-it kanë të arritura të rëndësishme në çështjet civile. Të drejtat pronësore, si një fushë me rëndësi të lartë në mjedise pas konfliktit dhe pas socializmit, janë duke u trajtuar gjithnjë e më shumë nga

Gjyqtarët e EULEX-it. Lënda e ashtuquajtur Klubi i Gjahtarëve Drenusha e cila është gjykuar në të dy shkallët nga Gjyqtarët e EULEX-it mund të shërbejë si shembull. Përveç ndjeshmërisë socio-politike, lënda ka qenë edhe juridikisht e ndërlikuar pasi që ka pasur të bëjmë me regjimin kushtetues të pronësisë shoqërore në periudhën para konfliktit, dhe transformimi i mundshëm i saj në pronë komunale apo shtetërore sipas legjislacionit aktual të Kosovës. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me AKM-në gjatë gjithë vitit 2010 është përqendruar në lëndët me rëndësi të lartë shoqërore dhe ekonomike, lënda e ashtuquajtur Ramiz Sadiku, me mbi 1400 ankues të cilët kërkonin që të përfshihen në listën e punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën e 20% të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes. DhPGjS-së më tutje është koncentruar në sqarimin e çështjeve të rëndësishme procedurale si kriteri për pranueshmërinë e kërkesës dhe vendimet gjyqësore preliminare, të cilat do të shërbenin si bazë e fortë për fazën e mëvonshme për lëshimin e aktgjykimeve në bazë të meritave të kërkesave.

Asnjëra nga këto zhvillime pozitive në implementimin e suksesshëm të mandatit të EULEX-it nuk do të ishte e mundur pa dedikimin dhe përkushtimin e gjyqtarëve tanë, zyrtarëve dhe këshilltarëve ligjorë. Prandaj shfrytëzoj rastin që të shpreh falënderime të përzemërta për të gjithë ju.

Maria Giuliana Civinini

Kryetare e Gjyqtarëve të EULEX-it

EULEX Kosovë

Lista e akronimeve

AGJE – Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it

APDhP – Ankesat në pritje në Kolegjin për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të mirëbesimit

KPK – Kodi Penal i Kosovës

KP RSFJ – Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë

LPK – Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

GjQ – Gjykata e Qarkut

GjEDNj – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KEDNj – Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave Themelore të Njeriut

EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

KKPB – Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore

DPB – Drejtoria për çështje Pronësore dhe Banesore

PCN – Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar

TPNJ – Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë

KPPK – Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

KGjK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

PK – Policia e Kosovës

AKP – Agjencia Kosovare e Pronës

KKPK – Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovar

AKM – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

LPP – Ligji mbi Procedurën Penale

Ligji mbi Kompetencat - Ligji mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovës

Ligji mbi PSRK – Ligji mbi Prokurorinë Speciale të Kosovës

GjK – Gjykata Komunale

MUK – monitorim, udhëzim dhe këshillim

GZ – Gazeta Zyrtare

ZPK – Zyra e Presidentit të Kosovës

ZPShK – Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës

PAEJ – Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit

NP – Ndërmarrjet Publike

PTK – Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës

KL – Kërkesë për Largim nga gjykata vendore e paraqitur pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

KSAK – Krahina Socialiste Autonome e Kosovës

GjS – Gjykata Supreme

ADhP – Ankesë kundër vendimit të gjykatës vendore e paraqitur pranë Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

KDhP – Kërkesë e Rregullt e paraqitur pranë Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

K-ShDhP – Kërkesë për Shqyrtimin e një vendimi me anë të kërkesës së rregullt të paraqitur pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

LPDhP – Lista e Lëndëve të Punëtorëve

LDhP – Lënda lidhur me Procedurën e Likuidimin të paraqitur pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

MLDhP – Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë e paraqitur pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

DhPGjS - Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

ZPSK – Zyra e Prokurorit Special të Kosovës

NSh – Ndërmarrje Shoqërore

PSSP – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara

UNMIK – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Hyrje

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet punën e gjyqtarëve të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (tani e tutje EULEX) në përmbushjen e funksioneve të tyre ekzekutive në gjykatat e Kosovës gjatë vitit 2010. Raporti ka për qëllim që të ofroj një pasqyrë vetëm të funksioneve ekzekutive/gjyqësore të Gjyqtarëve të EULEX-it në gjykatat e Kosovës. Raporti nuk e mbulon punën e gjyqtarëve të EULEX-it në monitorim, udhëzim dhe këshillim (tani e tuje MUK).

Gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë funksionet gjyqësore në pajtim me Ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (tani e tuje Ligji mbi kompetencat).¹ Ligji mbi kompetencat i siguron gjyqtarëve të EULEX-it kompetenca primare/ekskluzive dhe sekondare/subsidiare mbi një numër të veprave penale të cilat përfshijnë; terrorizmin; krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës; krim të organizuar; vrasje dhe vrasje të rënda; krimet ekonomike dhe financiare. Sipas nenit 3, paragrafit 1 të Ligjit mbi kompetencat, gjyqtarët e EULEX-it kanë kompetenca primare/ekskluzive mbi cilëndo vepër penale e cila hetohet ose ndiqet nga Zyra e Prokurorit Special të Kosovës (tani e tutje PSRK). Në rrethana të jashtëzakonshme, gjyqtarët e EULEX-it gjithashtu mund të marrin përgjegjësi dhe të ushtrojnë kompetencat sekondare/subsidiare mbi veprat penale të cilat hetohen dhe ndiqen nga Prokuroritë Komunale dhe të Qarkut.

Kapitulli mbi Ushtrimin e autorizimeve të Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it sipas Ligjit mbi kompetencat ofron hollësi lidhur me procedurën e përzgjedhjes dhe marrjes së lëndëve nën kompetencat sekondare/subsidiare të gjyqtarëve të EULEX-it. Procedura dhe kushtet për marrjen e lëndëve të ndjeshme dhe/ose

¹ Ligji Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, i datës 13 mars 2008. Ligji është në dispozicion përmes ueb faqes së EULEX-it: <http://www.eulex-kosovo.eu/training/?id=13>

komplekse, qoftë penale ose civile, janë përcaktuar në Ligjin mbi kompetencat. Zbatimi i këtyre dispozitave gjatë vitit 2010 kanë qar në evoluimin e procedurës, duke i marrë parasysh rrethanat e veçanta (p.sh. në veri të Kosovës) dhe situatën aktuale në gjykata e Kosovës në drejtim të përmbushjes së mandatit të Misionit për qëndrueshmëri dhe llogaridhënie të gjyqësorit të Kosovës. Në lidhje me këtë, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it (tani e tutje KAGjE) shpeshherë e shfrytëzon mekanizmin e përcaktuar në Ligjin mbi kompetencat për ta shtuar përfshirjen e gjyqtarëve të Kosovës në lëndët të cilat trajtohen nga gjyqtarët e EULEX-it.

Kapitulli mbi Veprat Penale përqendrohet në procedurat e përzgjedhura penale të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2010 nga gjyqtarët e EULEX-it. Këto lëndë janë përzgjedhur sipas disa kriterëve si lidhshmëria me prioritetet e Misionit të EULEX-it sipas mandatit të tij për vitin 2010 dhe vlerat e përparësisë ose rëndësia udhëzuese e arsytimit në kuptim të interpretimit të dispozitave ligjore materiale ose procedurale. Pjesët përkatëse të këtij Kapitulli përmbajnë përshkrimin e 4 (katër) lëndëve të krimeve të luftës, 11 (njëmbëdhjetë) lëndëve të korrupsionit, krimit të organizuar dhe veprave që lidhen me krimin e organizuar, 2 (dy) procedura penale që lidhen me dhunën në familje, 1 (një) lëndë penale të motivuar në baza etnike, 2 (dy) lëndë të procedurave penale ku është ushtruar një sasi e konsiderueshme e presionit publik dhe politik mbi gjyqësorin dhe 4 (katër) lëndëve me vrasje.

Përveç kësaj, gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë kompetencat e tyre mbi lëndët civile. Sipas nenit 5, paragrafit 1 të Ligjit mbi kompetencat, gjyqtarët e EULEX-it kanë: kompetenca primare mbi lëndët që janë në kompetencë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjS) për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (tani e tutje AKM); kompetenca ekskluzive mbi lëndët që janë në kompetencë të cilësdo gjykate në Kosovës lidhur me ankesat kundër vendimeve të Komisionit Kosovar për Kërkesa Pronësore (tani e tutje KKKP); dhe autorizime për të përzgjedhur cilëndo lëndë të re apo të pazgjidhur civile që ka të bëjë me pronën. Në nivelin e Qarkut dhe atë Komunal, gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë vetëm kompetencat sekondare/subsidiare në fushën e Ligjit civil dhe nuk kanë kompetenca primare/ekskluzive që lidhen me lëndët

penale. Prandaj, në fushën civile puna kryhet kryesisht në formën e MUK-ut dhe jo përmes gjykimit të lëndëve; si rrjedhojë, numri i lëndëve civile me të cilat janë marrë gjyqtarët e EULEX-it në mënyrë të konsiderueshme është më i vogël sesa numri i lëndëve penale. Aktualisht, gjyqtarët civil të EULEX-it ia përkushtojnë përafërsisht 10% të kohës së tyre mandatit ekzekutiv. Koha e mbetur i përkushtohet MUK-ut. Në pjesën e gjykimit të lëndëve civile, raporti përmbledh lëndët civile me të cilat janë marrë gjyqtarët civil të EULEX-it gjatë vitit 2010, gjykimi i të cilave përfshinë çështje ligjore të ndjeshme dhe komplekse. Përmbledhja e lëndëve ofron historikun faktik të lëndës; arsyetimin e marrjes së lëndës nga gjyqtarët e EULEX-it si dhe rezultatit e procedurës.

Kapitulli i 4-të i raportit përqendrohet në kompetencat e DhPGjS-së. DhPGjS-ja fillimisht është themeluar nga Administrata e Përkohshme e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (tani e tutje UNMIK) Rregullorja 2002/13² për të siguruar mekanizëm të kontrollit të fortë, pavarur dhe të paanshëm për procesin e privatizimit në Kosovë, të kryer nga AKM-ja. Në fillim të vitit 2009 është ri-dizajnuar dhe zgjeruar në masë të madhe, për përfshirjen e gjyqtarëve të EULEX-it. Raporti përshkruan bazën ligjore të mandatit të DhPGj-së dhe ofron një përmbledhje të lëndëve relevante të cilat bien nën kompetencat e DhPGjS-së.

Përfundimi i Raportit Vjetor paraqitet nën Kapitullin VII dhe vlerëson të arriturat e deritashme, dhe sfidat e mbetura. Në vitin 2010, trashëgimia e UNMIK-ut ka përfunduar në nivelin e Gjykatës Supreme (GjS-së). Përparim i rëndësishëm është arritur në këtë aspekt në nivelin e Gjykatave të Qarkut. Gjyqtarët e EULEX-it i kanë dhënë prioritet gjykimeve të lëndëve që kanë përfshirë akuza të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Është bërë punë shtesë për ta zvogëluar numrin e lëndëve penale të pazgjidhura, posaçërisht lëndët të cilat kanë përfshirë paraburgime të zgjatura. Vëmendje e veçantë i është kushtuar gjykimit të drejtë të lëndëve kundër të miturve.

² Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, e datës 13 qershor 2002

Njësia e Gjyqtarëve të EULEX-it – personeli dhe vendosja në Gjykatat e Kosovës

Gjyqtarët e EULEX-it përfaqësojnë pjesën integrale të Komponentit të Drejtësisë së EULEX-it. Gjyqtarët e EULEX-it janë ose shtetas të shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian ose të Shteteve të Treta Kontribuuese (Norvegjisë, Zvicrës, Turqisë, Kroacisë, SHBA-së dhe Kanadasë), dhe veprojnë si gjyqtarë në cilësinë e tyre nacionale. Për shkak të natyrës së veçantë të funksioneve të tyre, gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë funksionet ekzekutive në pajtim me Ligjin mbi kompetencat.

Aktualisht, në Gjykatat në tërë Kosovën janë të vendosur 39 (tridhjetë e nëntë) gjyqtarë të EULEX-it dhe 27 (njëzet e shtatë) zyrtarë ligjor të EULEX-it. Përveç tyre, ka edhe këshilltarë ligjorë vendorë, asistentë administrativë/përkthyes dhe interpret/përkthyes. Përkrahja e stafit vendorë është e domosdoshme për ushtrimin efikas të funksioneve gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it. KAGjE-së është Kryesuese e Njesisë së Gjyqtarëve.

Shpërndarja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe zyrtarëve ligjorë është si në vijim:

- 5 (pesë) gjyqtarë të GjS-së, përfshirë KAGjE-së;
- 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarë penale në nivelin e Gjykatave të Qarkut (GjQ);
- 9 (nëntë) gjyqtarë civil në nivelin e GjQ-së;
- 6 (gjashtë) gjyqtarë të shkallës së parë në DhPGjS-së, dhe
- 3 (tre) gjyqtarë të apelit në DhPGjS;
- 15 (pesëmbëdhjetë) zyrtarë ligjorë në nivelin e GjQ-së;
- 5 (pesë) zyrtarë ligjorë në nivelin e GjS-së;
- 1 (një) zyrtar ligjor për ankesat e Agjencisë Kosovare të Pronës (tani e tutje AKP)
- 6 (gjashtë) zyrtarë ligjorë në DhPGjS.

Gjyqtarët e EULEX-it i kryejnë detyrat e tyre në tërë Kosovën. Ekipet e Gjyqtarëve të EULEX-it janë të vendosur në të gjitha pesë GjQ-të.

GjQ Prishtinë – 6 (gjashtë) gjyqtarë penal dhe 2 (dy) gjyqtarë civil të ndihmuar nga 5 (pesë) zyrtarë ligjor dhe 3 (tre) këshilltarë ligjorë vendorë;

GjQ Gjilan – 2 (dy) gjyqtarë penal dhe 1 (një) gjyqtar civil të ndihmuar nga 3 (tre) zyrtarë ligjor dhe 1 (një) asistent ligjor vendor;

GjQ Pejë – 3 (tre) gjyqtarë penale dhe 2 (dy) gjyqtarë civil të ndihmuar nga 2 (dy) zyrtarë ligjorë dhe 2 (dy) këshilltarë ligjorë vendorë;

GjQ Prizren– 1 (një) gjyqtarë penale dhe 2 (dy) gjyqtarë civil të ndihmuar nga 2 (dy) zyrtarë ligjorë, 2 (dy) këshilltarë ligjorë vendorë dhe 1 (një) asistent ligjorë vendorë;

GjQ Mitrovicë – 4 (katër) gjyqtarë penal dhe 2 (dy) gjyqtarë civil të ndihmuar nga 3 (tre) zyrtarë ligjorë, 2 (dy) këshilltarë ligjorë vendorë.

Kapitulli 1: Procedura e përzgjedhjes dhe marrjes së lëndëve sipas Ligjit mbi kompetencat (analiza e vendimeve dhe të dhënave statistikore)

Gjyqtarët e EULEX-it i ushtrojnë funksionet e tyre gjyqësore sipas Ligjit mbi kompetencat. Ligji rregullon *inter alia* kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në bazë të kriterit objektiv dhe të parapërcaktuar, autorizimet e KAGjE-së dhe prerogativat e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it (tani e tutje AGjE).³ Këto dispozita ia mundësojnë palëve në procedurë që të përcaktojnë *gjyqtarin kompetent* në lëndën e dhënë, p.sh. gjyqtari i cili është caktuar në lëndë, sipas ligjit dhe rregullave të tij mbi kompetencat. Ky ligj lexohet në lidhje me Ligjin mbi themelimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës (Ligji mbi PSRK)⁴ i cili i siguron kompetenca kësaj Zyre që të ndjek dhe hetojë krimet e rënda.

³ Shih nenet 2 dhe fol. Për kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it; neni 4.10 i Ligjit mbi kompetencat për Asamblesë e Gjyqtarëve të EULEX-it

⁴ Ligji Nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, të datës 13 mars 2008.

Duhet bërë një dallim në mes të kompetencave primare/ekskluzive dhe subsidiare/sekondare të gjyqtarëve të EULEX-it në lëndët penale. Lënda nën kompetenca primare automatikisht bie nën kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it sipas dispozitave të ligjit, kurse për një lëndë nën kompetencat sekondare, duhet të merret një vendim nëse lënda do të merret nga gjyqtarët e EULEX-it, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

- Kompetencat ekskluzive të gjyqtarëve të EULEX-it janë paraparë për lëndët që bien nën kompetencat primare të PSRK-së.⁵ Këto lëndë të listuara në nenin 9 të Ligjit për PSRK-në konsiderohen si krime të rënda, p.sh. terrorizmi, gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës, krimi i organizuar etj. Përveç kësaj, të gjitha lëndët e hetuara nën kompetencat sekondare të PSRK-së bien nën kompetencat primare të gjyqtarëve të EULEX-it.
- Nëse një lëndë nuk hetohet ose ndiqet nga PSRK-ja, gjyqtarët e EULEX-it mund t'i ushtrojnë kompetencat e tyre sekondare. KAGjE-së ka kompetenca për një numër të kufizuar të lëndëve që të caktojë gjyqtarë të EULEX-it në faza përkatëse të procedurës penale (procedura për marrjen e lëndës).

Kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në lëndët civile, të caktuar në Gjykata të rregullta përcaktohen në nenin 5 të Ligjit mbi kompetencat. Kushtet për përzgjedhjen e një lënde civile përmenden në nenin 5, paragrafin 1 , c) të Ligjit. Marrja e lëndës nga gjyqësori i Kosovës të gjyqtarët e EULEX-it mund të konsiderohet si përjashtim nga parimi fundamental i *gjyqtarit kompetent* siç është përcaktuar me Ligj. Në të vërtetë, gjykimi i gjyqtarit të EULEX-it i një lënde e cila tanimë i është caktuar një Gjyqtari tjetër apo ka qenë në pritje të caktimit të një Gjyqtar, përjashtohet nga rregullat fundamentale mbi kompetencat. Prandaj, kushtet për marrjen e lëndës rregullohen në mënyrë strikte në Ligjin mbi kompetencat.

⁵ Article 3 of the Law on Jurisdiction

I. Bazat për përzgjedhjen dhe marrjen e një lënde

Gjykimi i një lënde nga gjyqtarët e EULEX-it mund të jetë i domosdoshëm për të siguruar një procedurë të drejtë dhe të paanshme e cila nuk mund të garantohet nëse gjyqësori i Kosovës merret me lëndën.

Bazat për marrjen e një lënde penale

Për marrjen e një lënde penale parashihen dy situata në Ligjin mbi kompetencat: nëse ekziston nevoja për të siguruar zbatimin e duhur të drejtësisë dhe nëse ekziston dyshimi se lënda ka të bëjë me krim të motivuar në baza etnike.

Nevoja për siguruar administrimin e duhur të drejtësisë sipas nenit 3, paragrafit 3 të Ligjit mbi kompetencat

Neni 3, paragrafi 3 përcakton një listë të veprave penale të cilat mund të bien nën kompetencat sekondare të gjyqtarëve të EULEX-it “kur konsiderohet e domosdoshme që të sigurohet administrimi i duhur i drejtësisë”. Nevoja për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë shtjellohet në nenin 3, paragrafin 5 të Ligjit:

- nëse ka pasur kërcënime ndaj gjyqtarit kosovar, dëshmitarëve apo palëve në procedurë lidhur me lëndën, dhe kjo në mënyrë të arsyeshme bën të besohet se do të ketë keqpërdorim të drejtësisë në rast se lënda mbahet në kompetenca ekskluzive të gjyqtarit kosovar”; apo
- “nëse është e arsyeshme të besohet se aktiviteti i gjyqtarit të EULEX-it, për shkak të kompleksitetit apo natyrës së veçantë të lëndës, është i nevojshëm për të shmangur keqpërdorimin e drejtësisë”.

Dyshimi për krimet e motivuara në baza etnike sipas nenit 3, paragrafit 4 të Ligjit mbi kompetencat

Gjyqtarët e EULEX-it mund t'i ushtrojnë kompetencat e tyre sekondare në lëndët të cilat kanë indikacione të elementeve të motivimit në baza etnike; me fjalë të tjera “kur viktimat, objektet apo objektet e veprës penale duket të jetë përzgjedhur për shkak të lidhjes, bashkimit, afërsisë, mbështetjes apo anëtarësisë së tyre të vërtetë apo të perceptuar me një grup të vërtetë apo të perceptuar të identifikuar sipas racës, origjinës kombëtare, etnike apo shoqërore, afërsisë me ndonjë minoritet kombëtar apo grup politik, gjuhës, ngjyrës, besimit, gjinisë, moshës, të metave fizike apo mentale, orientimit seksual, apo faktorëve tjerë të ngjashëm”.

Bazat për marrjen e një lënde civile

Kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatat e rregullta mbi çështjet civile janë paraparë në nenin 5 të Ligjit mbi kompetencat. Neni 5, paragrafi 1, pika c) përcakton kompetenca të kufizuara për gjyqtarët e EULEX-it në procedura të rregullta civile për çdo lëndë të re apo të pazgjidhur civile që ka të bëjë me pronën, përfshirë këtu ekzekutimin e procedurave që janë në kompetenca të cilësdo gjykate në Kosovë, nëse

- i) ekziston dyshimi i bazuar i përpjekjeve për të ndikuar në paanësinë apo pavarësinë e gjyqësorit vendor; apo
- ii) ekziston dyshimi i bazuar se gjyqësori vendor nuk është i gatshëm apo është i paaftë që ta shqyrtojë lëndën siç duhet; apo
- iii) ekziston dyshimi i bazuar në shkeljen serioze të zhvillimit të drejtë të procedurës.

IV. Procedura e përzgjedhjes dhe marrjes së një lënde

Përzgjedhja dhe marrja e një lënde penale në nivelin e gjykatës komunale, të qarkut apo supreme vendoset para fillimit të fazës përkatëse të procedurës (hetimeve, procedurës paraprake, konfirmimit, gjykimit, ankesës). Inicohet në bazë të kërkesës nga Prokurori i EULEX-it i caktuar në lëndë (apo duke punuar me një ekip të përzier me Prokurorë vendorë) apo të cilësdo palë në procedurë apo me kërkesë me shkrim nga Kryetari i

Gjykatës kompetente. Parimet e transparencës, objektivitetit dhe efikasitetit shërbejnë si udhërrëfyes gjatë procedurës për marrjen e lëndës.

Zyra e KAGjE-së ka lëshuar Procedurat Standarde Operative (PSO) në janar të vitit 2009 të cilat ofrojnë hollësi lidhur me procedurën e marrjes së një lënde penale (plotësimi i kërkesës etj.). Duke e marrë parasysh ndjeshmërinë e fazës së procedurës paraprake në një lëndë penale, PSO janë ndryshuar pak në tetor të vitit 2010 në procedurën e marrjes së lëndës në këtë fazë.

Sipas nenit 3, paragrafit 6 të Ligjit, Gjyqtari i Kosovës i cili përndryshe do të caktohej në lëndë, Kryetari i Gjykatës kompetente dhe palët në procedurë në lëndë kanë të drejtë të dëgjohen nga KAGjE-së. Në këtë mënyrë palët mund të dorëzojnë një mendim me shkrim te KAGjE-së nëse lënda duhet të merret apo jo. Sidoqoftë, e drejta për tu dëgjuar është interpretuar në kuptim të gjerë dhe shqyrtimi zakonisht mbahet për t'iu dhënë të drejtën palëve dhe Gjyqtarëve të Kosovës që ta paraqesin mendimin e tyre. Shqyrtimi mbahet nga KAGjE-së në seancë të mbyllur për shkak të natyrës së ndejshme ose fazës së hershme të procedurës e cila mund të parandalojë çfarëdo zbulimi të informatave konfidenciale në publik. Pas shqyrtimit KAGjE-së lëshon një aktvendim të bazuar. Ai i bashkëngjitet shkresave të lëndës dhe i komunikohet personave të ftuar në shqyrtim. Kundër këtij aktvendimi nuk ka mundësi ankese.⁶ Ky aktvendim është i vlefshëm gjatë tërë procedurës penale përveç nëse më pas paraqitet një kërkesë për dorëzimin e lëndës te Gjyqtarët e Kosovës.

Edhe pse mbajtja e shqyrtimit për marrjen e lëndës është rregull, ekzistojnë rrethana të veçanta në instanca të caktuara në të cilat nuk kërkohet shqyrtimi: kur palët kanë shprehur mendimin me shkrim; kur lënda është në fazën e hershme të hetimeve dhe kur Kryetari i Gjykatës tanimë ka shprehur mendimin e tij/saj; kur kërkesa është në mënyrë të qartë e papranueshme pasi që nuk bie nën kompetencat e Gjyqtarëve të EULEX-it. 35 (tridhjetepesë) kërkesa për transferimin e lëndëve penale janë refuzuar/hedhur poshtë pa

⁶ Neni 3, paragrafi 6 i Ligjit mbi kompetencat

shqyrtim , kryesisht për shkak të mungesës së kompetencave të Gjyqtarëve të EULEX-it ose mungesës së bazave të mjaftueshme.

Procedura e marrjes së një lënde civile ndryshon varësisht nëse lënda është e “re” ose në “pritje”.⁷ Gjyqtari i EULEX-it vlerëson nëse lënda e re i plotëson kushtet sipas nenit 5, paragrafit 1 të Ligjit dhe lëshon një aktvendim për përzgjedhjen dhe marrjen e lëndës. Në këtë të fundit, lënda “në pritje”, mbahet një shqyrtim nga KAGjE-së, ose të deleguarit të saj,⁸ dhe lëshohet një vendim i formës së prerë.

Përbërja e kolegjeve të caktuara në lëndët e marra

Sipas ligjit, kolegjet në të cilat Gjyqtarët e EULEX-it i ushtrojnë kompetencat e tyre kanë përbërje të përzier me shumicën e Gjyqtarëve të EULEX-it dhe me Kryetar të kolegjit nga EULEX-i.⁹ Përbërja e kolegjit bëhet në bazë të secilës lëndë pas vlerësimit të plotë të shkresave të lëndës dhe të rrethanave të saj.

Megjithatë, neni 3, paragrafi 7 i Ligjit mbi kompetencat ia mundëson KAGjE-së që të bëjë përjashtime nga ky rregull duke vendosur që për arsye të bazuara kolegji në një lëndë penale mund të përbëhet nga shumica e Gjyqtarëve të Kosovës. KAGjE-së gjithashtu mund të vendos që kolegjet të përbëhen tërësisht nga Gjyqtarët e Kosovës ose mos të caktojë Gjyqtarë të EULEX-it në një fazë të caktuar të procedurës penale. Kohëve të fundit ky mekanizëm është shfrytëzuar më shpesh dhe janë disa instanca në të cilat kolegjet e përziera janë përbërë nga shumica e Gjyqtarëve vendorë e jo Gjyqtarëve të EULEX-it.¹⁰ Në mënyrë që edhe më tutje të ndihmohet procesi i angazhimit të Gjyqtarëve të Kosovës në kolegje të përziera, KAGjE-së ka lëshuar një vendim në korrik

⁷ Lënda është e re kur të regjistrohët mirëpo nuk i është caktuar Gjyqtarit të Kosovës. Lënda e regjistruar dhe e caktuar është në pritje.

⁸ Neni 3, paragrafi 14 i Udhëzimeve për Përzgjedhjen e e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it në lëndë civile të datës 10 korrik 2008

⁹ Shih neni 3, paragrafin 7 të Ligjit mbi kompetencat

¹⁰ Tendencë për një përfshirje më aktive të Gjyqtarëve të Kosovës në gjykimin e krimeve të rënda është veçanti e dukshme në nivelin e Gjykatës Supreme në mbi 56 (pesëdhjetegjashtë) lëndë penale të trajtuara nga Gjyqtarët e EULEX-it që nga janari i vitit 2009, kolegjet kanë qenë të përbëra nga shumica e Gjyqtarëve vendorë kurse kanë qenë të kryesuara nga Gjyqtarët e EULEX-it.

të vitit 2010 mbi procedurat e përbërjes dhe caktimit të kolegjeve. Konsiderohet se përfshirja graduale e Gjyqtarëve të Kosovës në kolegje kontribuon në forcimin e kapaciteteve dhe ligjshmërisë së gjyqësorit, dhe promovon inkorporimin e praktikave më të mira Evropiane në sistemin gjyqësor të Kosovës.

Përfundimisht, KAGjE-së ka miratuar Udhëzimet për Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it në lëndët civile dhe penale më 10 korrik 2008, dhe në nivelin e Gjykatës Supreme më 23 tetor 2008, siç parashihet me Ligjin mbi kompetencat.¹¹ Këto udhëzime përfshijnë parimet fundamentale të caktimit të Gjyqtarëve të EULEX-it dhe sistemit për caktimin e lëndëve. Ato janë ndryshuar në vitin 2010 duke e marrë parasysh gjendjen aktuale dhe vëllimin e punëve të gjykatave. Këto Udhëzime janë publike dhe i mundësojnë secilës palë në procedurë që të kenë qasje në rregullat e aplikueshme për caktimin e lëndës një Gjyqtari të EULEX-it.

II. Lëndët e marra gjatë vitit 2010

A. Lëndët penale të marra gjatë vitit 2010

Gjatë vitit 2010, nga KAGjE-së në fushën penale janë mbajtur 53 (pesëdhjetet) shqyrtime për marrje të lëndëve (29 (njëzetënëntë) në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë). Pas shqyrtimit, janë miratuar 43 (dyzetet) kërkesa për marrjen e lëndëve penale. Kërkesat e tjera janë refuzuar ose tërhequr nga Prokurori. Një kërkesë është shtyrë për shkak të njoftimit të pasuksesshëm të palëve.

Krahasimi i lëndëve penale dhe civile të marra në mes të viteve 2009 dhe 2010

Gjykatat	Gjykata e Qarkut Prishtinë	Gjykata e Qarkut Mitrovicë	Gjykata e Qarkut Pejë	Gjykata e Qarkut Prizren	Gjykata e Qarkut Gjilan	Gjykata Supreme e Kosovës

¹¹ Udhëzimet për Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it në Lëndë Penale në Gjykatat e Qarkut të datës 10 korrik 2008; Udhëzimet për Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it në Lëndë Civile në Gjykatat e Qarkut të datës 10 korrik 2008; Udhëzimet për Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it në Lëndë Penale në Gjykatën Supreme të Kosovës të datës 23 tetor 2008, të ndryshuar më 1 qershor 2010, udhëzimet janë në dispozicion në ueb faqen e EULEX-it <http://www.eulex-kosovo.eu/en/justice/assembly-of-the-eulex-judges.php>

Vitet	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010
Lëndët penale të marra	14	3	19	25	8	11	4	6	1	0	3	2
Lëndët civile të marra	6	21	0	0	21	6	0	4	3	2	0	0

- 1) Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë: ka pasur një rritje në marrjen e lëndëve civile dhe zvogëlim të lëndëve penale 3 (tre) lëndë penale dhe 21 (njëzetënjë) lëndë civile) gjatë vitit 2010 në krahasim me 14 (katërbëdhjetë) lëndë penale dhe 6 (gjashtë) lëndë civile të marra gjatë vitit 2009. Kjo rënie ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të lëndëve penale nën kompetencat ekskluzive të Gjyqtarëve të EULEX-it dhe zgjerimit të aktiviteteve të monitorimit.
- 2) Në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë: numri i lëndëve të përzgjedhura është ngritur në vitin 2010 (25 (njëzetepesë) lëndë) në krahasim me 19 (nëntëmbëdhjetë) lëndë gjatë vitit 2009. Nuk është marrë asnjë lëndë civile për shkak të rrethanave specifike të cilat mbizotërojnë në regjionin e Mitrovicës. Gjykimi i lëndëve të rënda penale nga Gjyqtarët e EULEX-it është rritur që nga viti i kaluar për shkak të nevojës për të siguruar administrimin e drejtësisë në veri të Kosovës dhe mungesës së Gjyqtarëve shqiptarë dhe serb të Kosovës për të marrë pjesë në kolegje në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Për më tepër, ekipi i EULEX-it është vendosur në Gjykatën në Mitrovicë dhe është përforcuar me punëtorë shtesë.
- 3) Gjykata e Qarkut në Pejë: ka pasur një rritje të lehtë të numrit të lëndëve penale të marra gjatë vitit 2010 (11 (njëmbëdhjetë) lëndë penale) në krahasim me vitin 2009 (8 (tetë) lëndë penale). Numri i lëndëve civile të marra gjatë vitit 2010 nga (6 (gjashtë) lëndë) është zvogëluar në krahasim me 21 (njëzetënjë) lëndë civile të marra gjatë vitit 2009. Gjatë vitit 2010 një Gjyqtarët civil të EULEX-it janë përfshirë në gjykimin e lëndëve penale për shkak të mungesës së numrit të Gjyqtarëve penale të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Pejë.
- 4) Në Gjykatën e Qarkut në Prizren: numri lëndëve civile dhe penale është rritur gjatë vitit 2010 (6 (gjashtë) lëndë penale dhe 4 (katër) lëndë civile) përderisa vetëm 3 (tre) lëndë penale janë marrë gjatë vitit 2009. Rritja e numrit të lëndëve

- penale gjatë vitit 2010 është si arsytim i marrjes së lëndëve të cilat përfshijnë anëtarë të gjyqësorit të Kosovës në regjionin e Prishtinës.¹²
- 5) Gjykata e Qarkut në Gjilan: nuk ka pasur kërkesa për marrjen e lëndëve penale; vetëm 2 (dy) lëndë penale janë marrë në vitin 2010, krahasuar me 3 (tri) lëndë penale dhe 1 (një) penale në vitin 2009. Gjyqtarët e EULEX-it janë të angazhuar në mënyrë aktive në aktivitetet monitoruese ndërsa gjyqtarët e EULEX-it nga gjykata e qarkut në Gjilan po ashtu merren me lëndët e procedurës paraprake në regjionin e Prishtinës
 - 6) Gjykata Supreme e Kosovës: 2 (dy) lëndë penale janë marrë gjatë vitit 2010, ndërsa gjatë vitit 2009 ishin përzgjedhur dhe ishin marrë gjithsej tri (3) lëndë penale nga gjyqtarët e EULEX-it.

Shumica e lëndëve penale të marra gjatë vitit 2010 ishin nën kompetencën e gjykatës së qarkut të Mitrovicës. Pjesa më e madhe e këtyre lëndëve (16 lëndë) kishin të bënin me vepra të rënda penale. Nevoja për të garantuar gjykim të drejtë dhe të paanshëm për të akuzuarit si dhe për të siguruar zbatimin e drejtësisë është themelore gjatë vendosjes për marrjen e lëndëve. Këto janë parime mbështeten në atë se cilat lëndë penale u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it në veriun e Kosovës ku pengohet funksionimi normal i sistemit gjyqësor nga situata komplekse politike si dhe nga pezullimi i procesit të re-integrimit të gjyqtarëve kosovarë në gjykatën e qarkut të Mitrovicës. Nën këto rrethana një numër i lëndëve është gjykuar nga gjyqtarët e EULEX-it në Mitrovicë për t'i ikur shkeljes së të drejtave të të pandehurit për shkak të zgjatjes së procedurës penale ose për shkak të vazhdimit të padrejtë të paraburgimit. Pjesa më e madhe e këtyre lëndëve të marra kanë të bëjnë me raste serioze si vrasje, vrasje në tentativë, trafikim të qenieve njerëzore dhe vepra tjera penale të ndjeshme siç janë lëndët me dhunë familjare.

¹² Shih nenin 13, paragrafin 2 të Ligjit mbi kompetencat. Veprat penale që supozohet të jenë kryer nga anëtarët e gjyqësorit vendor apo nga të punësuarit e gjykatave të ndryshme në Kosovë do të hetohen, ndiqen dhe gjykohen nga një prokurori dhe nga një gjykatë që ushtron kompetenca dhe juridiksion në një rajon të ndryshëm nga ai ku gjyqtari, prokurori apo i punësuarit ushtrorjnë zakonisht funksionet e tyre. Prandaj, nëse krimi i supozuar ka ndodhur në regjionin e Prishtinës ose të Gjilanit, prokuroria dhe gjykata kompetente do të identifikohen në prokurorinë komunale ose të qarkut dhe në gjykatën komunale ose të qarkut në Prizren.

Për shembull rasti i të pandehurit B. Z. i cili pohohet të ketë tentuar t’ia marrë jetën gruas së vet në vitin 2008 duke e goditur në kokë dhe në fytyrë si dhe duke ia lidhur një litar rreth qafës. Kryetarja e Asamblesë mori vendimin që ta marrë lëndën në fjalë duke pasur parasysh vështirësitë për zbatimin e drejtësisë në pjesën veriore të Kosovës si dhe shkeljet e mundshme të të drejtave të të pandehurit dhe të viktimës. Po ashtu bëhej fjalë për një lëndë të rënde penale të dhunës familjare si dhe për mbajtje të gjatë të të pandehurit në paraburgim (nga shtatori 2008).

Gjyqtarët e EULEX-it janë marrë edhe me lëndën e vrasjes A.D. (gjuajtje me pushkë automatike dhe vrasje në tentativë të kushëririt të viktimës) duke u bazuar në faktin se i pandehuri ishte në paraburgim qe tre vjet dhe lënda e tij ishte duke pritur për një kohë të gjatë (shqyrtimi gjyqësor që kishte filluar në shkurt 2008 më vonë ishte ndërprerë). Arsye tjetër ishte edhe të shmangej mundësia e keqpërdorimit të drejtësisë nëse nuk merrej lënda në fjalë.

Në lëndën me gjuajtje Y.K. është marrë parasysh aspekti i dhunshëm i krimit të kryer si dhe periudha e gjatë e mbajtjes në paraburgim të të pandehurit (që nga tetori 2007). Pas konfirmimit të aktakuzës në dhjetor 2009, nuk ishte caktuar fare shqyrtimi gjyqësor dhe një situatë e tillë do të mund to çonte tek një keqpërdorim serioz i drejtësisë.

Një tjetër kategori e lëndëve të marra nga gjyqtarët e EULEX-it janë *lëndët e korrupsionit*,¹³ në veçanti ato të cilat përfshijnë gjyqësorin e Kosovës. Pak raste janë marrë që kanë të bëjnë me veprën penale të Nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore sipas Nenit 346 të Kodit Penal të Kosovës (tash e tutje KPK)¹⁴. Në këto raste me qëllim të parandalimit të procedurës së padrejtë dhe të shkeljes së parimit të

¹³ Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it ka miratuar një listë të veprave penale të cilat mund të futen në kategorinë e ‘rasteve të korrupsionit’ gjatë Asamblesë së 12-të të mbajtur më 23 shtator 2010. Kjo listë fut veprat penale nën Kapitullin XXII: veprat penale kundër ekonomisë (Nenet 235-238; Nenet 249-251); Kapitullin XXIII: vepra penale kundër pasurisë (Neni 261); XXVII: veprat penale kundër administrimit të drejtësisë (Nenet 309-311); Kapitulli XXVIII: veprat penale kundër rendit publik dhe veprimeve juridike (Neni 316; Nenet 332-334); Kapitulli XXIX: veprat penale kundër detyrës zyrtare (Nenet 339-351)

¹⁴ Neni 346 i KPK-së: “Gjykatësi, gjykatësi laik ose gjykatësi për kundërvajtje i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër ose për t’i shkaktuar dëm personit tjetër nxjerr vendim të kundërligjshëm dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.”

paanshmërisë së gjyqtarëve në rastet kur bëhej fjalë për një anëtar të gjyqësorit kosovar nga një regjion i caktuar, ajo lëndë gjykohej nga gjykata e regjionit tjetër.¹⁵

Në lëndën M. S. I pandehuri në cilësinë e gjyqtarit përmbarues në gjykatën komunal ishte akuzuar se kishte nxjerrë vendim gjyqësor në mënyrë të kundërligjshme lidhur me një kontest civil. Kjo lëndë është marrë duke pasur parasysh faktin që vepra penale sipas nenit 346 të KPK-së ka një ndikim të fuqishëm në pavarësinë e gjyqësorit të Kosovës dhe në perceptimin e tij nga qytetarët kosovarë. Pastaj bëhej fjalë edhe për një lëndë komplekse pronësore.

Lënda tjetër që ka të bëjë me veprën penale të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimit gjyqësor e cila ka tërhequr vëmendjen e gjyqtarëve të EULEX-it ishte lënda e R.B. Kjo lëndë kishte të bënte me pohimet e nxjerrjes së kundërligjshme të vendimit gjyqësor nga ana e një gjyqtari të gjykatës komunale të Prishtinës. Sipas aktakuzës, i pandehuri kishte nxjerrë vendimin në fjalë në vitin 2005 duke dëmtuar një palë gjatë kontestit civil në procedurën e trashëgimisë. Në maj 2010, avokati mbrojtës kishte paraqitur kërkesë për marrjen e lëndës. Pasi që gjykimi i një lënde të tillë mund të kishte efekt të drejtpërdrejtë mbi reputacionin e gjyqtarit dhe pavarësinë e tij apo të saj si dhe perceptimin e gjyqësorit dhe publikut kosovar, lënda ishte përzgjedhur në muajin korrik të vitit 2010.

B. Lëndët civile të marra gjatë vitit 2010

Gjatë këtij viti, pra 2010, janë mbajtur 2 (dy) shqyrtime nga Kryetarja e Asamblesë. Të tjera shqyrtime janë mbajtur nga të deleguarit e saj që ka çuar tek marrja e mbi 32 lëndëve. 18 kërkesa për marrjen e lëndëve civile janë hedhur poshtë ose refuzuar, kryesisht për shkak të faktit se këto kërkesa nuk ishin brenda mandatit të gjyqtarëve të EULEX-it ose ishin të pabaza. Numri i përgjithshëm i lëndëve civile të marra gjatë vitit 2010:¹⁶

- 1) Gjykata e qarkut në Prishtinë: 21 lëndë të marra lëndë të marra ;

¹⁵ Neni 13, para 2 i Ligjit mbi kompetencat (i cituar më lart)

¹⁶ Asnjë lëndë civile nuk është marrë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë dhe as në Gjykatën Supreme të Kosovës gjatë vitit 2010.

- 2) Gjykata e qarkut në Pejë: 6 lëndë të marra ;
- 3) Gjykata e qarkut në Prizren: 4 lëndë të marra ;
- 4) Gjykata e qarkut në Gjiilan: 2 lëndë të marra .

Në Gjykatën e qarkut në Gjiilan, gjyqtarët e EULEX-it kanë marrë një lëndë që lidhet me kërkesën për konfirmimin e pronësisë të paraqitur nga Agjencia Kosovare për Privatizim (AKP) kundër komunës së Vitisë. Kjo lëndë ka të bëjë me çështjet e ndarjes së kompetencave në mes të gjykatave të rregullta të Kosovës dhe të DhPGjS-së. Gjykatat kosovare zakonisht nuk e konsiderojnë veten kompetentë për shqyrtimin e lëndëve në të cilat janë të përfshira Ndërmarrjet Shoqërore (NSh), të cilat janë nën kompetencën ekskluzive të Dhomës së Posaçme. Për më tepër, komuna e Vitisë nuk është e treguar e gatshme për zbatimin e vendimeve gjyqësore të nxjerra nga gjyqësori kosovar.¹⁷

Në gusht të vitit 2010, kryetari i gjykatës komunale të Deçanit ka kërkuar nga gjyqtarët e EULEX-it të marrin një lëndë të kompensimit të dëmeve (për shkatërrimin e pronës) kundër Manastirit të Deçanit. Pasi që kjo çështje është kontest pronësor që përfshinte palë të përkatësisë së ndryshme etnike, lënda në fjalë është marrë nga gjyqtarët e EULEX-it.

Po ashtu, gjyqtarët e EULEX-it marrë përsipër nga Gjykata Komunale e Glllogocit edhe 18 raste në të cilat si palë e paditur ka qenë komuna e Glllogocit, ndërsa paditës pronarët individualë të dyqaneve, dyqanet e të cilëve ishin rrëzuar nga komuna pas procedurave të gjata administrative. Gjyqtarët e EULEX-it kishin konsideruar se këto lëndë nuk ishin administruar në mënyrë të duhur si dhe presioni politik i ushtruar nga komuna mbi gjyqësorin vendor ka dëmtuar procesin e gjykimit të drejtë të këtyre.¹⁸

¹⁷ Shih referencën përkatëse në Kapitullin 3: Gjykimi i lëndëve civile (rastet e studiuara dhe statistika), lënda C. Nr. 328/09 Komuna e Vitisë kundër AKP-së, Gjykata Komunale në Viti (regjioni i Gjiilanit)

¹⁸ Shih referencën përkatëse Kapitulli 3: Gjykimi i lëndëve civile (rastet e studiuara dhe statistika), lënda C. Nr. 302/07 dhe të tjerët, pronarët e dyqaneve kundër Komunës së Glllogocit, Gjykata Komunale e Glllogocit (regjioni i Prishtinës)

Kapitulli 2: Gjykimi i lëndëve penale (rastet e studiuara dhe statistika)¹⁹

Ky kapitull paraqet procedurën penale të gjykimeve nën patronazhin e gjyqtarëve të EULEX-it. Sa i përket bazës ligjore dhe hollësive procedurale të përzgjedhjes dhe caktimit të lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it, kjo është trajtuar në Kapitullin 1: Procedura e përzgjedhjes dhe caktimit të lëndëve sipas Ligjit mbi kompetencat (analizë e vendimeve dhe të dhënave statistikore). Arsyet për përzgjedhjen dhe caktimin e këtyre lëndëve janë të shpjeguara në fillim të diskutimit për secilën lëndë.

Ky kapitull është i përbërë në një mënyrë tematike në nivelin e parë. Lëndët caktohen në bazë të procedurave të ndryshme, të cilat kanë qenë në vëmendjen e posaçme të komponentit të drejtësisë së EULEX-it gjatë vitit 2010. Procedurat ndahen në nënkategori sipas gjykatës që është kompetente, ashtu që lëndët klasifikohen sipas rendit kronologjik në bazë të datës së vendimit.²⁰ Përjashtim nga kjo rregull është pjesa e fundit, e cila përfshin kategori të ndryshme të procedurës. Pjesa më e madhe e kësaj procedure u është caktuar gjyqtarëve të EULEX-it për shkak të shqetësimeve se gjyqësori kosovar nuk do t'i gjykonte në mënyrë të drejtë, të pavarur dhe të paanshme. Bëhet fjalë për raste të vrasjes të cilat kishin natyrë komplekse ligjore dhe faktike të cilat janë marrë nga gjyqtarët e EULEX-it me qëllim të përkrahjes së gjyqësorit vendor dhe të rasteve të marra me qëllim të shmangies së shtyrjeve të papërcaktuara në administrimin e drejtësisë. Procedura kundër të pandehurve të njëjtë për të njëjtat vepra penale, të cilët janë gjykuar në instanca të ndryshme gjatë kësaj periudhe raportuese, janë paraqitur si raste të veçanta. Megjithatë, ata gjithnjë paraqiten së bashku në mënyrë të njëpasnjëshme duke filluar nga procedura në shkallën më të ulët.

Përveç funksioneve gjyqësore ekzekutive të gjyqtarëve të EULEX-it, mandati i tyre po ashtu përfshin edhe aktivitete të MUK-ut në raport me homologët e tyre vendorë. Shumë shpesh, nuk mund të bëhet një dallim i qartë në mes të funksionit ekzekutiv dhe

¹⁹ Aktgjykimet dhe aktvendimet e nxjerra për këto lëndë mund të gjenden në faqen e internetit të EULEX-it: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/judgments/index.php>

²⁰ Procedurat gjyqësore në Gjykatat Komunale janë të përfshira në nën-pjesë në bazë të fushës së kompetencave të Gjykatave përkatëse të qarkut.

aktiviteteve të MUK-ut, pasi që shpesh të dyja këto ndodhin në të njëjtën kohë gjatë punës me kolegje të përziera.

Sipas ligjit procedural në fuqi, përkatësisht Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), respektivisht Nenit 20 të tij, par. 1, lëndët gjykohen në gjykatat komunale, ato të qarkut dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Një lëndë gjykohet në shkallën e gjykatës komunale nga një gjyqtar i vetëm ose nga një trup gjykues që përbëhet nga një gjyqtar dhe nga dy gjyqtarë porotë, nëse vepra penale në fjalë është e dënueshme me gjobë ose me burgim deri në 5 (pesë) vjet.²¹ Gjykata e qarkut është kompetente për dëgjimin e ankesave kundër aktgjykimeve të nxjerra nga gjykata komunale. Trupi gjykues i kësaj shkalle përbëhet ose nga 3 (tre) ose nga 5 (pesë) gjyqtarë.

Gjykata Supreme si shkalla më e lartë në procedurën penale është kompetente për të vendosur për 1) ankesat kundër vendimit të gjykatës së qarkut si gjykatë e shkallës së parë, 2) për ankesat kundër aktgjykimit të shkallës së dytë dhe 3) për mjetet e jashtëzakonshëm juridike. Kapitulli XXXIX i kodit procedural përmend këto lloje të mjeteve të jashtëzakonshme juridike: Rishikimin e procedurës penale, Zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.²²

Disa statistika mbi gjykimet e lëndëve penale për vitin 2009 dhe 2010

²¹ Për lëndët me të cilat merren gjyqtarët e EULEX-it, kolegjet përbëhen vetëm me gjyqtarë profesionistë pa përfshirje të gjyqtarëve porotë. Shih gjithashtu rastin Pkl-Kzz 119/09 Mehmet Morina, aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 20 janar 2010, Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, faqet 3 dhe 4.

²² Shih Nenin 451 të KPPK-së lidhur me Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë: kërkesë kjo e cila mund të paraqitet nga Prokurori publik i Kosovës, nga i pandehuri apo avokati i tij mbrojtës për shkak të këtyre arsyeve: 1) Në rast të shkeljes së ligjit penal; 2) Në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 403, paragrafi 1 i këtij Kodi ose 3) Në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Gjykata Supreme mund ta ndryshojë ose ta anulojë aktgjykimin e shkallës së parë apo të dytë ose ta refuzojë kërkesën.

Numri i lëndëve penale në fazën e shqyrtimit gjyqësor në shkallën e gjykatës së qarkut

Gjykatat	2009	2010
Gj.Q. Gjilan	1	4
Gj.Q. Mitrovicë	21	34
Gj.Q. Pejë	9	17
Gj.Q. Prishtinë	23	30
Gj.Q. Prizren	12	8
Gjithsej:	66	93

Numri i aktgjyqimeve të nxjerra në lëndët penale në gjykatat komunale, në gjykatat e qarkut si dhe në Gjykatën Supreme sipas gjykatave

Gjykatat	2009	2010
Gjykata Supreme	27	24
Gj.Q. Gjilan	1	1
Gj.Q. Mitrovicë	4	27
Gj.Q. Pejë	7	12
Gj.Q. Prishtinë	10	15
Gj.Q. Prizren	6	8
Gjithsej:	56	87

Numri i aktgjyqimeve të nxjerra në lëndët penale në gjykatat komunale, në gjykatat e qarkut si dhe në Gjykatën Supreme sipas veprave penale

Vepra penale	2009	2010
Krime të luftës	10	4
Terrorizëm	2	0
Korrupsion	1	15
Të tjera (Vrasje, Vjedhje, Dhunim, Lëndim trupor, TQNj)	39	68
Gjithsej	56	87

I. Lëndët me krime të luftës

Lënda P nr. 285/10 Vukmir Cvertković, Gjykata e qarkut në Pejë

Lloji i procedurës:	Aktgjykim i shkallës së parë
Data:	9 nëntor 2010
Vepra penale:	Krime lufte kundër popullsisë civile, sipas neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (tash e tutje KP të RSFJ-së)
Epilogu:	Dënimi

Këto procedura lidhen me lëndën e krime të luftës kundër popullsisë civile, të kryera gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë, në mars të vitit 1999 në regjionin e Pejës.

I pandehuri është akuzuar se duke vepruar së bashku me anëtarët e policisë serbe dhe duke qenë edhe vetë i uniformuar, kishte dëbuar një familje shqiptare kosovare nga shtëpia e tyre dhe ua kishte vënë zjarrin së paku edhe dy shtëpive tjera prona të shqiptarëve në Klinë në fund të marsit të vitit 1999.

Pas një letërrreshtimi ndërkombëtar, i pandehuri, pas ekstradimit nga Norvegjia u arrestua në Kosovë më 13 korrik 2010. Aktakuza e paraqitur nga PSRK-ja në muajin shtator 2010 u konfirmua të njëjtin muaj. Aktakuza mbështetej kryesisht në deklaratat e dëshmitarëve të cilët e raportuan të pandehurin në njësinë e policisë për krime të luftës, kur në vitin 2005 ishte kthyer në Klinë dhe ishte bërë pjesëtar i Policisë së Kosovës (PK). Shqyrtimi gjyqësor filloi më 26 tetor 2010 dhe shumë pak dëshmitarë u dëgjuan si dhe u bë inspektimi i vendit të krimit në Klinë. Përveç kësaj, gjykata shqyrtoi me kujdes materialet e kësaj lënde, fotot e shtëpive të djegura dhe inspektimin e vendit të ngjarjes, raportet e policisë dhe deklaratën e dëshmitarit. I pandehuri, duke pranuar se ishte i uniformuar si polic rezervist gjatë asaj kohe, kishte mohuar akuzat e bëra kundër tij.

Më 9 nëntor 2010, trupi gjykues i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar kosovar konstatoi se i pandehuri në fjalë duke pasur të veshur uniformën e forcave serbe dhe i pajisur me një pushkë automatike AK-47, të njëjtën ia kishte drejtuar një viktime dhe e kishte urdhëruar viktimën dhe familjen e tij të shkojnë për Shqipëri. Po ashtu kishte konstatuar se i pandehuri së bashku me forcat tjera serbe kishte marrë pjesë në operacionin e organizuar ushtarak për dëbimin e popullsisë shqiptare kosovare nga Klina duke ua vënë zjarrin së paku dy shtëpive.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike duke pasur parasysh besueshmërinë e dëshmitarëve, kohën që kishte kaluar (10 vjet) në mes të ngjarjes dhe dëshmisë së tyre në gjykatë, dhe kishte marrë parasysh kohën që kishte kaluar në mes të dëshmive të mëhershme të dëshmitarëve si dhe dëshmisë së tyre në gjykatë dhe përfundimisht kishte vlerësuar se këto dëshmi përputheshin dhe ishin të besueshme. Gjykata ka marrë parasysh si rrethanë rënduese faktin që i pandehuri kishte kryer dy vepra penale të krimeve të luftës, d.m.th. ua kishte vënë zjarrin dy shtëpive dhe kishte dëbuar një familje nga shtëpia e tyre. Duke vepruar kështu, ai kishte shkaktuar rrezik serioz për tërë lagjen. Trupi gjykues e shpalli të pandehurin fajtor për Krime të luftës kundër popullsisë civile (sipas neneve 22 dhe 142 të KP të RSFJ-së) duke e dënuar të njëjtin me shtatë (7) vjet burgim.

Lënda Pkl.-Kzz 117/2009, Selim Krasniqi, Gjykata Supreme

Lloji i procedurës:	Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë
Data:	12 tetor 2010
Vepra penale:	I dënuar për Krime të luftës, trajtim çnjerëzor dhe shkaktim të vuajtjeve të mëdha ose rrezikim i shëndetit trupor të të burgosurve civilë duke zbatuar masat e frikësimit dhe terrorit në kundërshtim me Nenin 142 të KP të RSFJ-së, lidhur me Nenet 22, 26 dhe 30 të KP të RSFJ-së
Epilogu:	Është refuzuar si e pabazë

Procedura ka të bëjë me lëndën e krimeve të rënda kundër popullsisë civile. I pandehuri ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë edhe kundër aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, të datës 10 gusht 2006²³ edhe kundër aktgjykimit të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 10 prill 2009.²⁴

I pandehuri (së bashku me dy të bashkakuzuarit e tjerë) është dënuar në shkallën e dytë për veprën penale të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile me gjashtë (6) vjet burgim.

²³ Gjykata e qarkut në Prizren, Lënda P. Nr. 85/2005, 10 gusht 2006

²⁴ Gjykata Supreme e Kosovës, Lënda Ap.-Kž. Nr. 371/2008, 10 prill 2009

Në vendimin e gjykatës konstatohet se aktgjykimet nuk ishin mbështetur në dëshmi të papranueshme, siç pohohet nga mbrojtja. Në raport me interpretimin e Nenit 153, par. 1 të KPPK-së, gjykata ka gjetur se kjo dispozitë kërkonte interpretim shumë të saktë sipas formulimit duke konstatuar se KPPK nuk përmbante asnjë dispozitë mbi papranueshmërinë e deklaratës së dëshmitarit vetëm për shkakun se dëshmitari nuk ka marrë udhëzime të duhura juridike siç përcaktohet me ligj (Neni 164, par. 2 i KPPK-së). Sa i përket pretendimit se dispozitivi i aktgjykimit të formës së prerë ka qenë i pakuptueshëm apo në mospërputhje me arsyetimin e aktgjykimit, gjykata konstaton se nuk ka ekzistuar një pasaktësi e tillë në asnjërin prej aktgjykimeve të lëshuara nga instancat e mëhershme. Ajo ka sqaruar se sipas Nenit 451, par. 2 i KPPK-së “Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike [...]”, një kërkesë e tillë nuk mund të shpie tek detyrimi i Gjykatës Supreme për t’i rivlerësuar provat dhe faktet. Rrjedhimisht, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është refuzuar si e pabazë.

Lënda Pkl-Kzz 27/2010 Gani Gashi, Gjykata Supreme

Lloji i procedurës:	Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë
Data:	6 gusht 2010
Vepra penale:	I dënuar për Krime të luftës, vrasje, tentim vrasje dhe cenim i integritetit trupor ose i shëndetit sipas Nenit 142 të KP të RSFJ-së
Epilogu:	Është refuzuar si e pabazë

Lënda ka të bëjë me vepra të rënda penale të kryera gjatë konfliktit në Kosovë. Ka qenë kjo lënda e parë për krime të luftës e gjykuar nga gjyqtarët e EULEX-it. Avokati mbrojtës ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës si dhe kundër aktgjykimit të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme të Kosovës.

I pandehuri ishte akuzuar se në korrik të vitit 1998 si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) i caktuar si rojë në pikën e kontrollit afër Komoranit në pjesën qendrore të Kosovës, me qëllim ka vrarë dhe ka tentuar të vrasë dy civilë si dhe ka cenuar

integritetin trupor dhe shëndetin e dy të tjerëve. Viktimat kanë qenë të gjithë anëtarë të së njëjtës familje.

Më 3 mars 2009, gjykata e shkallës së parë ka shpallur fajtor të pandehurin për krime të luftës kundër popullsisë civile, duke shkelur Nenin 142 të KP të RSFJ-së, lidhur me Konventën e Gjenevës së vitit 1949 dhe me Nenin 4 të Protokollit shtesë të Konventave të Gjenevës, duke e dënuar me 15 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe duke ndryshuar disa aspekte formale të aktgjykimit.

Më 6 gusht 2010, kolegji i përbërë prej pesë gjyqtarëve të Gjykatës Supreme ka refuzuar kërkesën, duke konstatuar se si dispozitivi i shkallës së parë ashtu edhe ai i shkallës së dytë janë plotësisht të kuptueshëm, të qëndrueshëm dhe të bazuar dhe se nuk ka mospajtime në mes të dispozitivit dhe arsyetimit.

Sa i përket mospërputhjeve lidhur me disa çështje faktike, *mes tjerash* lidhur me kohën e saktë të kryerjes së vrasjes së viktimës e cila nuk është përcaktuar; pastaj se aktgjykimi tregon se viktima ishte qëlluar në shpinë ndërsa të gjitha provat flasin se ai ishte qëlluar në qaftë; dhe se viktima e tretë ishte lënduar nga një pjesë e vogël e xhamit të dritares së pasme dhe jo nga plumbi i shkrepur nga i pandehuri. Sa i përket pikës së fundit, gjykata ka konstatuar se i pandehuri mbahet penalisht përgjegjës për secilën pasojë të të shtënave të tij, duke përfshirë këtu edhe lëndimet e shkaktuara nga xhami i dritares së pasme e cila ishte thyer si pasojë e gjuajtjes së të pandehurit.

Gjykata Supreme ka konstatuar se të gjitha këto arsye tashmë janë ngritur nga avokati mbrojtës në ankesën e tij dhe për pjesën më të madhe të tyre janë dhënë përgjigjet në shkallën e parë dhe atë mënyrë shumë të qartë dhe të kuptueshme, duke konstatuar se këto mospërputhje të pretenduara janë vlerësuar në mënyrë të drejtë si nga shkalla e parë ashtu edhe nga ajo e dytë. Siç është thënë nga avokati mbrojtës, gjykata ka gjetur një mospërputhje në mes të aktgjykimeve në shqip dhe në anglisht, ku në shqip thuhet “të shtënat” e cila është forma në shumës e të shtënave, përderisa në anglisht thuhet “këto të shtëna”, duke konstatuar se në këtë rast përparësi ka versioni në anglisht i aktgjykimit.

Kërkesa është refuzuar si e pabazë.

Lënda Ap-Kz 108/2010 Idriz Gashi, Gjykata Supreme²⁵

Lloji i procedurës:	Aktgjykim kundër shkallës së parë
Data:	25 nëntor 2010
Vepra penale:	Krime të luftës kundër popullsisë civile, në kundërshtim me Nenin 142 të KP të RSFJ-së
Epilogu:	Është refuzuar si e pabazë

Procedura në këtë lëndë ka filluar në vitin 2007 nën patronazhin e UNMIK-ut dhe kishte të bënte me vepra të rënda penale kundër popullsisë civile.

I pandehuri akuzohej se më 12 gusht 1998 në rrethinën e fshatit Vranoc të komunës së Pejës, në fshatin Baran kishte ndaluar një femër e cila po udhëtonte në drejtim të Pejës dhe e kishte sjellë atë para pjesëtarëve të UÇK-së për marrje në pyetje, pas së cilës viktima ishte shoqëruar nga i pandehuri dhe një tjetër pjesëtar i UÇK-së në një pjesë të pyllit të njohur me emrin “Lugu I Isufit”, pranë fshatit Vranoc, komuna e Pejës, ku i pandehuri e kishte vrarë viktimën e cila perceptohej si bashkëpunëtore e serbëve.

Më 22 qershor 2007, gjykata e shkallës së parë e përbërë nga gjyqtarët e UNMIK-ut dhe ata kosovarë kanë shpallur të pandehurin fajtor për krime të luftës kundër popullsisë civile dhe e kanë dënuar me 15 vjet burgim. Lënda më vonë është bartur në EULEX. Më 2 qershor 2009, kolegji prej pesë gjyqtarësh të Gjykatës Supreme pjesërisht ka pranuar ankesën e të pandehurit, duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të rregullave procedurale duke pranuar dëshminë e njërit dëshmitar pa ndjekur fare formalitetet ligjore të përcaktuara për të ashtuquajturit dëshmitarë bashkëpunëtorë. Si rezultat i kësaj, lënda i është kthyer prapa për rigjykim gjykatës së shkallë së parë.

²⁵ Shih Raportin vjetor mbi aktivitetet gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it për 2009, faqet 12-13

Rigjykimi ka filluar në tetor 2009 në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Prokuroria ishte e përfaqësuar nga PSRK-ja. Më 19 nëntor 2009, Gjykata e qarkut të Pejës ka shpallur aktgjykimin me të cilin i pandehuri shpallej fajtor për Krime të luftës kundër popullsisë civile duke e dënuar atë me 14 vjet burgim.

Më 25 nëntor 2010, pas mbajtjes së seancës së hapur, Gjykata Supreme ka lëshuar aktgjykimin mbi refuzimin e ankesës si të pabazë dhe mbi vërtetimin e aktgjykimit të shkallës së parë, duke konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk përmbante asnjë shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe se gjendja faktike ishte konstatuar në mënyrë të drejtë nga trupi ri-gjykues dhe se shkalla e parë kishte konstatuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësinë e të pandehurit.

Sa i përket arsyes së të pandehurit lidhur me pranimin e dëshmive nga dëshmitari bashkëpunues nga ana e shkallës së parë, gjykata e apelit ka konstatuar duke pasur parasysh gjetjet e Gjykatës Supreme gjatë procedurës së parë të apelit, se përderisa trupi ri-gjykues ka vendosur të mos pranojë dëshmitë e dy dëshmitarëve, dëshmitë e tjera nuk i ka deklaruar të papranueshme prandaj të njëjtat mund të përdoren si prova. Përveç kësaj, gjykata ka konstatuar se dispozitivi përbën pjesën themelore të aktgjykimit dhe se ky dispozitiv i shkallës së parë përmban të gjitha të dhënat e nevojshme ashtu siç përcaktohet me kombinimin e Neneve 396, par. 4 dhe Nenit 391, par. 1 të KPPK-së. Po ashtu ajo refuzuar konstatimin se Gjykata e qarkut kishte vlerësuar gabimisht gjendjen faktike. Pra në atë instancë ishin plotësuar të gjitha kushtet që vrasja e viktimës të cilësohej si krim i luftës kundër popullsisë civile.

Gjykata Supreme më tej ka konstatuar se aktgjykimi i shkallës së parë një pjesë të madhe ia kushton vlerësimin të provave, duke përfshirë këtu edhe besueshmërinë e provave kundërthënëse, veçanërisht kur bëhet fjalë për disa dëshmi të dëshmitarëve (pjesë të caktuara të të cilave janë konsideruar si të pabesueshme). Ajo ka konstatuar se vlerësimi i provave është bërë në mënyrë të kujdesshme, transparente dhe bindëse në përputhje me procedurat e përcaktuara. Sa i përket dënimit, gjykata ka vërtetuar arsyetimin e gjykatës

së shkallës së parë se dispozitat ligjore të KP të RSFJ-së kanë qenë më të favorshme për të pandehurin prandaj edhe janë aplikuar gjatë caktimit të dënimit.

II. Veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe me krimin e organizuar

Lënda Pkl-Kzz 114/2009 Leme Xhema, Gjykata Supreme

Lloji i procedurës:	Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë
Data:	12 prill 2010
Vepra penale:	E dënuar për Lidhje të kontratës së dëmshme, Neni 109, par. 1 dhe 2 i Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (tash e tutje LPK)
Epilogu:	E refuzuar si e pabazë

Procedura ka të bëjë me një lëndë të krimit ekonomik që i ka shkaktuar dëm të madh financiar njëres prej kompanive më të mëdha publike në Kosovë. Aktgjykimi në fjalë ka të bëjë me kërkesën e të pandehurës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të shkallës së parë dhe të dytë. Nga aspekti ligjor vendimi diskuton çështjen e kushteve ligjore për dispozitivin e aktgjykimeve.

Sipas këtyre akuzave, e pandehura në shkurt 2003 në pozitën e saj si Drejtore e përgjithshme e ndërmarrjes publike të PTK-së ka iniciuar dhe ka autorizuar pagesën e një shume prej 300,000 eurosh për Kompaninë kosovare Norway Invest, gjoja se si pagesë për shërbime të ofruara PTK-së gjatë instalimit të rrjetit digjital të njohur si TETRA. Ajo ka bërë një gjë të tillë pa miratimin e AKM-së dhe duke e ditur se PTK-ja nuk kishte ndonjë detyrim kontraktues apo detyrim tjetër për të paguar këtë shumë dhe duke e ditur se kompania që i ka marrë mjetet në fjalë në të vërtetë nuk i kishte ofruar shërbimet e përshkruara në faturë.

Aktakuza kundër Leme Xhemës dhe të bashkakuzaarit të saj në fillim ishte paraqitur më 2 nëntor 2006 dhe pastaj ishte konfirmuar më 14 qershor 2007. Së pari lënda ishte nën kompetencat e UNMIK-ut. Aktgjykimi i shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës është shpallur më 9 maj 2008 dhe Leme Xhema është shpallur fajtores për veprën penale të Shpërdorimit të detyrës zyrtare ose autorizimit në bashkëkryerje si dhe

Lidhje të kontratës së dëmshme duke u dënuar me një dënim unik prej 4 (katër) vjet burgim.

Lënda iu bart EULEX-it më 2 janar 2009. Gjykata Supreme më 22 qershor 2009 pjesërisht ka miratuar ankesën dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke e dënuar atë vetëm për veprën penale të Lidhjes së kontratës së dëmshme pasi që kjo veprë penale përfshin edhe karakteristikat e Shpërdorimit të detyrës zyrtare ose autorizimit, duke e dënuar me 3 (tre) vjet burgim.

Gjykata duhet të vlerësonte nëse dispozitivit i mungonin elementet kryesore. Aktgjykimi deklaroi se dispozitivi është një pjesë përbërëse e aktgjyimit dhe duhet të lexohet së bashku me arsyetimin. Duke u bazuar në parimin ekonomik gjyqësor, një veprë duhet të interpretohet ashtu që të ketë kuptim në mënyrë që të shmanget përsëritja e panevojshme dhe procedurat sipërfaqësore gjyqësore. Kjo sqaron që arsyet për një vendim të caktuar nuk ka nevojë të jepen në dispozitiv por në arsyetim. Në esencë, gjykata ka konstatuar se faktet në dispozitiv duhet të lexohen së bashku me arsyetimin dhe se këta dy dispozitivë të aktgjyqimeve të instancave të mëparshme i plotësojnë kushtet ligjore.

Gjykata po ashtu ka diskutuar problemin e provave dhe pohimin e të pandehurës se kërkesa e saj për prova shtesë nuk është marrë parasysh, duke konstatuar se të gjitha faktet e nevojshme tashmë ishin dëshmuar, prandaj nuk kishte nevojë për prova shtesë. Rrjedhimisht, gjykata ka refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazë.

Lënda Pkl-Kzz 103/2009 Bedri Krasniqi (1), Xhevat Danqa (2), Agim Hasani (3),

Gjykata Supreme

Lloji i procedurës:	Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë
Data:	22 prill 2010
Vepra penale:	Të pandehurit (1) dhe (2) të dënuar për Shpërdorim të pozitës zyrtare në bashkëkryerje, Neni 339, par. 2 dhe 23 i KPK-së; i pandehuri (3) i dënuar për Falsifikim të dokumenteve zyrtare, Neni 348, par. 1 i KPK-së
Epilogu:	Është pranuar pjesërisht, ndërsa aktgjykimi kundër të pandehurve (1) dhe (2) është anuluar dhe është kthyer prapa

	në Gjykatën Komunale të Prizrenit, ndërsa aktgjykimi kundër të pandehurit (3) është konfirmuar
--	--

Kjo lëndë është paraqitur nga shkakku se ka të bëjë me keqpërdorimin e drejtësisë dhe përfshin si të pandehur një gjyqtar dhe një prokuror publik. Aktgjykimi vendos për dy kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të shkallës së parë dhe të dytë të Gjykatës Komunale të Prizrenit, të dorëzuara në emër të të pandehurve (1) dhe (2).

Të pandehurit janë një gjyqtar, një prokuror publik dhe një korrier i gjykatës, të gjithë të dënuar se në shtator 2007 së bashku kanë manipuluar me një aktakuzë penale në atë mënyrë duke i hequr fillimisht dy personat e akuzuar nga ndjekja dhe duke ua mohuar palëve të dëmtuara të drejtën e ndjekjes penale kundër dy të akuzuarve si prokurorë subsidiarë.

Gjykata e shkallës së parë kishte dënuar të pandehurit me 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj burgim. Gjykata e shkallës së dytë kishte vërtetuar dënimet. Gjyqtarët e EULEX-it e kanë marrë lëndën vetëm kur ka ardhur në Gjykatën Supreme pas kërkesë së avokatit mbrojtës të të pandehurit (1).

Gjykata ka konstatuar se nuk kishte dëshmi që i pandehuri (1) në mënyrë specifike kishte si qëllim të përfitonte dobi të kundërligjshme pasurore për veten ose për ndonjë person tjetër ose të kishte si qëllim t'i shkaktonte dëm një personi tjetër, siç përcaktohet me Nenin 339, par. 1 i KPK-së, duke bërë të ditur se as shkalla e parë as ajo e dyta nuk kishte diskutuar parimin *mens rea* për të pandehurit (1) dhe (2). Sa i përket të pandehurit (3), gjykata ka konstatuar se nuk kishte shkelje esenciale të procedurës penale as të ligjit penal. Prandaj, gjykata në raport me të pandehurin (1) ka anuluar aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë dhe ka kthyer lëndën prapa për rigjykim në Gjykatën komunale të Prizrenit. Sipas Nenit 455, par. 2 të KPPK-së, edhe pse ai nuk kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, gjykata kishte anuluar edhe aktgjykimet për të pandehurin

(2) për të njëjtat arsye që ekzistonin në dobi të tij, ndërsa ka konfirmuar vendimet kundër të pandehurit (3).²⁶

Rigjykimi në këtë lëndë ka filluar më 13 dhjetor 2010. Më 15 dhjetor 2010, gjykata sipas Nenit 390, par. 3 të KPPK-së, ka shfajësuar të pandehurit (1) dhe (2) për veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit sipas Nenit 339, par. 2, lidhur me Nenin 23 të KPK-së. Ajo ka konstatuar se nuk kishte prova për të mbështetur dyshimet e bazuara se të pandehurit (1) dhe (2) në mënyrë specifike dëshironin të përfitonin dobi të kundërligjshme pasurore për vete ose për të tjerët apo se kishin si qëllim t'i shkaktonin dëm ndonjë personi tjetër siç përcaktohet me Nenin 339 të KPK-së.

Më tej ka theksuar se është e pamundshme të një aktakuzë që ka të njëjtën datë të jetë juridikisht e ligjshme në dy versione të ndryshme dhe se Prokurori nuk ka pasur të drejtë ta ndryshojë përmbajtjen ligjore të aktakuzës së mëhershme duke e larguar një pjesë të saj dhe duke e arkivuar atë me të njëjtën datë dhe me të njëjtin numër të lëndës drejtpërdrejt tek gjyqtari. Gjykata komunale në këtë mënyrë ka shpallur fajtor të pandehurin (2) për veprën penale të Falsifikimit të dokumenteve zyrtare sipas Nenit 348, par. 2 të KPK-së dhe e ka dënuar të njëjtin me dënim me kusht prej 3 (tre) muajsh burgim.

Lënda P. No. 504/2007 “Lënda Kasabank” Jahja Lluka (1), Milazim Abazi (2) dhe Hashim Sejdiu (3), Gjykata e qarkut në Prishtinë

Lloji i procedurës:	Shkalla e parë
Data:	12 shkurt 2010
Vepra penale:	I pandehuri (1): i akuzuar me 2 pika të Dëshmisë apo lajmërimit të rrejshëm, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/2, ²⁷ Neni 10.5, par. (a) dhe (b) dhe Pranim i kundërligjshëm i parave, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/2, Neni 10.8
Epilogu:	

²⁶ Më 15 dhjetor 2010, është mbajtur rigjykimi para gjyqtarit të EULEX-it të Gjykatës Komunale në Prizren. Gjykata ka shfajësuar të dy të pandehurit nga akuzat për Shpërdorim të pozitës ose autorizimit dhe ka dënuar të pandehurin e dytë për Falsifikimin të dokumenteve zyrtare (Neni 348, para 2 i KPPK-së), duke i shqiptuar dënim me kusht prej 3 muajsh burgim me një periudhë verifikuese prej një (1) viti.

²⁷ Rregullorja e UNMIK-ut mbi pengimin e larjes së parave dhe veprave të ngjashme penale, e datës 5 shkurt 2004, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/53, të datës 8 nëntor 2006.

	<p>Të pandehurit (2) dhe (3): të dy të akuzuar për moslajmërim të transaksioneve në bashkëkryerje, Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2004/2, Neni 10.6, par. (b) lidhur me Nenin 23 të KPK-së</p> <p>I pandehuri (1): i shpallur fajtor për të 3 pikat;</p> <p>Të pandehurit (2) dhe (3) janë liruar nga të gjitha akuzat</p>
--	---

Procedura e tanishme ka të bëjë me lëndën penale kundër Ramush Haradinajt para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (tash e tutje TPNJ) e cila ka pasur një shkallë të gjerë të mbulimit medial.

Pas ngritjes së aktakuzës kundër Ramush Haradinajt nga ana e Prokurorit të TPNJ-së në Hagë, në Kosovë në vitin 2005 u themelua një fond për mbrojtjen e tij nga Jahja Lluka dhe nga bashkëthemelues të tjerë në një xhirollogari të Kasabankës dhe të Bankës Ekonomike. Ky fond është regjistruar si Organizatë Jo Qeveritare dhe me të njëjtin status është miratuar nga Ministria e Shërbimeve Publike. I pandehuri (1) është akuzuar për veprat penale të Deklarimit dhe lajmërimit të rrejshëm dhe të Pranimit të kundërligjshëm të parave. I pandehuri (2) si Drejtor i përgjithshëm dhe i pandehuri (3) i Menaxher i shitjes në kompaninë Kasabank janë akuzuar me Moslajmërim të transaksioneve në bashkëkryerje. Dispozitat penale me të cilat janë akuzuar të pandehurit synojnë parandalimin e larjes së parave duke ndëshkuar veprimet ose lëshimet të cilat mund fshehin punët e dyshimta të cilat kanë të bëjnë me larjen e parave si shkelje të rregulloreve në fuqi mbi financimin dhe mbi sistemin bankar. Test i qartë që gjykata duhej ta kryente punën e vet ishte respektimi i rregullave dhe i detyrave të lajmërimit dhe të deklaratave të ilustruara me normat ligjore.

Pas konfirmimit të aktakuzës, lënda është bartur tek EULEX-i në shkurt të vitit 2009. Vepra penale binte në fushën e kompetencave primare të gjyqtarëve të EULEX-it sipas Nenit 3, par. 2 të Ligjit mbi kompetencat. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 10 dhjetor 2009 ndërsa aktgjykimi është shpallur më 12 shkurt 2010. Në ditën e parë të gjykimit, gjykata ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për ndarjen e procedurës penale kundër të Pandehurve (2) dhe (3) dhe me qëllim të mundësisimit të përfundimit dhe të përshpejtimit të procedurës.

Në fund të procedurës së provave gjykata ka konstatuar se ka prova të plota që i pandehuri (1) ka vepruar si bashkëthemelues dhe përfaqësues i autorizuar i Fondit duke siguruar informata dhe duke përgatitur raporte, certifikata ose deklarime lidhur me deponimin e parave në xhirollogarinë e Fondit, dhe me vetëdije ka bërë deklarime të rrejshme ose qëllimisht nuk ka zbuluar informata materiale. Gjykata përveç kësaj, ka konstatuar se i pandehuri (1) ka pranuar në emër të Fondit një kontribut në para i cili kalon shifrën prej 1,000 eurosh gjatë një dite të vetme, duke shkelur kështu Nenin 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2. Provat janë siguruar përmes dokumentacionit masiv të konfiskuar nga hetuesit prej bankës dhe nga dëshmitë e disa dëshmitarëve. Megjithëkëtë, Milazim Abazi dhe Hashim Sejdiu janë liruar nga të gjitha akuzat për arsye se gjykata nuk ka mundur të konstatojë qëllimin e tyre për t'i fshehur transaksionet e dyshimta.

Lënda P. Nr. 403/2007 Shefka Shasivari (1), Suzana Haxhimusovic Bajtijari (2) dhe Riza Kuka (3), Gjykata e qarkut në Prishtinë

<p>Lloji i procedurës: Data: Vepra penale:</p>	<p>Shkalla e parë 23 qershor 2010 I pandehuri (1): i akuzuar për veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare në bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenin 339 dhe 23 të KPK-së dhe Mashtrim gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në bashkëveprim, në kundërshtim me Nenin 341 dhe 23 të KPK-së I pandehuri (2): I akuzuar për veprat penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare në bashkëveprim, në kundërshtim me Nenin 339 dhe 23 të KPK-së dhe Mashtrim gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në bashkëveprim, në kundërshtim me Nenin 341 dhe 23 të KPK-së I pandehuri (3): I akuzuar për veprën penale të Ofrimit të ndihmës për Shpërdorimin e pozitës zyrtare, në kundërshtim me Nenin 339 dhe 25 të KPK-së</p>
<p>Epilogu:</p>	<p>Dënimi</p>

Kjo lëndë është përzgjedhur për raport sepse ka të bëjë me një nga prioritetet e mandatit të EULEX-it – luftimi i korrupsionit. Krimet e kryera nga personat që supozohen të kenë ndjekur interesin publik meritojnë vëmendjen e posaçme të komunitetit ndërkombëtar.

Shefka Shasivari është akuzuar se në mes të viteve 2003 dhe 2004 e ndihmuar nga Riza Kuka si person zyrtar dhe me qëllim të përfitimit të dobisë së kundërligjshme pasurore për vete, duke i dëmtuar të tjerët ose organizatën e punës, të dy duke shkelur vendet e tyre zyrtare të punës në Zyrën e Presidentit të Kosovës (ZPK), duke tejkaluar autorizimet e veta dhe pa i kryer detyrat e tyre zyrtare siç përcaktohet me Ligjin mbi prokurimin publik, Shasivari me ndihmën e Kukës duke mashtruar kanë manipuluar blerjen e 90 gomave për automjetet e ZPK-së, duke shkelur ligjet dhe rregullat e prokurimit të qeverisë. Ata kanë vepruar kundër interesit publik dhe i kanë shkaktuar ZPK-së humbje të mëdha duke i fryrë tepër shumë shifrat e parave, lart mbi vlerën e vërtetë të gomave duke përdorur dokumentacion të falsifikuar me qëllim të justifikimit të çmimit të fryrë.

Shefka Shasivari është shpallur fajtores dhe është dënuar me një dënim unik prej 2 (dy) vjetësh burgim. Gjykata ka konstatuar se Suzana Bahtijari në cilësinë e saj si person zyrtar ka falsifikuar dokumentin zyrtar të quajtur “Urdhërpagesa” të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave duke futur në të informata të rreme. Me nënshkrimin e saj ajo kishte certifikuar pranimin e gomave të markës Bridgestone për stinën e verës si dhe dorëzimin e tyre tek departamentet kompetente në përputhje me kushtet e përcaktuara me Urdhërpagesa, ndërsa realisht ato goma as që ishin sjellë fare nga Sllovenia për në Kosovë. Ajo është shpallur fajtores për veprën penale të Falsifikimit të dokumenteve zyrtare dhe është dënuar me dënim me kusht prej 4 (katër) muajsh burgim. Riza Kuka është shpallur fajtor për këtë pikë dhe është dënuar me dënim me kusht prej 6 (gjashtë) muajsh burgim. Gjykata ka obliguar të pandehurit (1) dhe (3) për t’i kompensuar dëmet e shkaktuara në shumën prej 28,400 eurosh brenda një periudhe prej 2 (dy) vjetësh, duke filluar nga data kur aktgjykimi të merr formën e tij të prerë.

Lënda P. Nr. 462/2009 Ove Johansen, Gjykata e qarkut në Prishtinë²⁸

Lloji i procedurës:	Shkalla e parë
Data:	9 korrik 2010
Vepra penale:	I akuzuar për veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare

²⁸ Për referim shih më lart Lëndën Pkl-Kzz 114/2009 Leme Xhema, Gjykata Supreme

Epilogu:	në bashkëkryerje, Nenit 339, par. 1 dhe 3, 23 i KPK-së I dënuar
-----------------	--

I pandehuri në fjalë është akuzuar për kryerjen e veprës penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare në bashkëkryerje me Leme Xhemën dhe me bashkëkryerës të tjerë. Arsyeja pse jemi përcaktuar për këtë lënë është se lënda lidhet me lëndën penale të përmendur më lart.

Gjykata ka konstatuar se edhe pse vetë i pandehuri nuk ka qenë person zyrtar në kuptimin e Nenit 339 të KPK-së, ai kishte dhënë një kontribut të ndjeshëm në kryerjen e veprës penale nga ana e Leme Xhemës. Një kontribut i këtillë, sipas Nenit 23 të KPK-së, me kushtin që parimi *mens rea* të përmbushet, e bën bashkëkryerësin përgjegjës sikur ta kishte kryer vetë këtë vepër penale, pavarësisht faktit nëse i pandehuri ka pasur kompetenca zyrtare apo jo. I pandehuri duke vepruar *de facto* si përfaqësues i kompanisë “Norway Invest” në Kosovë, ka pasur një rol aktiv dhe me paramendim ka ndikuar në stimulimin, në organizimin dhe në pranimin e pagesës së kundërligjshme në vlerë prej 300,000 eurosh nga Leme Xhema për kompaninë “Norway Invest R&O AS”.

Rrjedhimisht i pandehuri është shpallur fajtor. Gjatë llogaritjes së dënimit, gjykata ka marrë parasysh si rrethana rënduese edhe vlerën e madhe të dëmit të shkaktuar si dhe faktin që ky i pandehur ishte dënuar edhe më herë në Norvegji për një vepër penale të kontabilitetit jo besnik (të rrejshëm).

Pasi që rrethanat lehtësuese janë pranuar, fakti se i akuzuari nuk ka qenë i ngarkuar me fuqi zyrtare dhe nuk kishte asnjë provë se ai personalisht e ka pasuruar veten. Vetëm është përfunduar se sjellja penale ka shpirë pasurimin e Kompanisë kosovare “Norway Invest”. Gjykata në kontekstin e njëjte gjithashtu ka vërejtur vështirësitë e marrjes me afarizëm në Kosovë në atë kohë.

Gjykata shpalli si dënim me kusht me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh. Dënimi ekzekutohet nëse brenda periudhës kohore prej 2 (dy) vitesh, duke filluar prej kohës kur

aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm, i pandehuri nuk e paguan dëmin e shkaktuar PTK-së në shumën e 300,000 Eurove.

Lënda P. nr. 71/2007 Nexhat Daci (1) dhe Ahmet Alishani (2), Gjykata e Qarkut në Prishtinë

Lloji i procedurës:	Shkalla e parë
Data:	10 nëntor 2010
Veprat penale:	Të dytë: Pika të shumëfishta të aktakuzës të Shpërdorimit, neni 219, paragrafët 1, 2 të LPK-së dhe Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës, neni 340 i KPK-së
Rezultati:	Të dytë: Dënim i pjesshëm

Ky rast është paraqitur në raport pasi që një prej të akuzuarve është person i njohur politik i cili në kohën e kryerje së veprës penale ka mbajtur funksion të rëndësishëm publik.

I pandehuri është akuzuar në shkurt dhe maj të vitit 2005 kur ai ishte Kryetar i Parlamentit të Kosovës dhe si pasojë ai është cilësuar si person zyrtar, ka përvetësuar shumën e 590 eurove nga buxheti i caktuar për Parlamentin e Kosovës për blerjen e dy palë syzeve për vete dhe 950 eurove për rregullimin personal të dhëmbëve me qëllim të përfitimit të paligjshëm material. Gjykata konstatoi se ishte vërtetuar se Daci i ka përdorur këto të holla, që i ishin besuar atij duke marr parasysh pozitën e tij brenda Parlamentit të Kosovës për blerjen e syzeve dhe për të paguar trajtimin dentar, kështu që ka kryer vepër penale të Përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës.

Më 10 nëntor 2010, gjykata e shkallës së parë e shpalli të Pandehurin fajtor nga dy pika të aktakuzës të veprës penale të Përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës. Gjykata ka hedhur poshtë pretendimet e të pandehurve që a) nuk ka qenë brenda kompetencës së tij zyrtare që ti autorizoj pagesat nga buxheti por kjo ishte detyrë e Sekretarisë së Parlamentit të Kosovës; dhe b) të dy blerjet ishin të lidhura me detyrat e tij zyrtare. Gjykata përfundoi që termi “që i është besuar”, siç përdoret në nenin 340 të KPK-së duhet të interpretohet gjerësisht. Është e mjaftueshme që i pandehuri, bazuar në pozitën e tij zyrtare, ishte-së paku *de facto*- në pozitën e udhëheqjes me fuqi të vendosjes mbi përdorimin e

mallrave/fondeve në fjalë. Gjykata ka gjetur se ekzistojnë prova të mjaftueshme që i pandehuri ka qenë në pozitë faktike që i ka mundësuar atij të vendos mbi shpenzimet nga buxheti i Parlamentit të Kosovës. Sa i përket pretendimit b), gjykata vërtetoi që i pandehuri personalisht i ka porositur syzet nga syza bërësi dhe shërbimet dentare në emër të tij dhe duke mos e përmendur Parlamentin e Kosovës si palë kontraktuese apo ndonjë procedurë publike tenderuese. Prandaj, Gjykata e Qarkut përfundoi se këto blerje ishin ekskluzivisht të natyrës personale pa kurrfarë lidhjeje me aktivitetet zyrtare të të Pandehurit.

Ahmet Alishani ishte shpallur fajtor nga një pikë e aktakuzës së Përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës. Ai i ka ofruar ndihmë Nexhat Dacit në kryerjen e veprës së lartpërmendur duke u ndërlidhur me dentistin, duke e udhëzuar atë se si të përgatit faturat dhe si ta pranoj pagesën nga buxheti i Parlamentit për punën e kryer dentare në dobi të Nexhat Dacit.

Sa i përket akuzave tjera trupi gjykues përfundoi se prokuroria nuk mund të ofroj prova të mjaftueshme që vërtetojnë se i Pandehuri ka kryer vepra penale të Shpërdorimit. I pandehuri (1) është dënuar me dënim unik me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe 6 (gjashtë) muaj. Përveç kësaj, sipas nenit 56, paragrafit 2 të KPK-së, atij i është ndaluar ushtrimi i pozitave të administrimit publik ose të shërbimeve publike për 2 (dy) vite pas vuajtjes së dënimit. I pandehuri (2) është dënuar me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve. Prokuroria e gjithashtu edhe të dy të Pandehurit u ankuan në aktgjykim. Ankesat aktualisht janë në pritje në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Lënda P.nr. 36/2010 Abedin Muzlijaj, Gjykata Komunale e Klinës (regjioni i Pejës)

Lloji i procedurës:	Shkalla e parë
Data:	25 mars 2010
Veprat penale:	I akuzuar me Shpërdorimi i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit dhe Mashtrimi, Nenet 339, paragrafi 2 dhe 261, paragrafi 1 të KPK-së
Rezultati:	Dënim i pjesshëm

Lënda është paraqitur këtu sepse bie brenda kompetencës primare të Gjyqtarëve të EULEX-it dhe ka të bëjë me mandatin qendrorë të misionit, lufta kundër korrupsionit.

I pandehuri kishte punuar si Zyrtar Hetues Policorë në Zyrat Kryesore Regjionale në Pejë. Ai ishte akuzuar, i ngarkuar me këtë pozitë zyrtare të hetimit të vrasjes në mars të vitit 2008 duke kërkuar 10,000 Euro nga familja e viktimës, gjoja se me qëllim të pagesës së informatorëve që do të zbulonin kryesin e veprës penale. Ai ka pranuar shumën e 4,500 Eurove dhe 700 Frangave Zvicerane në tri këste.

I pandehuri është akuzuar me Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose të Autorizimit dhe të Mashtrimit sipas nenit 339 paragrafit 2 dhe nenit 261 paragrafit 1 të KPK-së. Në shqyrtimin gjyqësorë para Gjykatës Komunale në Klinë ishte e padiskutueshme që i Pandehuri ka kërkuar shumën e pretenduar të hollave në aktakuzë nga familja e viktimës së vrasjes. Megjithatë, i Pandehuri pretendoi që ai thjeshtë ka kërkuar për hua pa ndonjë lidhje me detyrën e tij si zyrtar hetues. Gjykata ka gjetur që versioni i të Pandehurit ishte kundërshtuar nga deklaratat e besueshme dhe kuptueshme të dëshmitarit. Ka gjetur të besueshme që në kontekst të Kosovës familja e viktimës së vrarë e ka gjetur të pranueshme që kërkohen të holla për përkrahjen e hetimit policorë. Gjykata i ka dhënë peshë faktit që i Pandehuri vetëm gjatë marrjes në pyetje të tij në shqyrtim gjyqësorë, pasi që janë paraqitur të gjitha provat kundër tij ka ofruar pohimin (pretendimin) e tij shfajësues. As gjatë fazës së procedurës paraprake e as gjatë marrjes në pyetje nga pala kundërshtare të dëshmitarëve mbrojtja nuk i ka kundërshtuar deklaratat vendimtare. Gjykata e ka marrë parasysh paraqitjen e vonë të versionit shfajësues si një manovrim taktik me qëllim të shmangies së ballafaqimit me dëshmitarët kyç. Gjykata përfundoi që i Pandehuri ka kryer veprë penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose të Autorizimit kur e ka pranuar pagesën në shkëmbim të zbulimit të kryesit të veprës penale.

Gjykata ka gjetur se vepra penale e Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit ishte kryer kur Abedin Muzlijaj ka kërkuar të holla në shkëmbim për gjetjen e kryesit të vrasjes dhe ka pranuar këstin e parë në shumën e 3,000 Eurove. Të gjitha pagesat e mëvonshme ishin pranuar vetëm në ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje fillestare. Edhe

pse i Pandehuri lajthit palën e dëmtuar kur e pranon këstin tjetër pasi që ai kishte dorëzuar raportin e tij penal në Zyrën e Prokurorit, kjo nuk ka përbërë veprë plotësuese, d.m.th.: Mashtrimin por ende ishte veprës së lartpërmendur fillestare. Prandaj, nuk e ka shpallur fajtor për Mashtrim.

I pandehuri është dënuar për Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit sipas nenit 339 paragrafit 2 të KPK-së dhe është dënuar me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim me dënim me kusht nëse i akuzuari i kompenson dëmin e shkaktuar palës së dëmtuar.

Lënda Ap-Kz nr. 93/2010 Abedin Muzlijaj, Gjykata e Qarkut në Pejë

Lloji i procedurës:	Ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë
Data:	7 Shtator 2010
Veprat penale:	I dënuar për Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit (shih më lart)
Rezultati:	Konfirmim i pjesshëm i aktgjykimit të mëparshëm

Procedurat e tanishme kanë të bëjnë ankesën e vendimit në lëndën e përshkruar më lart. Aktgjykimi përmban diskutim të vlefshëm mbi cilësimin juridik të alternativës së cilësuar të veprës penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose të Autorizimit sipas nenit 339, paragrafit 2 të KPK-së.

Me ankesat e parashtruara nga PSRK-ja dhe të mbrojtjes Gjykata e Qarkut në Pejë duhej të vendoste në shkallë të dytë. Gjykata e ka marr parasysh që shkalla e parë në mënyrë të mjaftueshme ka vërtetuar faktet e lëndës dhe nuk ka parë nevojë për marrjen e provave shtesë. Gjykata ka refuzuar pretendimin e të pandehurit që vepra në fjalë është përcaktuar gabimisht sepse nuk ka pasur qëllim për të shkaktuar dëme. Ka shtjelluar më tutje që asnjë qëllim për të shkaktuar dëme që tejkalojnë 2,500 Euro nuk është i nevojshëm për të kryer veprë penale nga neni 339, paragrafit 2. Është e mjaftueshme që kur dëmi (që tejkalon 2,500 euro) është shkaktuar si rezultat i drejtpërdrejtë i kryerjes së veprës penale që përshkruhet në nenin 339, paragrafin 1 të KPK-së.

Sa i përket veprës penale të Mashtrimit, kolegjit e ka ndjekur argumentin e gjykatës së shkallës së parë që vepra më e rëndë e përvetëson atë më pak të rëndë dhe si pasojë ka

refuzuar ankesën e prokurorisë në këtë aspekt si të pabazuar. Ka ndryshuar aktgjykimin e mëparshëm sa i përket sanksionimit penale. Vendimi që të mos shkohet përtej 1 (një) viti dhe 6 (gjashtë) muaj ishte i bazuar në faktin e ri që i Pandehuri në ndërkohë i ka kthyer mbrapa palës së dëmtuar shumën e të hollave të pranuar në mënyrë joligjore. Gjykata ka shqiptuar burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe 6 (gjashtë) muajve pa pezullim sipas nenit 34, paragrafit 2 të KPK-së me qëllim të përmbajtjes së kundërvajtësve tjerë të mundshëm. Të dy ankesat e ushtruara nga avokatët mbrojtës në emër të Pandehurit ishin refuzuar si të pabazuara.

Lënda P. nr. 385/2010 Agim Zeka, Gjykata Komunale në Prizren (Regjioni i Prizrenit)

Lloji i procedurës:	Shkalla e parë
Data:	25 mars 2010
Veprat penale:	I akuzuar me Dhënia e Ryshfetit si ndërmjetës, neni 344, paragrafit 1 të KPK-së
Rezultati:	Dënim

Procedura lidhet me lëndën e dhënies së ryshfetit gjyqtarit dhe si e tillë është pjesë qendrore e mandatit të EULEX-it.

Fillimisht, shqyrtimi gjyqësor para Gjykatës Komunale në Prizren është hapur bashkë kundër Elez Hoxhës,²⁹ gjyqtarit i cili është akuzuar për marrjen e ryshfetit dhe të Pandehurit. Në fillim të shqyrtimit gjyqësor me 23 mars 2010, i Pandehuri Agim Zeka është deklaruar i pafajshëm. Gjykata pastaj ka marr aktvendim duke urdhëruar ndarjen e procedurave kundër të dy pandehurve të përmendur.

Gjykata, duke e qenë e kënaqur që kërkesat për deklaratë të fajësisë janë plotësuar në përputhje me nenin 315, paragrafit 1 të KPPK-së ka gjetur se i pandehuri në mes të viteve 2005 dhe 2007 ka akorduar ndërmjetësim me kryetarin e kolegjit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën kundër dy personave të akuzuar për vrasje, në shumën e së paku 53,000 Eurove dhe të automjetit Volkswagen Caddy si ryshfet me qëllim të ndikimit të

²⁹ Referencë e kundërt lënda pasuese

rezultatit të favorshëm të shqyrtimit të përmendur për dy personat e akuzuar. I pandehuri ka mohuar që ai ka përfituar financiarisht duke vepruar si ndërmjetës për një person tjetër dhe gjykata nuk ka gjetur provë për të kundërshtuar këtë pretendim. I pandehuri është dënuar dhe i është shqiptuar burgimi në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve dhe gjobës prej 2,000 Eurove. Dënimi ka reflektuar deklarinimin e hershëm të pafajësisë së të pandehurit.

Më 30 korrik 2010, Gjykata e Qarkut në Prizren ka refuzuar si të pabazuara³⁰ ankesat e avokatit mbrojtës dhe të Prokurorisë.

Lënda P. nr. 351/2010 Elez Hoxha, Gjykata Komunale në Prizren (Regjioni i Prizren-it)

Lloji i procedurës:	Shkalla e parë
Data:	14 korrik 2010
Veprat penale:	I akuzuar me Marrjen e Ryshfetit, neni 343, paragrafit 1 të KPK-së
Rezultati:	Dënim

Procedura ka të bëj me veprën e lartpërmendur penale. Kanë të bëjnë me gjyqtarin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i cili ishte i akuzuar me marrjen e ryshfetit, kundër të cilit janë ndarë procedurat.

I pandehuri është akuzuar se gjatë viteve 2005 deri në vitin 2007, derisa ishte gjyqtar I Gjykatës së Qarkut në Prishtinë prandaj edhe person zyrtar në kuptim të nenit 343 të KPK-së ka pranuar të holla në shumën e 53,000 Eurove dhe automjet Volkswagen Caddy të gjitha këto me qëllim që ai do të kryej brenda fushës së autoritetit të tij zyrtar veprë zyrtare apo veprë tjetër të cilën ai nuk do të duhej të kryej ose të dështoj të kryer veprë zyrtare apo veprë tjetër të cilën ai do të duhej të kryente – posaçërisht shfajësimi apo shqiptimi i dënimit jo proporcionalisht të lehtë kundër 2 (dy) personave të akuzuar për vrasje.

³⁰ Shih lëndën KP.nr. 160/10 të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Agim Zeka, 30 korrik 2010, në dispozicion në <http://www.eulex-kosovo.eu/en/judgments/CM-District-Court-of-Prizren.php>

I pandehuri i ka mohuar të gjitha akuzat dhe ka pohuar se pretendimet kanë rezultuar nga një skemë e shtjelluar për të siguruar rigjykimin e 2 (dy) personave që ai ka dënuar për vrasje dhe një përpjekje të marr hak kundër tij për dënimet e tyre. Gjykata ka dëgjuar disa dëshmitarë. Aktgjykimi gjithashtu i bazuar në prova të dokumentuara, në mes të tyre sigurimi, dogana dhe dokumentet e regjistrimit për automjetin në fjalë e gjithashtu edhe incizimet audio-vizuale të bëra nga familja e 2 (dy) personave që i pandehuri i ka dënuar për vrasje.

Në lidhje me këto incizime, me propozimin e dorëzuar nga mbrojtja, Gjykata Komunale duhej të vendoste mbi pranueshmërinë e fakteve. Ka shtjelluar që provat mund të jenë të papranueshme vetëm nëse marrja e incizimeve të lartpërmendura audio-vizuale janë të dënueshme sipas KPK-së. Dispozitat relevant që duhet të merren parasysh ishin vepra penale sipas neneve 170³¹ dhe 171³² të KPK-së. Megjithatë, asnjë nga dispozitat penale të zbatuara që nga incizimi i bisedave në mes të dëshmitarit dhe të pandehurit dhe që incizimet nuk ishin bërë në lokalet personale të pandehurit prandaj edhe nuk përbëjnë shkelje të privacisë së të pandehurit. Si pasojë gjykata i ka konstatuar provat të pranueshme. Incizimet gjithashtu janë gjykuar si origjinale dhe kualiteti i mjaftueshëm që me besueshmëri të identifikohet i pandehuri derisa i pranonte pagesat dhe duke diskutuar potencialin e vet të ndikoj në procedurat gjyqësore në fjalë. Si pasojë, në bazë të provave gjykata e ka shpallur të pandehurin fajtorë siç është akuzuar. E dënoi atë me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) viteve dhe me dënim plotësues me gjobë në shumën e 10,000 Eurove.

Duke e shpallur aktgjykimin gjykata deklaroi:³³

Drejtësia dhe trajtimi i barabartë para ligjit janë parimet themelore në zemrën e çdo shoqërie demokratike. Ne mbështetemi në ata që mbajnë funksione gjyqësore, në besimin dhe sigurinë e njerëzve për mbrojtjen individuale të drejtave dhe lirive. Gjyqtarët janë shpesh e tëra që qëndron në

³¹ Përgjimi dhe Incizimi tonik i paautorizuar

³² Fotografimi dhe incizimet e tjera të paautorizuara

³³ Gjykata Komunale në Prizren, Lënda P. nr. 351/2010, Elez Hoxha, aktgjykimi faqe 36

mes të shoqërisë së lirë, të drejtë, demokratike dhe tiranisë. Kur gjyqtarët janë të korruptuar peshoret e drejtësisë shkojnë në të mirë të fajtorit. Zërat e pafajshëm nuk dëgohen; vepra e fajësisë mbetet e pandëshkuar dhe struktura e shoqërisë dezintegrohet.

Me ankesën e të pandehurit, Gjykata e Qarkut në Prizren morri aktgjykimin me 22 tetor 2010. Gjykata refuzoi ankesën si të pabazuar.³⁴

Lënda P. nr. 917/2010 Ekrem Agushi, Gjykata Komunale në Prizren (Regjioni i Prizren-it)

Lloji i procedurës:	Shkalla e parë
Data:	7 tetor 2010
Veprat penale:	I akuzuar me Nxjerrjen e Kundërligjshme të Vendimeve Gjyqësore, neni 346 i KPK-së
Rezultati:	I liruar

Procedurat aktuale kanë të bëjnë me një lëndë tjetër kundër gjyqtarit vendor i akuzuar për manipulimin e vendimit gjyqësor.

I pandehuri ishte akuzuar me 4 qershor 2008 duke vepruar si kryetar i kolegjit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë në pranimin e ankesës në lëndën e trashëgimit duke marr vendim të kundërligjshëm gjyqësor me qëllim të përfitimit kundërligjor ose të shkaktimit të dëmit ndaj personit tjetër. Prokuroria në veçanti pohoi që ai si gjyqtar raportues gjatë këshillimit dhe votimit me qëllim dështoi t'i informoj anëtarët tjerë të kolegjit që aktvendimi i plotfuqishëm gjoja se i lëshuar më herët nga Gjykata Komunale e Prishtinës ka qenë e vulosur me vulën me tekst “Republika e Serbisë, Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë”, prandaj edhe ishte qartë e dallueshme pasi që është lëshuar nga institucioni i paautorizuar, e ashtuquajtura gjykatë “paralele”. Në afekt kolegji me arsyetimin që çështja ka qenë *res judicata* e aprovoi aneksen dhe e anuloi vendimin e shkallës së parë.

³⁴ Shih Gjykata e Qarkut në Prizren, Lënda KP. nr. 227/10, Elez Hoxha, 22 tetor 2010 në dispozicion në <http://www.eulex-kosovo.eu/en/judgments/CM-District-Court-of-Prizren.php>

I pandehuri pretendonte që ai ka dështuar të vërej përmbajtjen e vulës dhe ishte i bindur që vendimi ka qenë i lëshuar nga dega legjitime e Gjykatës Komunale të Prishtinës. Ai deklaroi që ai nuk i ka njohur palët në procedurën e trashëgimisë dhe se as që ka pas qëllim të përfitoj për veten apo dikë tjetër ose t'i shkaktoj dëm ndonjërit. Ai gjithashtu përmendi që vendimi mbi trashëgiminë nuk është i plotfuqishëm dhe që palët në procedurë civile mund të ushtrojnë kërkesë para shkallës më të lartë. Gjykata përfundoi që nuk është vërtetuar se Ekrem Agushi ka vepruar me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm material për vete ose për personin tjetër ose t'i shkaktoj dëm personit tjetër, siç kërkohet nga neni 346 i KPK-së dhe e liroi të pandehurin.

Me 5 nëntor 2010, Prokuroria ushtroi ankesë kundër aktgjyimit të shkallës së parë. Gjykata e Qarkut refuzoi ankesën si të pabazuar më 7 dhjetor 2010 dhe me këtë konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale.³⁵

III. Lëndët e dhunës në familje

Lënda P. nr. 215/2007 Enver Hasani, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë

Lloji i procedurës:	Shkalla e parë
Data:	16 shkurt 2010
Veprat penale:	I akuzuar për Vrasje të Rëndë, neni 147, pika 9 e KPK-së dhe Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve, neni 328, paragrafit 2 të KPK-së
Rezultati:	Dënim

Shqyrtimi ka të bëjë me lëndë të rëndë të dhunës në familje ku bashkëshortja është vrarë nga bashkëshorti. Është gjithashtu vitrinë për ilustrimin e problemeve të ballafaquara në administrimin e drejtësisë në gjykatat e veriut të Kosovës. Pas të parës që është shqyrtuar nga gjyqtarët vendorë, për shkak të zhvendosjes së stafit gjyqësor nga gjykata e Mitrovicës procedurat janë ndërprerë në mars të vitit 2008 gjatë shqyrtimit gjyqësor. Pas marrjes përsipër nga EULEX-i ka rifilluar vetëm në janar të vitit 2010.

³⁵ Shih Gjykata e Qarkut në Prizren, Lënda Ap. nr. 156/10, Ekrem Agushi, 7 dhjetor 2010 në dispozicion në <http://www.eulex-kosovo.eu/en/judgments/CM-District-Court-of-Prizren.php>

Më 31 maj 2007 rreth orës 11:30 viktima Raba Hasani është qëlluar për vdekja në shtëpinë e saj në fshatin Klladernicë (Komuna e Skenderajt). Aktakuza e datës 10 shtator 2007, e akuzoi të akuzuarin i cili është bashkëshorti i viktimës së ndjerë me veprën penale të Vrasjes së Rëndë dhe të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve. Aktakuza është konfirmuar në nëntor të vitit 2007. Shqyrtimi gjyqësor filloi me 12 shkurt 2008; aktgjykimi është shpallur me 16 shkurt 2010.

Gjykata përfundoi se me 31 maj 2007 në shtëpinë e tyre i pandehuri pas argumentit të përqendruar në pyetjen nëse bashkëshortes së tij i nevojitet leja e tij për të lëshuar shtëpinë dhe nga xhelozia e qëllui bashkëshorten e tij së paku 3 herë nga distanca e afërt me pushkë karabinë M 48, duke e qëlluar atë në zonën e kraharorit dhe të abdomenit (barkut). Viktima ka vdekur në vendngjarje si rezultat i plagëve. I akuzuari ka pranuar që ka vrarë bashkëshorten e tij por ai pohoi se ai e ka bërë këtë në gjendje të afektit mendor i shkaktuar nga ofendimi i rëndë nga viktima. Gjykata si pasojë duhej të merr parasysh cilësimin juridik të veprës penale. E ka mohuar zbatueshmërinë e dispozitës ligjore të Vrasjes të kryer në Gjendje të Afektit Mendor (neni 148 të KPK-së) dhe ka përfunduar që i Pandehuri ka kryer Vrasje të Rëndë (neni 147, pika 9 e KPK-së). Gjykata gjeti se nuk ka pasur tregues që viktima ka sulmuar, keqtrajtuar ose ofenduar rëndë të Pandehurin dhe kështu që e ka sjellë atë, nëpërmes asnjë faji të tij, në gjendje të shokut (tronditjes) së rëndë.

E kundërta, veprimet e të pandehurit e kanë cilësuar atë të vetëdijshëm mentalisht dhe të kontrolluar, pasi që ai duhej të mbushte dhe rimbushte pushkën pas secilës së shtënë. Gjykata gjithashtu ka urdhëruar ekspertizën psikiatrike të pandehurit dhe kështu ka përjashtuar mundësinë që përgjegjësia e tij penale ishte e kufizuar ose e përjashtuar (neni 12 i KPK-së).

Duke e përcaktuar dënimin gjykata ka marr parasysh si rrethana rënduese në veçanti shpërdorimin afat-gjatë të cilin i pandehuri e ka nënshtruar bashkëshorten e tij, faktin se ajo ishte nënë e 7 (shtatë) fëmijëve dhe mënyrën se si ishte kryer vepra penale. Si

rrethana lehtësuese gjykata e ka llogaritur në veçanti që ai pjesërisht i ka pranuar veprat penale – ai është deklaruar fajtor për Vrasje dhe Posedim të Kundërligjshëm të Armëve. Gjykata e ka dënuar të pandehurit për të dy akuzat dhe e ka dënuar atë me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) viteve.

Lënda Ap-Kz nr. 192/2010 Enver Hasani, Gjykata Supreme

Lloji i procedurës:	Ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë
Data:	5 tetor 2010
Veprat penale:	I dënuar siç është akuzuar (shih më lart)
Rezultati:	Ankesa është refuzuar si e pabazuar

Procedura ka të bëj me ankesën në emër të pandehurit kundër aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë në lëndën e lartpërmendur.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme përmban diskutime interesante lidhur me barrën e provave dhe parimit *in dubio pro reo* sa i përket dhënies së privilegjit dispozitës nga neni 148 të KPK-së³⁶ e gjithashtu mbi cilësimin e “motiveve të ulëta” në kuptim të nenit 147, pikës 9 të KPK-së.

Gjykata pikë mbështetet që përfitimi për të pandehurin në zbatimin e nenit 148 të KPK-së nuk mund të mohohet për shkak të arsyes së thjeshtë që i akuzuari nuk ka ofruar ndonjë provë për ofendim të pretenduar nga viktimja e ndjerë para vrasjes. Kërkesa e tillë për paraqitjen e provave do të ishte në konflikt me parimet *in dubio pro reo* dhe *presumimi i pafajësisë* kështu që do të përbënte shkelje të drejtave më elementare individuale të paraqitura në Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut (tash e tutje KEDNj-ja). Prandaj kallëzimi i dhënë nga i akuzuari nuk mund të hidhet poshtë për arsyen e vetme që ai ka dështuar të dorëzojë ndonjë provë. Përshkrimi i tij i ngjarjes ishte i besueshëm (bindës) dhe asnjë provë nuk mund të gjendet me të cilën kjo pjesë e deklaratës së tij do të mund të hedhet poshtë (përgënjeshtrohet).

36 Dispozita parasheh dënim më të butë nëse vrasja është kryer në gjendjen e afektit mendor pasi që kryesi është sjellë pa fajin e tij apo saj në gjendjen e tronditjes (shokut) të rëndë i shkaktuar nga sulmi, keqtrajtimi apo ofendimi i rëndë nga personi i vvarë.

Kjo megjithatë, nuk e ndryshon cilësimin juridik. Bile as kallëzimi i ofruar nga vetë i akuzuari lejon zbatimin e nenit 148 të KPK-së. Nuk është e nevojshme që të vërtetohet nëse fjalët e viktimës përbëjnë “ofendim të rëndë dhe nëse i akuzuari ka rënë në gjendje të afektit mendor nga këto fjalë sepse zbatimi i nenit 148 të KPK-së kërkon që e tërë kjo të ketë ndodhur “nëpërmjet të fajit të askujt, të tij ose të saj”, d.m.th. të akuzuarit. Sa i përket kësaj faktet e vërtetuara në mënyrë korrekte në aktgjykimin e shkallës së parë nuk lënë hapësirë për dyshime që viktima ka reaguar në akuzime të gabueshme, ofendime personale dhe bile keqtrajtme fizike të shkaktuara asaj nga i akuzuari para vet ngjarjes. Si pasojë në çfarëdo rasti kanë qenë gabimet e tij që e bëri viktimën që në ditën kritike të reagoj në mënyrën e përshkruar nga i akuzuari.

Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka zbatuar nenin 147, pikën 9 të KPK-së. I akuzuari e privoi nga jeta bashkëshorten e tij për motive të ulëta. Motive të ulëta janë të gjitha ato motive që nuk janë të denjë për qenien njerëzore dhe të cilat nuk përputhen me pikëpamjet e miratuara morale të shoqërisë; ato janë në pikën më të ulët të peshores së vlerave sipas gjykitimit moral³⁷. Mund të jetë e diskutueshme nëse xhelozia në vetvete mund të shihet si motiv i ultë³⁸. Megjithatë, në lëndën në fjalë, i akuzuari nuk ka vepruar vetëm nga xhelozia. Ai gjithashtu ka vrarë bashkëshorten e tij sepse ajo “ka marr guxim” të tentoj të largohet nga shtëpia pa lejen e tij. Reagimi i tij në këtë përpjekje- duke e vrarë- demonstroi besimin e tij që ai pasur të drejtë të vendos lidhur me të drejtën e saj të ekzistoj. Ky koncept i pamëshirshëm egoist i të qenit sundues ndaj ekzistimit të saj tregon mosrespektimin më të lartë për të drejtën e natyrshme të qenies tjetër njerëzore të jetoj dhe si e tillë është motiv i ultë. Gjykata ka refuzuar ankesën e të pandehurit si të pabazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

³⁷ Shih Komentaret për ligjet penale të RS të Serbisë, KSA Kosovë dhe KSA Vojvodinë, 1981, "Savremena Administracija" Beograd, Komentaret për Kodin Penal të Serbisë, neni 47 nr. 7 pika d, Srzentic, Nikola – Stajic, dr. Aleksandar – Kraus dr. Bozidar – Lazarevic, dr. Ljubisa – Djordjevic, Dr. Miroslav.

³⁸ Gjykata Supreme e Serbisë në aktvendimin e saj Kz-2105/57 nuk e ka cilësuar xhelozinë si motiv të ultë; gjithashtu Gjykata Supreme e Kroacisë në aktvendimin e saj Kz-2333/56 ka theksuar që xhelozia nuk paraqet motiv të ultë.

IV. Lëndët e caktuara gjyqtarëve të EULEX-it për shmangien e keqpërdorimit të drejtësisë

A. Lëndët që kanë të bëjnë me veprat e dukshme të motivuara etnike

Lënda Ap-Kz nr. 24/2010 Predrag Djordjević, Gjykata Supreme

Lloji i procedurës:	Ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë
Data:	4 maj 2010
Veprat penale:	I akuzuar me Nxitjen e Urrejtjes, e Përçarjes ose e Mos durimit Kombëtar, Racor, Fetar a Etnik dhe Tentim Vrasje e Rëndë, Nenet 115, paragrafi 1 dhe 3 si dhe neni 147, i lidhur me nenin 20 të KPK-së
Rezultati:	Ankesa e të pandehurit e refuzuar; ankesa e palës së dëmtuar (1) e hedhur poshtë si e paafatshme; ankesa e palës së dëmtuar (2) e pranuar; aktgjykimi i shkallës së parë pjesërisht i ndryshuar

Aktgjykim ka të bëjë me lëndën ku i pandehuri, serb nga qyteti i Uzhicës në Serbi, në orët e hershme të mëngjesit të 14 qershorit 2008 është ngjitur në xhaminë në qendër të Mitrovicës jugore dhe ka vendosur flamurin me simbole ortodokse serbe në ndërtesën religjioze islamike. Më vonë, i armatosur me thikë dhe revole, ai hyri në oborrin me rrethojë të stacionit policorë të Kosovës në Mitrovicën Jugore dhe nga distanca e afërt shtiu në policin e Kosovës duke e plagosur rëndë atë.

Në shqyrtimin e shkallës së parë para Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, i pandehuri është dënuar për të dy veprat e përmendura penale dhe është dënuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje 6 (gjashtë) vite dhe 3 (tre) muaj. Fillimisht ai gjithashtu ishte i akuzuar me veprën penale të Kryerjes së Veprave Terroriste sipas nenit 110, paragrafëve 1 dhe 2 të lidhura me nenin 109, paragrafin 1, pikat 2, 7 dhe 10 të KPK-së. Megjithatë, prokurori më vonë tërhoqi këtë akuzë dhe si pasojë ishte refuzuar nga gjykata e shkallës së parë. Ankesat ishin parashtruar nga mbrojtja dhe dy policëve që pretendonin statusin e palës së dëmtuar.

Aktgjykimi shtjellon lidhur me çështjen e heqjes dorë vullnetare të tentimit dhe mbi kërkesat e zbutjes së jashtëzakonshme të dënimit në pajtim me nenet 66, paragrafi 2 dhe nenit 67 të KPK-së.

Pasi që mbrojtja në ankesa ka pretenduar që i akuzuari nuk ka pasur paramendim për Vrasje të Rëndë, gjykata duhej të merrte parasysh problemin juridik të heqjes dorë vullnetare të tentimit (neni 22 i KPK-së). Ka gjetur që fakti se i akuzuari e ka pasur plumbin e dytë në revolen e tij të cilën ai nuk tentoi të shtijë nuk ishte i mjaftueshëm për të kundërshtuar në mënyrë të suksesshme dashjen tij për të privuar jetën e viktimës. Së pari, sjelljes së të pandehurit i mungonte elementi i vullnetshëm pasi që polici pothuajse menjëherë i ka kthyer të shtënat dhe duke e bërë këtë e përmbajti të akuzuarin. Gjithashtu, duke shtënë nga një distancë shumë e afërt në pjesën e trupit që përmban organet vitale dhe arteriet e brendshme e vendosi jetën viktimës në një rrezik të lartë e cila me asgjë nuk mund të kontrollohet nga kryesi i veprës. Kështu që tentimi ishte kryer me pasojë që ai duhet të merrte masa aktive për parandalimin e shfaqjes së pasojave (d.m.th: vdekjes së mundshme të viktimës) me qëllim të përfitimit nga dispozita e heqjes dore vullnetare. Megjithatë, asnjë veprim i tillë – si për shembull thirrja për ndihmë mjekësore – nuk është ndërmarr.

Gjykata sqaroi që sa i përket veprës penale Nxitja e Urrejtjes, e Përçarjes ose e Mosdurimit Kombëtar, Racor, Fetar a Etnik, polici i lënduar nuk ka pasur të drejtë të ankohet pasi që vepra penale nuk ishte vepër e drejtuar drejtpërdrejtë kundër atij ose drejtave të tija të mbrojtura me ligj.

Në lidhje me dënimin, gjykata pike mbështetet që nuk ka pasur arsye të mjaftueshme për të zbatoj zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit sipas nenin 66, paragrafit 2 dhe nenit 67 të KPK-së. Fakti që vepra penale ishte vetëm tentim ka rezultuar në zbutjen e dënimit në përputhje me nenin 65, paragrafit 2 të KPK-së dhe nuk mund të përdoret ndonjë herë tjetër për të arsyetuar zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit sipas nenit 66 të KPK-së. Sa i përket rrethanave tjera lehtësuese, siç është përmendura nga shkalla e parë, d.m.th: gjendja e tij e jo e ekuilibruar mendore dhe mungesa e dosjes së mëparshme penale, Gjykata Supreme e Kosovës mbështetet që bile edhe kombinimi i të tre faktorëve nuk do të ishte i jashtëzakonshëm për të arsyetuar zbatimin e nenit 66, paragrafit 2 të KPK-së.

Si pasojë gjykata sërish e llogariti dënimin, duke rezultuar në dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) viteve dhe 3 (tre) muajve.

B. Lëndët që përfshinë presionin politik dhe publik të gjyqësorit

Lënda Pkl-Kzz nr. 31/2010 Jeton Kiqina, Gjykata Supreme

Lloji i procedurës:	Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë
Data:	1 nëntor 2010
Veprat penale:	I pandehuri është dënuar me 5 (pesë) Vrasje të Rënda me Dashje dhe 1 (një) Tentim Vrasje e Rëndë, neni 30, paragrafi 1, paragrafi 2 pika 1 dhe para 3 i LPK-së në lidhje me nenet 19 dhe 22 të KP të RSFJ-së
Rezultati:	E refuzuar si e pabazuar

Kjo lëndë është paraqitur këtu sepse ka të bëjë me vitin 2001 me vrasjen hakmarrëse të ish policit gjatë regjimit të Millosheviqit së bashku me bashkëshorten e tij, djalin e tij dhe dy vajzat e tij. Vrasja me sa duket ishte mirë e planifikuar dhe ekzekutuar nga një grup i madhe i personave. Procedura lidhur me të pandehurin e tanishëm janë vetëm një prej disa lëndëve në pritje me të pandehur të shumtë lidhur me vrasjen e përmendur. Lëndët kanë tërhequr një vëmendje shumë të madhe të publikut. Disa manifestime publike dhe demonstrata ishin organizuar nga përkrahësit e të pandehurve me kërkesë për t'i liruar “ushtarët e lirisë” dhe të qëllimit që të paraqesin procedurat si një tentim për të diskredituar UÇK-në dhe ish pjesëtarët e saj e gjithashtu edhe qëllimit të shfaqjes së presionit ndaj gjyqësorit.

I pandehuri ishte i akuzuar dhe është shpallur fajtor për veprat penale të Vrasjes së 5 (pesë) personave në bashkëkryerje (neni 30, paragrafi 2 pikat 1, 3, 4, 5 të LPK-së në lidhje me nenet 22 dhe 24 të KP të RSFJ-së) dhe 1 (një) Tentim Vrasje në bashkëkryerje (neni 30, paragrafi 2 pikat 1, 3, 4, 5 të LPK-së në lidhje me nenet 19, 22 dhe 24 të KP të RSFJ-së). Avokati mbrojtës i të akuzuarit ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 3 dhjetor 2009.

Gjykata Supreme duhej të adresonte pretendimin e mbrojtjes që gjykata e shkallës së parë ka vendosur në përbërjen e parregullt të kolegjit. Ka vendosur që edhe pse KPPK-ja në nenin e saj 24 KCCP përcakton kolegji të përbërë prej pesë anëtarëve, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6³⁹, neni 2.1 si *lex specialis* ka prioritet. Sa i përket zëvendësimit të një anëtari të kolegjit në seancën e fundit dëgjimore të gjykimit të shkallës së parë ka përfunduar që mbrojtja ka qenë e informuar me rregull nuk ka ngritur asnjë kundërshtim lidhur me përbërjen e ndryshuar dhe ishte pajtuar në leximin e dëshmimeve të mëparshme. Gjykata gjithashtu ka hedhur poshtë pretendimet nga mbrojtja që dispozitivët e të dy aktgjykimeve të mëhershme ishin të pakuptueshme dhe se ato ishin bazuar në prova të papranueshme. Pretendimi nga mbrojtja që aktgjykimet në arsyetime nuk kanë përmbajtur fakte vendimtare lidhur me lidhjen shkakore në mes të veprimeve dhe pasojave dhe që *mens rea* e të pandehurit është refuzuar si e papranueshme për arsye se bie jashtë fushës së shqyrtimit në fazën e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Në këtë fazë gjykata mund të shqyrtoj vetëm shkelje të shfaqur të ligjit por jo edhe më tutje të korrigjoj përcaktimin e fakteve gjatë procedurave të mëparshme.

Si pasojë, Gjykata Supreme ka refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimet e mëparshme, duke e dënuar të pandehurin me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) viteve.

Lënda P. nr. 281/2007 Albin Kurti, Gjykata e Qarkut në Prishtinë

Lloji i procedurës:	Shkalla e parë
Data:	14 qershor 2010
Veprat penale:	Pika 1 e akuzës: Pjesëmarrja në Grup që Kryen Vepër Penale, neni 320, paragrafi 2 të KPK-së (Akuzë që më vënë është tërhequr nga Prokurori Publik) Pika 2 e akuzës: Pjesëmarrja në Grupin që Pengon Personat Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare, neni 318, paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së
Rezultati:	Pika e 3 e akuzës: Thirrja për Rezistencë, neni 319, paragrafi 1 i KPK-së (Akuza më vënë e tërhequr nga Prokurori Publik) Dënim i pjesshëm

³⁹ Rregullorja e UNMIK-ut mbi Emërimin dhe Shkarkimin nga detyra të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Ndërkombëtar, e datës 15 shkurt 2000, e ndryshuar me Rregulloret e UNMIK-ut nr.2000/34 dhe 2001/2.

Lënda është paraqitur si shembull për mungesë të rezistencës së gjyqësorit të Kosovës t'i përballoj presionit publik dhe politik. Për shkak të kësaj shqyrtimi gjyqësor ishte zvarritur për afro 6 (gjashtë) muaj. Lënda në mënyrë konstante fokusoï një sasi të madhe të interesimit të publikut.

Më 10 shkurt 2007, turma protestuese e organizuar nga lëvizja “Vetëvendosje” theu pengesat dhe kordonin e vendosur nga policët e Kosovës dhe të UNMIK-ut para Ndërtesës së Qeverisë në Prishtinë. Gjatë rrjedhës së ngjarjeve, dy protestues ndërruan jetë pasi që ata ishin qëlluar me plumba gome, të cilët gjoja se ishin shtënë në turmë nga forcat policore rumune. Në vitin 2007, një aktakuzë është ngritur kundër të pandehurit Albin Kurti, i cili ishte lider i lëvizjes “Vetëvendosje”.

UNMIK filloi shqyrtimin gjyqësor kundër të pandehurit, por i ndaloi të gjitha procedurat në shkurt të vitit 2008 pasi që nuk mund të gjendej asnjë avokat mbrojtës që dëshironte të mbroj Albin Kurtin. Në dhjetor të vitit 2008, lënda prej UNMIK-ut është transferuar tek EULEX-i.

Me 19 janar 2010 gjyqtari i EULEX-it ishte emëruar si Kryetar Kolegji së bashku me një gjyqtar tjetër të EULEX-it dhe një gjyqtari vendorë si anëtarë të kolegjit në lëndën penale kundër Albin Kurtit. Më 21 janar 2010, Kryetari i kolegjit lëshoi një urdhër për rifillimin e shqyrtimit gjyqësor që në të njëjtën kohë duke e emëruar avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare (*ex officio*). Më 9 shkurt 2010, pas 6 (gjashtë) tentimeve të pasuksesshme, Zyrtari Gjyqësor përfundimisht i dorëzoi thirrjet gjyqësore Albin Kurtit.

Me 15 shkurt 2010, filloi shqyrtimi gjyqësor kundër Albin Kurtit por i pandehuri dështoi të paraqitet dhe avokati mbrojtës refuzoi caktimin sipas detyrës zyrtare, duke kërkuar kështu që gjykata t' i liroj atë nga detyra e përfaqësimit të Albin Kurtit. Trupi gjykues refuzoi propozimin e avokatit dhe e shtyu shqyrtimin gjyqësor për datën 22 shkurt 2010.

Më 22 shkurt vazhdoi shqyrtimi gjyqësor dhe kolegji në përbërjen e pandryshuar, duke vërtetuar mungesën e të pandehurit lëshoi urdhër arrest, duke e shtyrë seancën për orën 12:30 të së njëjtës ditë. Para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari vendorë në mënyrë të papritur lëshoi gjykatën për arsye mjekësore dhe Kryetari i kolegjit pas rifillimit të shqyrtimit gjyqësor e shtyu seancën për datën 23 shkurt 2010. Në të njëjtën ditë, kryetari i kolegjit ishte informuar që për shkak të sëmundjes gjyqtari vendor mund të mos jetë në gjendje të paraqitet në shqyrtim gjyqësor siç ishte planifikuar. Prandaj, kryetari i kolegjit i dërgoi letër kryetarit të GJQ-së duke kërkuar nga ai që urgjentisht të caktoj zëvendësimin.

Më 23 shkurt, pak kohë para se të fillonte seanca e caktuar, dy gjyqtarë vendor refuzuar urdhrin nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut për zëvendësimin e anëtarit që mungonte të kolegjit. Për shkak të faktit që u bë e pamundur që mënyrë të suksesshme të përbëhej kolegji i nevojshëm, në orën 10:30 seanca dëgjimore u shty për datën 2 mars 2010. Ditën e ardhshme një gjyqtar tjetër vendor refuzoi emërimin si zëvendësim për anëtarin që mungonte në kolegji. Në mbledhjen vijuese me kryetarin e kolegjit të EULEX-it, kryetari konfirmoi mosdashjen e cilitdo gjyqtari të Gjykatës së Qarkut të marr pjesë si gjyqtar në gjykim. Më vonë ai vuri në pah se arsyet për refuzimet të gjitha korresponduan nga shqetësimi i gjyqtarëve vendorë që ta ekspozojnë veten në një gjykim aq të ndjeshëm. Kjo shpiu në një shtyrje tjetër të seancës dëgjimore për datën 13 prill 2010.

Më 8 prill 2010, Parlamenti i Kosovës mbajti një seancë për të diskutuar ngjarjet e 10 shkurtit 2007 që shpiu në vdekjen e dy protestuesve, gjatë së cilës është ngritur kërkesa për ndalimin e procedurave penale kundër Albin Kurtit. Parlamenti abstenoj nga lëshimi i vendimit në këtë çështje.

Me 12 prill, gjyqtari vendor që fillimisht ishte emëruar si anëtar i kolegjit u kthye nga pushimi mjekësor. Avokat i ri mbrojtës për të pandehurit ishte emëruar dhe me qëllim të dhënies së kohës për tu përgatitur për gjykim, seanca dëgjimore është caktuar sërish për datën 16 prill 2010. Në ditën e caktuar avokati mbrojtës deklaroi që ai nuk do të mund të vazhdoj mbrojtjen pasi që ai ka qenë i sulmuar nga aktivistët e “Vetëvendosjes” duke

gjuajtur vezë në ndërtesën e gjykatës dhe se familja e tij kishte pranuar kërcënime ditëve të fundit. Gjykimi përsëri është shtyrë për datën 19 prill dhe urdhër arresti i ri ishte lëshuar për të pandehurin.

Si pasojë, Kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës ishte emëruar si avokat mbrojtës plotësues sipas detyrës zyrtare. Megjithatë, asnjë nga avokatët mbrojtës, e as i pandehuri nuk ishin të pranishëm me datën 19 prill dhe me pohimin e Policisë së Kosovës për paaftësinë për të arrestuar të pandehurin.

Më 26 prill 2010, Policia e Kosovës bëri përpjekje për të arrestuar të pandehurin, i cili dihej se merr pjesë në funeral në Prishtinë. Tentimi dështoi dhe 3 policë të Kosovës ishin lënduar kur janë goditur nga vetura e të pandehurit. Edhe një seancë dëgjimore gjithashtu dështoi më 28 prill për shkak të mungesës së të pandehurit. Dështimi për të siguruar praninë e të pandehurit i cili me sa duket bile nuk tentonte të fshihej filloi të ngre dyshime lidhur me seriozitetin e tentimeve të Policisë së Kosovës për të arrestuar Albin Kurtin.

Përfundimisht, i pandehuri ishte arrestuar në befasi dhe shqyrtimi gjyqësor ishte mbajtur më 14 qershor 2010. Gjatë seancës, i pandehuri u deklarua që ai nuk do ta pranojë këtë “Gjykatë të EULEX-it”, të cilën ai e konsideronte vetëm si vazhdim të UNMIK-ut. Prokuroria që përfaqësohej nga prokurori vendor nga PSRK-ja e tërhoqi akuzën e parë dhe të tretë. I pandehuri përfundimisht është dënuar për Pjesëmarrje në Grupin që Pengon Personat Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare dhe është dënuar me 9 (nëntë) muaj burgim mirëpo ai është liruar menjëherë duke marrë parasysh kohën që tashmë e kishte kaluar në paraburgim.

C. Lëndët me vrasje

Lënda Ap-Kz nr. 190/2009 Shkumbin Mehmeti, Gjykata Supreme

Lloji i procedurave:	Ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë
Data:	27 janar 2010
Veprat penale:	I dënuar për 2 (dy) pika të akuzës së Vrasjes së Rëndë, 2 (dy) pika të akuzës për Tentim Vrasje të Rëndë në bashkëkryerje

Rezultati:	dhe 3 (tri) pikave të akuzës të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve, neni 30, paragrafi 2 pika 2 të LPK-së në lidhje me nenet 19, 22 të KP të RSFJ-së; nenit 8.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/7 ⁴⁰ në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së dhe nenit 328, paragrafit 2 të KPK-së Ankesat pjesërisht të aprovuara; aktgjykimi i shkallës së parë i ndryshuar
-------------------	--

Lënda kishte të bëjë me krim të rëndë duke përfshirë zënien në pritë të automjetit të Policisë së UNMIK-ut dhe vdekjen e policit ndërkombëtar dhe të policit të Kosovës si rrjedhojë e menjëhershme e trazirave të marsit të vitit 2004. Vendimi gjithashtu përmban vlerësimin e standardeve të gjyqimit të drejtë.

I pandehuri ishte akuzuar, disa ditë pas trazirave të marsit 2004, së bashku me tre persona të tjerë, ai sulmoi një veturë të policisë së UNMIK-ut me 4 (katër) anëtarë të ekipit të përzier kosovar/ndërkombëtar, dhe hapi zjarr nga armët automatike. Dy policë ishin vrarë, dhe dy pasagjerët tjerë janë plagosur. Sulmuesit rrëmbyen dy vetura me qëllim të largimit nga vendi i krimit.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë në shkallën e parë e ka shpallur të pandehurin fajtor për të gjitha akuzat dhe ka shqiptuar një dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) viteve. Dënimi kryesisht është bazuar në provat mbështetëse të siguruar nga përmbajtja e thirrjeve telefonike të përgjuara nga telefoni mobil i Mehmetit.

Gjykata Supreme konfirmoi që gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar me arsyetim të duhur faktik dhe ligjor të përgjegjësisë penale të të akuzuarit brenda fushës së aktakuzës, dhe që mungesa e provave të drejtpërdrejta *ipso facto* nuk përfshin që lënda duhej të vendosej *in dubio pro reo*, por që gjykata ligjërisht është e autorizuar të vlerësojë dhe të vendos nëse ka prova të mjaftueshme sekondare dhe mbështetëse (faktike) të cilat vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshëm që i akuzuari ishte fajtorë. Megjithatë, Gjykata Supreme ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë pasi që e ka marrë parasysh dënimin me

⁴⁰ Rregullorja e UNMIK-ut për Autorizimin e Mbajtjes së Armëve në Kosovë, e datës 21 shkurt 2001.

12 (dymbëdhjetë) vite burgim të shqiptuar më herët kundër Shkumbin Mehmeti për veprë tjetër penale nga aktgjykimi i plotfuqishëm siç është përfshirë në dënimin e vetëm unik me burg në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) viteve.

Për më tepër, Gjykata Supreme theksoi që objektet e sallës së gjykimeve në burgun e Dubravës ku gjykimi i shkallës së parë është mbajtur ka ofruar kushtet juridike të nenit 43 të KPPK-së dhe garanci për gjykim të drejtë dhe publik siç parashihet prej KEDNJ-së pasi që, *inter alia*, kontakti në mes të avokatit mbrojtës dhe të akuzuarit ishte garantuar, i akuzuari ishte në gjendje që në mënyrë efektive të ushtroj të drejtën e tij për mbrojtje, “ndryshimi i vendit të zhvillimit të gjyqit” në këtë sallë të gjykimit është arsyetuar në mënyrë të rregullt dhe ligjore dhe është lajmëruar paraprakisht si dhe përbërja e trupit gjykues ka qenë e ligjshme.

Lënda Api-Kzi nr. 1/2010 Shkumbin Mehmeti, Gjykata Supreme

Lloji i procedurës	Ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së dytë
Data:	26 nëntor 2010
Veprat penale:	I dënuar për 2 (dy) pika të akuzës të Vrasjes së Rëndë, 2 (dy) pika të akuzës për Tentim Vrasje të Rëndë, neni 30, paragrafi 2 pika 6) e LPK-së, në lidhje me nenin 19 dhe 22 të KP të RSFJ-së dhe 3 (tri) pikave të akuzës për Posedimin e Paautorizuar të Armëve sipas nenit 8.2. dhe 8.6. të Rregullores së UNMIK nr. 2001/7
Rezultati:	Ankesat e refuzuara, aktgjykimet e vërtetuara

Lënda⁴¹ ka të bëjë me një krim të rëndë (vrasje dhe vrasje në tentativë) menjëherë si pasojë e trazirave të Marsit 2004. Kjo kërkonte një analizë të legjislacionit në Kosovë si dhe të procedurës përkitazi me standardet e gjykimit të drejtë të garantuar me KEDNJ.

Gjykata Supreme si gjykatë e shkallës së dytë kishte ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë, duke mbështetur se dënimi unik i shqiptuar ndaj Shkumbin Mehmetit ishte 30 (tridhjetë) vjet burgim për dy pika të Vrasjes së rëndë dhe Vrasjes së rëndë në tentativë. Kishte vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket arsyetimit

⁴¹ Referencë Lënda Ap-Kz Nr. 190/2009 Shkumbin Mehmeti, Gjykata Supreme

faktik dhe ligjor që vërteton përgjegjësinë penale të Mehmetit duke u bazuar në provat e siguruar me anë të përgjimit të bisedave telefonike.

Gjykata Supreme si gjykatë e shkallës së tretë vërtetoi përmbushjen e standardeve për gjykim të drejtë me gjykimin në shkallë të parë duke specifikuar se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (tash e tutje PSSP) si autoriteti më i lartë i zbatimit të drejtësisë në Kosovë në atë kohë ka qenë autoriteti i duhur për aprovimin e mbajtjes së procedurës në Burgun e Dubravës.

Më tutje mbështet se legjislacioni në Kosovë përkitazi me përgjimin telefonatave si dhe përgjimet e tanishme të telefonatave të kryera gjatë hetimeve të kësaj lënde ishin në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), dhe si të tilla ishin prova tërësisht të vlefshme në këtë procedurë. Duke iu referuar vazhdimisht jurisprudencës së GJEDNJ-së lidhur me përgjimin e komunikimeve për qëllimet e hetimeve të policisë, Gjykata Supreme theksoi se sikur KPPK-ja ashtu edhe Rregulloret e UNMIK-ut ishin në përputhje me kushtet e praktikat gjyqësore përkatëse pasi që kjo rregullore i rregulloi në hollësi, *në mes tjera*, parakushtet për caktimin e masës, procedurën për kërkimin e urdhrit, natyrën, përmbajtjen, ndryshimin dhe vazhdimin e urdhrave dhe pranueshmërinë e provave të siguruar me anë të këtyre masave. Gjykata po ashtu nënvizoi se kolegji i shkallës së parë ka bërë kujdes të veçantë që mos të shkelë të drejtat e privacisë së të pandehurit në këtë lëndë.

Lënda Ap-Kz Nr. 128/2010 F. B., Gjykata Supreme

Lloji i procedurës:	Ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë
Data:	3 gusht 2010
Veprat Penale:	I akuzuar për Vrasje, Neni 146 KPK
Rezultati:	Dënim, vepra penale e ri-cilësuar

Kjo lëndë paraqitet në raport për shkak të argumentimeve të vlefshme faktike dhe ligjore në vendim përkitazi me barrën e provës, parimin *in dubio pro reo* dhe cilësimin ligjor të veprës penale.

E pandehura ishte i akuzuar, më 24 maj 2007 në shtëpinë e saj e pandehura femër qëllloi një fqinj të saj 3 (tri) herë me pushkë gjuetie, duke i shkaktuar vdekjen e tij.

Në shqyrtimin e parë gjyqësor gjykata e shkallës së parë kishte konsideruar se e pandehura kishte vepruar në vetëmbrojtje të domosdoshme (Neni 8 KPK) dhe e liroi të pandehurën nga akuza për vrasje, duke e dënuar atë vetëm për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Pas ankesës Gjykata Supreme ka prishur pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë dhe ka kthyer lëndën në shkallë të parë për rigjykim. Pasi kjo lëndë është marrë nga EULEX-i Gjykata e Qarkut në Pejë shpalli të pandehurën fajtoreshë për Vrasje dhe e dënoi atë me 10 (dhjetë) vjet burg.

E pandehura nuk e mohoi të ketë qëlluar viktimën. Megjithatë, ajo pohoi se përveç faktit se ai e kishte dhunuar atë disa herë më parë dhe e kishte kërcënuar ta dhunonte prapë, ai po e sulmonte atë me thikë kur ajo e qëlloi atë. Një thikë është gjetur pranë viktimës por pasi që asnjë gjurmë e gishtërinjve nuk u identifikua në të, nuk ishte e mundur të përcaktohej nëse viktima e kishte përdorë atë për ta kërcënuar apo sulmuar të pandehurën. Pohimi për dhunimet e mëhershme u kundërshtua nga anëtarët e familjes së viktimës së ndjerë me pretendimin e ai dhe e akuzuara kishin pasur një aferë dashurie të vullnetshme.

Gjykata Supreme në arsyetimin e vet së pari i diskutoi mangësitë e dispozitivit të aktgjykimin të shkallës së parë. Ajo gjeti se përmbajtja ishte e shkurtër sa i përket kushteve ligjore dhe i mungonte përshkrimi i fakteve, siç janë rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe paramendimi. Megjithatë, pasi që gjykata gjeti se provat e prodhuara në shkallë të parë ishin të mjaftueshme për të vërtetuar drejt gjendjen faktike ajo nuk pati nevojë të anulojë aktgjykimin e mëparshëm dhe të caktojë një rigjykim por veprimi në përputhje me Nenin 426, par 1 të KPPK-së, p.sh. ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke i vlerësuar ndryshe faktet materiale të përcaktuara. Duke vendosur kështu gjykata i dha një peshë të caktuar faktit se kjo lëndë ishte gjykuar më parë në shkallë të dytë 2 (dy) herë.

Gjykata është dashur ta vlerësojë nëse përshkrimi i ngjarjeve nga e pandehura ishte i besueshëm dhe i arsyeshëm (madje edhe pa prova për ta dëshmuar atë) dhe, nëse po, a ekzistonin prova, që lejonin të arrihej përfundimi përtej dyshimit të arsyeshëm se versioni i paraqitur nga e pandehura nuk ishte i vërtetë. Përndryshe barra e provës do të kalonte te e pandehura e cila do të duhej patjetër të dëshmonte pafajësinë e tij ose të saj. Gjykata gjeti se narrativi i paraqitur nga e akuzuara lidhur me ngjarjet, të cilat ndodhën para vrasjes, ishte i hollësishëm dhe i besueshëm kurse deklarata e dëshmitarit përkitazi me lidhje e pretenduar të dashurisë në mes të akuzuarës dhe viktimës së ndjerë nuk ishin të besueshme. Si pasojë, në zbatimin e parimit *in dubio pro reo* gjykata ndoqi pohimin e të akuzuarës se kishin ndodhur 2 (dy) episode të dhunës seksuale dhe kërcënimeve kundër saj nga viktima e ndjerë.

Gjykata u pajtua me shkallën e parë se e pandehura nuk mund të pretendojë vetëmbrojtje të domosdoshme. Ajo thekson se edhe nëse viktima ndoshta paska hyrë në objektin e të akuzuarës pa leje, e akuzuara kishte marrë pushkën e gjuetisë nga dhoma e gjumit, e kishte mbushur atë dhe pastaj shkoi te viktima edhe pse bashkëshorti i saj dhe vjehrra e saj ishin të pranishëm aty pranë. Kjo nuk ishte një situatë ku do të mund të vërtetohej një sulm i pashmangshëm i viktimës kundër të akuzuarës.

Kolegji më tutje gjeti se veprimi i të pandehurës tregonte elemente të Vrasjes së kryer në gjendje të afektit mendor në përputhje me Nenin 148 të KPK-së. Viktima e kishte detyruar atë 2 (dy) herë të ketë marrëdhënie seksuale kundër dëshirës së saj; ai e ishte fotografuar trupin e zhveshur të saj, e kishte kërcënuar atë se do ta publikonte në internet në rast se ajo e lajmëronte atë. Përveç kësaj, viktima e kishte kërcënuar atë se do t'ia bënte të njëjtën gjë edhe vajzës së saj. Në ditën kritike e tërë kjo u grumbullua në një gjendje të afektit mendor në momentin kur viktima nuk iu bind urdhrat të saj që ai të largohej nga shtëpia e saj. Gjykata gjeti shenja të gjendjes së tillë të veçantë mendore në sjelljen e të pandehurës gjatë dhe pas kryerjes së krimit.

Gjykata si rezultat i kësaj pranoi pjesërisht ankesën në emër të së pandehurës dhe me ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së parë e shpalli të akuzuarën fajtores për Vrasje të

kryer në gjendje të afektit mendor. Ajo u dënua – duke përfshirë edhe dënimin përfundimtar për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve – me një dënim unik me 4 (katër) vjet burgim. Ankesa e palës së dëmtuar u refuzua si e pabazuar.⁴²

Lënda P. Nr. 32/2009 Radivoje Virijević, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë⁴³

Lloji i procedurës:	Shkalla e parë
Data:	22 prill 2010
Veprat Penale:	I akuzuar për Vrasje të rëndë dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve
Rezultati:	Dënim, vepra penale e ri-cilësuar

Kjo lëndë është përfshirë pasi që është një shembull për shumë lëndë të “zakonshme” të Vrasjes që posaçërisht gjyqtarët e EULEX-it në gjykatën në Mitrovicë duhet t’i trajtojnë për shkak të mosfunksionimit të pjesshëm të gjykatave vendore.

I pandehuri u akuzua se gjersa ishte duke vozitur veturën tij më 20 qershor 2008 në një fshat të komunës së Zveqanit e ka qëlluar viktimën e ndjerë me pushkë të modelit AK-47 dhe ka vrarë atë.

Gjykata vërtetoi se bashkëshortja e të akuzuarit kishte pasur një aferë jashtëmartesore me viktimën e ndjerë për 8 vjet, prej vitit 2000 deri më 6 qershor 2008. Pas përfundimit të

⁴² Dy anëtarë të kolegjit në mendimet e tyre pjesërisht mospajtuese nuk pajtohen me përfundimin se dispozitivi përmbante mangësi të shumta. Të dy mendimet argumentojnë se dispozitivi është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban së paku elementet esenciale të kërkuara me ligj. Përveç kësaj, me arsyetimin e dhënë në aktgjykim vendimi i vetëm i mundshëm për Gjykatën Supreme do të kishte qenë anulimi i aktgjykimit të shkallës së parë dhe kthimi i lëndës për rigjykim. Si pasojë e kësaj gjyqtarët konsiderojnë se arsyetimi i aktgjykimit në fjalë është kontradiktor. Për më tepër, një anëtar i kolegjit nuk u pajtua as me cilësimin juridik të veprës penale si Vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor. Mendimi përkatës mospajtuës shtjellon se një pohim i thjeshtë i “afektit mendor” nuk ishte i mjaftueshëm dhe se mbrojtja kishte obligim të siguronte prova për rrethanat lehtësuese nga Neni 148 i KPK-së. Një barrë e tillë e provës nuk mund të konsiderohet si në kundërtënie me Nenin 6 të KEDNJ-së.

⁴³ I bashkakuzuari ishte i mitur. Informatat lidhur me këtë të akuzuar nuk janë përfshirë për shkak të mbrojtjes së të dhënave personale.

lidhjes viktimë e ndjerë kishte filluar t'i dërgojë porosi tekstuale gruas së të akuzuarit në telefonin e saj duke e shtrënguar atë t'i kthehej atij, duke e kërcënuar atë me vdekje dhe duke e sharë bashkëshortin e saj – të akuzuarin. Pasi i pandehuri e vërejti se gruaja e tij ishte shqetësuar nga këto porosi ajo i tregoi atij rreth aferës së saj të kaluar dhe ai ia morri asaj telefonin. Mes datës 6 qershor 2008 dhe ditës së vrasjes viktimë e ndjerë kishte dërguar 71 porosi tekstuale në telefonin mobil të gruas së të akuzuarit, shumë prej tyre përmbanin kërcënime për jetën e saj. I akuzuari gjatë asaj kohe kërkoi dy herë nga viktimë e ndjerë të ndalojë së dërguari porosi kërcënuese (një herë përmes dy kushërinjve të cilët biseduan me viktimën dhe një herë përmes eprorit të viktimës, komandantit vendor të policisë). Në të dyja rastet këta persona iu qasën viktimës por pa sukses dhe porositë kërcënuese vazhduan.

Në mbrëmjen e vrasjes familja e të pandehurit kishte për vizitë vajzën e tij dhe burrin e saj. Kur ata shkuan, rreth orës 22.30, e bija i tregoi të akuzuarit se ajo po të njëjtën ditë nga viktimë e ndjerë kishte pranuar një porosi për nënën e saj, me kërcënim se do ta vriste. Sipas dëshmisë së të pandehurit atëherë atij “i humbi mendja tërësisht”. Ai doli nga shtëpia, morri pushkën nga hangari i tij dhe shkoi këmbë deri te shtëpia fqinje e viktimës së ndjerë. Kur ai e pa duke u afruar te shtëpia e tij në veturën e tij i pandehuri hapi zjarr me armë automatike deri sa u zbraz karikatorit.

I pandehuri e pranoi se e kishte vrarë viktimën e ndjerë. Të gjitha ato fakte ishin vërtetuar duke u bazuar në dëshmitë e qarta, të qëndrueshme dhe vërtetuese të disa dëshmitarëve dhe dy të akuzuarve. Prandaj gjykata i konsideroi ato të besueshme.

Si dëshmi plotësuese u dëgjua edhe një psikolog si dëshmitar ekspert mbi gjendjen mendore të të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale. Bazuar në dëshminë e saj gjykata gjeti se vepra penale duhej të cilësohej si Vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor sipas Nenit 148 të KPK-së. I pandehuri kishte pësuar stres të rëndë kur kishte kuptuar për lidhjen tetë vjeçare të gruas së tij me viktimën e ndjerë – me një fqinj dhe shok të ngushtë të ciklin e kishte ndihmuar me vite sepse familja e viktimës kishte qenë e zhvendosur nga Kosova qendrore. Mirëpo, ai kishte vendosur t'ia falte gruas së tij. Pas

kësaj stresi i tij ishte grumbulluar dhe gradualisht ishte rritur prej porosive që viktimat e ndërë vazhdonte t'i dërgonte, duke e sharë atë dhe kërcënuar jetën e gruas së tij. Të gjitha tentimet e tij për ta lehtësuar situatën në mënyrë paqësore kishin dështuar. Në ditën kritike, pas pranimit të ofendimeve të reja më të mëdha nga viktimat dhe pasi morri vesh se edhe e bija e tij kishte pranuar porosi kërcënuese stresi i grumbulluar rezultoi me një gjendje të shokut të rëndë që afektoi vetëdijen dhe arsyen e të pandehurit. Në këtë gjendje ai e kreu vrasjen.

Si pasojë e kësaj gjykate e dënoi të pandehurin për Vrasje të kryer në gjendje të afektit mendor dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve me dënim unik me 7 (shtatë) vjet burgim. Në caktimin e dënimit gjykata, në mes fakteve tjera, morri parasysh se i akuzuari kishte pranuar vrasjen dhe kishte pranuar fajësinë për veprën Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve.

Kapitulli 3: Gjykimi i lëndëve civile (rastet studimore dhe statistikat)

Ky kapitull fokusohet në aktivitetet e kryera nga gjyqtarët civilë të EULEX-it në gjykatat e rregullta të Kosovës brenda kompetencave të tyre sekondare ekzekutive. Lëndët e zgjedhura janë të klasifikuara në mënyrë tematike. Një pjesë i përkushtohet Kolegjit për Ankesa të Gjykatës Supreme të Kosovës i AKP-së.

Sipas Ligjit mbi Kompetencat Nenit 5 një gjyqtar civil i EULEX-it mund të merr vetëm një lëndë të re apo të pazgjidhur civile që ka të bëjë me pronën,⁴⁴ përfshirë fazën e ekzekutimit, nëse vendimi është marrë nga Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it dhe nëse janë plotësuar njëri apo disa nga këto kushte: 1) ekziston dyshimi i

⁴⁴ Asambleja e Nëntë e Gjyqtarëve të EULEX-it e mbajtur më 11 mars 2010 miratoi një rekomandim që të interpretojë shprehjen 'lëndët civile që lidhen me pronën' nën Nenin 5.1. c) të Ligjit mbi Kompetencat siç vijon:

Lëndët me patundshmëri dhe ato të 'përziera', kudo ku ka kontestim të së drejtës *in rem* (që ka të bëjë me statusin dhe përcaktimin e pronës), të drejtës së banimit dhe të drejtave të tjera të pronës shoqërore apo shtetërore, dhe kërkesat për kompensim të bazuara në shkeljen apo humbjen e një prej të drejtave të lartpërmendura apo në pengimin e paligjshëm në realizimin e një të drejte të tillë. Versionin e plotë të Rekomandimit (Aneksi I i Asamblesë së nëntë të Gjyqtarëve të EULEX-it, 11 mars 2010) mund ta gjeni në faqen e internetit të EULEX-it <http://www.eulex-kosovo.eu/en/justice/assembly-of-the-eulex-judges.php>

- bazuar i përpjekjeve për të ndikuar në paanësinë apo pavarësinë e gjyqësorit vendor; apo
- 2) ekziston dyshimi i bazuar se gjyqësori vendor nuk është i gatshëm apo është i paafhtë që ta shqyrtojë lëndën siç duhet; apo
 - 3) ekziston dyshimi i bazuar në shkeljen serioze të zhvillimit të drejtë të procedurës.

Lëndët përzgjidhen nga gjyqtarët civilë të EULEX-it në rajonet përkatëse në përputhje me modalitetet e themeluara në Udhëzimet për përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të miratuara nga Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it. Kjo mundëson një procedurë objektive dhe transparente që pajtohet me parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit.

Shumica e lëndëve civile të trajtuara nga gjyqtarët civilë të EULEX-it gjatë vitit 2010, ishin lidhur me prona të kontestuara që rrjedhin nga konflikti i vitit 1999. Shpesh i pranishëm është aspekti ndëretnik në këto lëndë pasi që kthimi i personave të zhvendosur përbrenda shpesh has në uzurpimin e jashtëligjshëm të pronave të tyre apo edhe shitjen e tyre të bëra me mashtrim. Këtë e komplikon edhe më shumë fakti se shumë pronarë të tanishëm kanë blerë pronën e tyre duke mos qenë të vetëdijshëm për faktin se shitblerja është kryer pa pëlqimin e pronarit të ligjshëm. Kundër kësaj prapavije ekziston rreziku se këto lëndë mund të ndezin një tension social dhe ndëretnik. Kjo ka kontribuar në disa raste në mosdashjen/ngurrimin nga gjyqësori Kosovar për të reaguuar, që ka pasuar me një ngarkesë së madhe të lëndëve që janë në pritje të aktgjyqimit të formës së prerë. Kjo është e dukshme veçanërisht në komunitete të vogla të goditura rëndë nga konflikti. Megjithatë, duhet po ashtu të nënvizohet se edhe numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve civilë të Kosovës ka kontribuar në prapambetjen e vendimeve dhe procedurat e gjata në lëndët civile.

Disa faktorë lidhur me kornizën legjislative apo praktikave në gjykatat e Kosovës mund ta pengojnë zbatimin e duhur të drejtësisë në çështjet civile: vështirësitë përkitazi me ligjin në fuqi; natyra komplekse e lëndëve që vijnë nga situatat e para dhe/ose pas konfliktit; përdorimi i tepërt i mekanizmave procedurale siç janë procedura e rigjyqimit

dhe pezullimi i procedurës së ekzekutimit; njoftimi praktik i palëve në procedurë që jetojnë jashtë Kosovës.

Sipas ligjit të procedurës në fuqi në Kosovë, në nivel të Gjykatës Komunale të shkallës së parë vetëm një gjyqtar vendos mbi çështjet lidhur me kontestin civil. Lëndët në shkallë të dytë gjykohen nga një kolegji prej tre gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut. Në gjykatën Supreme mund të paraqitet kërkesë për rishikim. Pas lëshimit të vendimit për një lëndë të caktuar, kjo lëndë dërgohet në gjykatën kompetente Komunale për ekzekutim.⁴⁵

I. Kolegji për Ankesa i Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Pronës

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10 vuri themelin për krijimin e Kolegjit Ankimor të Gjykatës Supreme për lëndët pronësore të lidhura me konfliktin.⁴⁶ Kolegji për Ankesa është dashur të përbëhet prej gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe vendorë por më vonë është pezulluar⁴⁷ dhe Kolegji për Ankesa i AKP-së u themelua me mandatin për të vendosur mbi ankesat kundër vendimeve të Komisionit Kosovar për Kërkesa Pronësore (tash e tutje KKKP) përgjegjëse për gjykimin e kërkesave të pranuar nga AKP-ja. Dy gjyqtarë civilë të EULEX-it u caktuan në nëntor 2008, por kolegji nuk ishte tërësisht në gjendje pune pasi që i mungonte anëtari i tretë Kosovar i kolegjit. Më 22 tetor 2010, u emërua një Gjyqtar i Kosovës i cili i mundësoi kolegjit të kryejë funksionin e vet ekzekutiv. Pas

⁴⁵ Shih në mes tjera Nenin 15 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore të datës 30 qershor 2008; për ekzekutimin e vendimit, shih në mes tjera Nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-008 mbi procedurën përmbarimore të datës 2 qershor 2008

⁴⁶ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/10 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të datës 4 mars 2006. Kjo Rregullore e vendos AKP-së përgjegjëse për të pranuar, regjistruar dhe për të ndihmuar gjykatat në zgjidhjen e kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, si pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, si (kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore).

⁴⁷ Kolegji për Ankesa u pezullua në tetor 2006 me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar më vonë me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave Lidhur me Pronën E Paluajtshme Private, Duke Përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale në qershor 2008.

këtij emërimi 8 (tetë) lëndë do të përpunohen menjëherë dhe do të merret vendim. Prej vitit 2009 dymbëdhjetë ankesa janë përcjellë nga AKP-ja në Kolegjin për ankesa të AKP-së. Në shumicën e këtyre rasteve kolegji është dashur të lëshonte urdhra për të verifikuar nëse këto kërkesa ishin njoftuar me kohë sipas ligjit dhe/ose për të kuptuar pse parashtruesit a ankesave nuk i kanë respektuar afatet kohore të përcaktuara me ligj.

Gjatë vitit 2010, gjatë pritjes së emërimit të Gjyqtarit Kosovar, gjyqtarët e EULEX-it të Kolegjit për Ankesa të AKP-së themeluan kornizën administrative të nevojshme për ta bërë kolegjin operativ. U arrit marrëveshje si të ruhen dosjet si dhe mbi procedurat që do të përdoren kur kolegji t'i pranojë ankesat. Me ndihmën e Shefit të Shkrimores së AGJE-së u krijua një sistem i skedimit, përfshirë të gjitha lëndët. Përveç kësaj, gjyqtarët e EULEX-it të Kolegjit për Ankesa të AKP-së përpiluan dhe vazhdimisht e përditësojnë listën e legjislacionit lidhur me pronën që mbulon periudhën kohore prej vitit 1945 deri më tani.

II. Lëndët lidhur me Pronën

Në pjesën vijuese, prezantohet një përmbledhje me historikun e lëndëve⁴⁸ të trajtuara nga Gjyqtarët Civilë të EULEX-it në mbarë Kosovën më 2010, bashkë me rezultatet dhe arsyet e marrjes së lëndëve nga EULEX-i. Të gjitha lëndët e prezantuara ilustrojnë çështje ligjore komplekse dhe të ndjeshme dhe vendimet e marra nga gjyqtarët civilë të EULEX-it japin kontributin e vet në themelimin e jurisprudencën përkatëse, e cila e përmirëson sistemin gjyqësor të Kosovës.

Rrethanat e veçanta në Mitrovicë

Gjyqtarët civilë të EULEX-it, të caktuar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, vepruan si gjyqtarë penalë me gjykimin e lëndëve më urgjente që kishin të bëjnë me paraburgimin e të pandehurve. Gjatë vitit 2010 gjersa vepronin si gjyqtarët EULEX-it në Mitrovicë ata pranuan përafërsisht 50 parashtresa/kërkesa lidhur me çështje civile, shumica prej të

⁴⁸ Aktgjykimet e lëshuara nga gjyqtarët civilë të EULEX-it gjenden në faqen e internetit të EULEX-it: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/judgments/index.php>

cilave kanë të bëjnë me konteste pronësore. Gjendja në Kosovën veriore i ndalon gjyqtarët e EULEX-it të gjykojnë lëndët civile. Këto parashtresa i referohen lëndëve në pritje të vendimeve pasi që gjykatat në veri janë jofunksionale.

A. Lëndët e dëbimit

Lënda E. Nr. 393/08 Shoqata e Gjuetarëve “Drenusha” kundër Komunës së Vitisë, Gjykata Komunale në Viti (Rajoni i Gjilanit)⁴⁹

Lënda: urdhër për dëbim dhe lirim të objektit Lloji i procedurës: ekzekutim
--

Lënda e parë që përfshin Shoqatën e Gjuetarëve “Drenusha” dhe debitorin Komunën e Vitisë përmbledh dy dëbime. Kjo lëndë duhet të krahasohet me lëndët tjera që përfshijnë Komunën e Vitisë të cilat janë vlerësuar si të ndjeshme për shkakun e përfshirjes së Komunës, një institucioni publik të fuqishëm. Intervenimi i gjyqtarëve civilë të EULEX-it prandaj ishte konsideruar si i domosdoshëm për shkak të mosgatishmërisë së gjyqësorit të Kosovës për zbatimin e urdhrave të gjykatës.

Më 3 nëntor 2008, një Gjyqtar i Kosovës i Gjykatës Komunale në Viti lëshoi një urdhër Komunës të lirojë pronën kontestuese brenda 20 (njëzet) ditëve. Mirëpo ky urdhër nuk u respektua dhe uzurpimi i paligjshëm vazhdoi. Gjyqtarët e EULEX-it morën këtë lëndë për të garantuar ekzekutimin e vendimeve të marra nga gjyqtarët e Kosovës.

Dëbimi i parë u caktua dhe u ekzekutua gjatë verës 2009. Megjithatë, Komuna e uzurpoi prapë ndërtesën pas pak kohe. Më 19 mars 2010, gjyqtarët civilë të EULEX-it lëshuan një urdhër për ri-dëbimin e komunës nga objekti. Dëbimi u caktua për datë 6–7 prill ku Policia e Kosovës kishte për detyrë të ndihmojë në zhvendosjen e tërë stafit dhe pajisjeve. Me qëllim të shmangies së turmave të mëdha gjatë operacionit gjyqtarët e EULEX-it caktuan dëbimin për ditën e shtunë dhe të diel. Shumë shpejt u bë e qartë se Kryetari i

⁴⁹ Shih referencën: Lënda C.nr. 66/09 Komuna e Vitisë kundër Shoqatës së Gjuetarëve “Drenusha”, Gjykata Komunale në Viti (Rajoni i Gjilanit)

Komunës kishte urdhëruar të hapen shkollat dhe i tërë stafi të jetë i pranishëm në objekt për të “pastruar ambientin”. Gjatë natës së 5 - 6 prillit 2010, disa individë të maskuar rrëmbyen rojat, hynë në objekt dhe vendosën eksploziv brenda ndërtesës. Shpërthimi shkatërroi pjesërisht ndërtesën por dëbimi u ekzekutua në rrënojat e ndërtesës.

B. Lëndët e pronësisë

Lënda C. Nr. 66/09 Komuna e Vitisë kundër Shoqatës së Gjuetarëve “Drenusha”, Gjykata Komunale në Viti (Rajoni i Gjilanit)

Lënda: kërkesë pronësore Lloji i procedurës: procedurë kontestimore
--

Kjo lëndë ka të bëjë me kërkesa lidhur me pronë të kontestueshme të paraqitura nga Komuna e Vitisë, kundër Shoqatës së Gjuetarëve “Drenusha”. Kjo ishte vlerësuar si veçanërisht interesante për faktin se fillimisht kjo pronë ishte e regjistruar në emër të NSH por është pohuar se i përket Komunës pas konfliktit të vitit 1999 bazuar në një vendim komunal.

Seanca e fundit e shqyrtimit gjyqësor u mbajt më 26 shkurt 2010. Më 19 mars 2010 një gjyqtar civil i EULEX-it në Gjykatën Komunale të Vitisë, refuzoi kërkesën pronësore të paraqitur nga Komuna. Është paraqitur ankesë ndaj kësaj lënde në Gjykatën e Qarkut në Gjilan por kolegji prej një gjyqtari të Kosovës dhe dy gjyqtarëve civilë të EULEX-it vërtetuan aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.⁵⁰

Lënda C. Nr. 66/09 Komuna e Vitisë kundër Shoqatës së Gjuetarëve “Drenusha”, Gjykata Komunale në Viti (Rajoni i Gjilanit)

Lënda C. Nr. 328/09 Komuna e Vitisë kundër AKP, Gjykata Komunale në Viti (Rajoni i Gjilanit)

Lënda: kërkesë pronësore Lloji i procedurës: procedurë kontestimore
--

⁵⁰ Lënda AC.nr.170/10, Gjykata e Qarkut në Gjilan

Lënda e fundit ku përfshihet Komuna e Vitisë nuk lidhet me lëndët e lartpërmendura. Gjyqtarët civilë të EULEX-it e konsideruan këtë lëndë të ndjeshme pasi që ekzistonte dyshim i bazuar se gjyqësori i Kosovës nuk ishte i gatshëm të merrej me këtë lëndë për shkak të përfshirjes së Komunës dhe prandaj e morën lëndën përsipër pasi arriti në nivelin e ankesës.

Në këtë lëndë AKP-ja paraqiti kërkesë në gjykatën komunale për të përcaktuar të drejtën pronësore në mes AKP-së dhe Komunës së Vitisë. Gjykata Komunale e shpalli vetveten jokompetente për ta gjykuar këtë kërkesë dhe deklaroi se lënda është në kompetencë të DHPGJS-së.⁵¹ Ky vendim u anulua nga gjyqtarët civilë të EULEX-it⁵² dhe lënda u dërgua në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.⁵³ Lënda u përfundua në shtator pas dy seancave të rigjykimit nga ana e një Gjyqtari të Kosovës dhe paraqet një shembull të mirë të bashkëpunimit në mes gjyqtarëve të EULEX-it dhe të Kosovës.

Lënda C. Nr. 973/08, Gjykata Komunale në Pejë (Rajoni i Pejës)

Lënda: Vërtetim i pronësisë

Lloji i procedurës: procedurë kontestimore

Në këtë lëndë, paditësja, me përkatësi etnike Serbe, paraqiti kërkesë për vërtetimin e pronësisë dhe rrjedhimisht edhe një kërkesë për kompensim të dëmit.

Paditësja deklaroi se pronari i ri i NSH të privatizuar refuzoi që ajo të hyjë në pronës e saj që gjendet të oborrin e asaj ndërmarreje. Gjyqtari civil i EULEX-it, me shërbim në Gjykatën Komunale në Pejë e konsideroi jokompetente këtë gjykatë për t'u marrë me këtë lëndë prandaj e dërgoi lëndën në DHPGJS për procedurë të mëtutjeshme. Duke vepruar kështu gjyqtari i EULEX-it e kuptoi se gjykatat e Kosovës në përgjithësi nuk

⁵¹ Shih në mes tjera Nenin 4 dhe Nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.

⁵² Lënda AC. Nr. 351/09, Gjykata e Qarkut në Gjiilan

⁵³ Lënda C. Nr. 104/2010, Gjykata Komunale në Viti

veprojnë në përputhje me dispozitat Ligjit të procedurës kontestimore.⁵⁴ Ishte e qartë se gjykatat e Kosovës mbyllën lëndët dhe i udhëzuan palët të paraqesin kërkesa të reja në OVGJS. Kjo praktikë buron prej një vendimi për t'i refuzuar shkresat e lëndëve prej gjykatave të konsideruara si jokompetente, të marra nga GJS më 2004.

Pas takimeve me Kryetarin e DHPGJS-së ishte vërtetuar se nuk ishin zbatuar dispozitat e atij ligji. Rrjedhimisht Ekipi i Gjyqtarëve të EULEX-it zhvilloi për së afërmi monitorim, udhëzim dhe këshillim me të gjithë gjyqtarët e pesë Gjykatave Komunale në Pejë me qëllim të korrigjimit të kësaj praktike çorientuese.

Lënda AC. Nr. 623/09, Gjykata e Qarkut në Prizren

<p>Lënda: pengim i pronësisë mbi pronën Lloji i procedurës: procedurë kontestimore</p>
--

Kjo lëndë i referohet një padie pronësore të para-luftës mbi patundshmërinë ku një Serb pretendon se ka qenë pronar i ligjshëm që prej vitit 1993. Kjo lëndë e pazgjidhur vendosi në qendër të vëmendjes këtë çështje interesante ligjore, se a ka kompetencë një gjykatë e rregullt civile në Kosovë për të vendosur mbi paditë që kanë të bëjnë me uzurpimin e jashtëligjshëm të pronës. Me këtë u ngrit çështja e kompetencës së Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB)⁵⁵ dhe gjykatave të Kosovës mbi çështjet e pronësisë së patundshmërive të tilla.

⁵⁴ Neni 23 i Ligjit të procedurës kontestimore thotë se nëse gjykata e konsideron veten jokompetente ajo duhet ta dërgojë lëndën në gjykatë kompetente brenda tri ditësh. Padia hedhet poshtë vetëm në rast se gjykata gjen se një tjetër organ shtetëror ka kompetencë mbi atë padë.

⁵⁵ Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 e datës 15 nëntor 1999 themeloi Drejtorinë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DPB) dhe Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) për të gjykuar kërkesat e personave fizikë, pronësia, posedimi ose e drejta e banimit në pronën e patundshme banesore të të cilëve u është revokuar pas datës 23 Mars 1989 në bazë të legjislacionit i cili është diskriminues si në zbatim ashtu edhe në qëllimet e tij; kërkesat e personave fizikë që kanë bërë transaksione jozyrtare me prona të patundshme banesore në bazë të vullnetit të lirë të palëve pas datës 23 mars 1989; kërkesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit në pronën banesore para datës 24 Mars 1999, e që tani nuk kanë atë pronë në posedim, dhe kur e drejta e pronësisë nuk është transferuar vullnetarisht; shih në mes tjera Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60 të datës 31 tetor 2000 mbi kërkesat pronësore banesore dhe Rregullat e Procedurës dhe Evidencës së Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.

Në vitin 2002 është paraqitur një kërkesë ku thuhet se një Shqiptar i Kosovës kishte zaptuar në mënyrë të jashtëligjshme pronën dhe kishte filluar ndërtimin. Në vitin 2005, KKBP lëshoi një vendim me urdhër që ajo pronë duhet t'i kthehet paditësit, si pronar i ligjshëm.

Në tetor 2009 Gjykata Komunale në Prizren e refuzoi këtë kërkesë, duke e shpallur të papranueshme pasi që gjykatat e rregullta nuk ishin kompetente të merren me lëndë të tilla. Gjykata Komunale prandaj konsideroi se kjo padi bie nën kompetencë ekskluzive të KKBP-së. Më 19 shkurt 2010, kolegji me përbërje shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prizren përfundoi se çështjet që kanë të bëjnë me pronësinë bien nën kompetencë ekskluzive të KKBP-së, dhe në këtë mënyrë vërtetoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Megjithatë, kjo padi specifike ishte lidhur me pengimin e pronësisë mbi pronën, e jo lidhur me çështjen e posedimit. Prandaj u arrit përfundimi se kjo lëndë do të mund të trajtohej nga gjykatat e rregullta të Kosovës. Gjykata e Qarkut në vendimin e saj e anuloi vendimin e Gjykatës Komunale dhe ktheu lëndën në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim.

Lënda Ac. Nr. 88/2010, Gjykata e Qarkut në Prizren

Lënda: vërtetimi i pronësisë bë pronës së patundshme Lloji i procedurës: procedurë kontestimore
--

Lënda në vijim po ashtu i referohet një kërkesë për verifikim të pronësisë në Gjykatën e Qarkut në Prizren. Filloi në vitin 2001 dhe, siç do të përshkruhet më poshtë, është kthyer dy herë në Gjykatën Komunale për rigjykim. Në prill 2010, gjyqtarët civilë të EULEX-it në Gjykatë të Qarkut morën këtë lëndë përsipër pasi që ishte në pritje të vendimit të formës së prerë për nëntë vjet dhe se ishin monitoruar disa shkelje substanciale të procedurës që tregonin se Gjyqësori i Kosovës nuk ishte i gatshëm të merrej më këtë lëndë. Kjo lëndë po ashtu nënvizon çështjen e lënies pothuaj sistematike anash të lëndëve të zakonshme në Kosovë, duke rritur ngarkesën e madhe të lëndëve civile.

Në vitin 2001 paditësi, një Shqiptar i Kosovës, deklaroi se një pjesë e tokës së tij ishte uzurpuar në mënyrë joligjore nga ana e të paditurit dhe kërkoi që Gjykata Komunale të

vërtetojë pronësinë. Në dhjetor 2001, Gjykata Komunale vendosi se paditësi ishte pronari i ligjshëm i pronës dhe kështu urdhëroi të paditurin, po ashtu Shqiptar i Kosovës, që ta dorëzojë atë. Ndaj këtij vendimi është paraqitur ankesë dhe vendimi i Gjykatës Komunale u anulua nga Gjykata e Qarkut në Prizren në dhjetor 2004. Lënda u kthye për rigjykim dhe në tetor 2004 Gjykata Komunale vërtetoi vendimin e tyre duke pohuar se paditësi ishte pronari i ligjshëm. Prapë pas ankesës në qershor 2006 Gjykata e Qarkut e anuloi vendimin e Gjykatës Komunale dhe e ktheu lëndën për rigjykim për herë të dytë. Në janar 2010 Gjykata Komunale lëshoi vendimin e tyre të tretë duke vërtetuar pronësinë e paditësit, dhe duke pohuar se të paditurit duhet ta dorëzojnë pronën e uzurpuar, dhe të paguajnë kompensim për uzurpimin joligjor të pronës.

Në nëntor 2010 një kolegji i Gjykatës së Qarkut në Prizren me përbërje shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it lëshoi një aktgjykim të formës së prerë që refuzon ankesën e të paditurve të muajit shkurt 2010 dhe vërtetoi aktgjykimin e lëshuar nga Gjykata Komunale në Suharekë pasi që u konstatua se gjykata e shkallës së parë kishte vërtetuar drejt dhe kishte zbatuar drejt ligjin material.

C. Kontratat

Lënda C. Nr. 194/06, Gjykata Komunale në Istog (Rajoni i Pejës)

Lënda: Anulim i kontratës së blerjes Lloji i procedurës: procedurë kontestimore
--

Lënda në vijim ka të bëjë me anulimin e kontratës së shitblerjes për një pronë në Komunën e Istogut. Lënda ishte e vlerësuar si e ndjeshme dhe rrjedhimisht është marrë nga gjyqtarët civilë të EULEX-it pasi që kontesti përfshinte palët me prejardhje të ndryshme etnike që ishte e pazgjidhur me vite. Kjo lëndë po ashtu paraqet një problem interesant gjyqësor të zakonshëm në Kosovë.

Të paditurit, Shqiptarë të Kosovës, pretendojnë të jenë pronarët e ligjshëm të pronës duke kiu referuar aktgjykimeve të lëshuara nga Kryetari i Gjykatës Komunale në Istog. Gjatë kësaj procedure paditësi, Serb i Kosovës, mungonte dhe asnjëherë nuk ishte i njoftuar.

Kjo nënvizon një praktikë të zakonshme që është parë në gjykatat e Kosovës pas konfliktit të vitit 1999 deri në vitin 2008, pasi që disa Shqiptarë të Kosovës në mënyrë joligjore kanë marrë dokumente pronësore përmes një procesi të paraqitjes së kërkesave kundër Serbëve. Në këto kërkesa të paraqitura pohohej se shitblerja kishte ndodhur por nuk ishte nënshkruar kontrata asnjëherë pasi që ligji, në natyrë diskriminuese, e ndalonte një gjë të tillë. Gjykata, në pamundësi të ftesës së palës Serbe, për shkak të adresës së panjohur, rrjedhimisht emëron një përfaqësues të përkohshëm. Ky përfaqësues rrallë kundërshton atë kërkesë dhe kështu praktikisht shpall Shqiptarin e Kosovës pronar të asaj prone. Në realitet ky mekanizëm iu mundësoi shumë Shqiptarëve të Kosovës të sigurojnë prona në mënyrë joligjore por edhe i detyroi shumë prej tyre të paguajnë dy herë për pronat që i kishin blerë në besim.

Në lëndën që i referohemi kërkesa ishte tërhequr dhe kontesti ishte zgjidhur pasi që paditësi Serb morri paratë për pronën e diskutueshme. Prandaj të paditurit paguan dy herë për atë pronë (herën e parë paguan te pronari i gabuar me autorizim të falsifikuar dhe herën e dytë te pronari i vërtetë).

Lënda C. Nr. 253/07, Gjykata Komunale në Pejë (Rajoni i Pejës)

Lënda: Anulim i kontratës së blerjes Lloji i procedurës: procedurë kontestimore
--

Në lëndën në vijim dy Serbë paraqitën një kërkesë për anulimin e kontratës së shitblerjes kundër dy Shqiptarëve të Kosovës. Kjo është njëra nga shumë lëndët e gjykuara nga Gjyqtarët e EULEX-it lidhur me shitblerjet mashtruese të tokës.

Kontrata e shitblerjes së pronës kinse ishte nënshkruar dhe vërtetuar më 2004 në mes nënës së paditësve dhe të paditurve. Megjithatë, u vërtetua gjatë gjykimit se e ëma kishte vdekur në vitin 1983 dhe gjyqtari civil i EULEX-it prandaj e anuloi shitblerjen. Në këto lëndë gjendja faktike është shpesh e ndërlikuar pasi që numri i palëve të përfshira në kombinim me interesin e palëve të treta e vështirësojnë gjykimin e lëndës. Çështja ligjore interesante në këtë lëndë ishte se a ia kishin shitur paditësit pronën qëllimisht të paditurve apo prona ishte bartur në mënyrë joligjore pa njohurinë e tyre me anë të dokumenteve të

falsifikuara; në fakt kjo çështje ligjore ua bëri të mundur gjyqtarëve civilë të EULEX-it të qartësojnë parimin e mbrojtjes së palës së tretë.

D. Lëndët e posedimit

Lënda C. Nr. 126/07, Gjykata Komunale në Istog (Rajoni i Pejës)

Lënda: Kthimi i posedimit dhe kompensimi i dëmit Lloji i procedurës: procedurë kontestimore
--

Në vitin 2009 gjyqtarët civilë të EULEX-it morën këtë lëndë me histori ndëretnike, në pritje të vendimit në Gjykatën Komunale në Istog lidhur me një kërkesë për kthimin e pronës dhe kompensimin e dëmeve. Kjo lëndë nënvizon lidhjen e ngushtë në mes mandatit Ekzekutiv të gjyqtarëve civilë të EULEX-it dhe mandatit të tyre të MUK-ut.

Paditësi me përkatësi etnike Serbe pohoi se i padituri, Shqiptar i Kosovës, kishte uzurpuar pronën e tij, kishte shkatërruar shtëpinë e mëparshme dhe ndërtuar një të re në atë vend. Gjatë procedurës u bë e qartë se i padituri ishte larguar nga Kosova dhe jetuar në një adresë të panjohur. Po ashtu u qartësua se pala e tretë, prapë Shqiptar i Kosovës, jetonte në atë pronë. Sipas Ligjit të procedurës gjyqtari civil i EULEX-it caktoi një përfaqësues ligjor për të përfaqësuar të paditurin dhe e dërgoi këtë vendim për botim në Gazetë Zyrtare (GZ). Megjithatë, në përputhje me Ligjin mbi GZ-në gazeta nuk ishte e obliguar t'i botonte aktet gjyqësore.⁵⁶ Me gjetjen e kësaj zbrazëtire ligjore, gjyqtarët civilë të EULEX-it në Pejë iniciuan procedurën për ndryshimin e Ligjit mbi GZ-në. Kjo procedurë zgjati gati një vit dhe ligji i ndryshuar u shpall dhe u botua në gusht 2010 dhe si rezultat Gjykatat e Kosovës mund të shpallin aktet e tyre në gazetë, duke garantuar publicitetin mundësinë e qasjes. Më 15 shtator 2010 Gjykata Komunale prezantoi përfaqësuesin ligjor, në lëndën e referuar më lart, duke ua mundësuar gjyqtarëve civilë të EULEX-it të vazhdojnë procedurën në këtë lëndë.

⁵⁶ Gjyqtarët e Kosovës i dërgonin shpalljet për botime në gazeta të përditshme.

E. Lëndët që përfshijnë presion politik të palës në procedurë ose kërcënimet e marra nga Gjyqësori i Kosovës

Lënda C. Nr. 302/07 dhe të tjera, pronarët e dyqaneve kundër Komunës së Gllogocit, Gjykata Komunale në Gllogoc (Rajoni i Prishtinës)

Lënda: kompensim i dëmit

Lloji i procedurës: procedurë kontestimore

Nga totali i 21 (njëzet e një) lëndëve të marra nga taken gjyqtarët civilë të EULEX-it në rajonin e Prishtinës, tetëmbëdhjetë ishin paraqitur nga pronarët individualë të dyqaneve kundër Komunës së Gllogocit.⁵⁷ Arsyeja prapa marrjes së këtyre lëndëve ishte se lëndët nuk ishin administruar drejt, si dhe për faktin se Komuna dukej se kishte ushtruar presion politik në gjyqësorin e Kosovës.

Në vitin 2001 përafërsisht 60 (gjashtëdhjetë) pronarë dyqanesh kërkuan vëmendjen e PSSP-së dhe Ombudspersonit për ta penguar Komunën e Gllogocit në ekzekutimin e vendimit për t'i rrënuar dyqanet e tyre. Më 7 maj 2001 PSSP-ja lëshoi një Udhëzim Ekzekutiv dhe pezulloi vendimin e marrë nga Komuna. Përkundër vëmendjes së fuqishme të PSSP-së dhe Ombudspersonit dhe faktit se këto lëndë ishin në pritje të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës komuna e ekzekutoi vendimin e saj dhe rrënoi dyqanet në mars 2005. Procedura për kompensimin e dëmeve ende ishte në pritje në vitin 2009, kur të 18 (tetëmbëdhjetë) palët paraqitën ankesat e tyre në EULEX. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe pas dëgjimit të palëve të përfshira, u vlerësua se gjykata e Kosovës nuk ishte e zonja ta përfundojë procedurën.

Lëndët C. Nr. 193/02 dhe C. Nr. 82/09, Gjykata Komunale në Lipjan dhe C. Nr. 2355/07, Gjykata Komunale në Prishtinë (Rajoni i Prishtinës)

Lënda: anulim i kontratës /vërtetim i pronësisë

Lloji i procedurës: procedurë kontestimore

⁵⁷ C.nr.302/07, C.nr.163/08, C.nr.120/08, C.nr.122/08, C.nr.116/08, C.nr.301/07, C.nr.166/08, C.nr.164/08, C.nr.160/08, C.nr.121/08, C.nr.306/07, C.nr.119/08, C.nr.117/08 dhe C.nr.61/05.

Gjatë vitit 2010 gjyqtarët civilë të EULEX-it morën 3 (tri) lëndë civile në Rajonin e Prishtinës, ku gjyqtarët e Kosovës kishin qenë të ekspozuar ndaj kërcënimeve dhe pengimeve të tjera nga ana e palëve. Dy prej këtyre tri lëndëve ishin të paraqitura në Gjykatën Komunale në Lipjan dhe e treta në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

Lënda e parë⁵⁸ e paraqitur në Lipjan kishte të bëjë me një kërkesë për anulim të kontratës. Në vitin 2002 paditësi pohoi se ai kishte përparësi në blerjen e një parcele, të cilën e kishte blerë i padituri, që gjendej aty ngjitur me pronën e tij. Gjatë shqyrtimeve në Gjykatën Komunale paditësi dhe disa të afërm të tij kanosën gjyqtarin e Kosovës, avokatin mbrojtës dhe të paditurin. Këto kërcënime penguan përfundimin e procedurës dhe prandaj kjo lëndë ishte në pritje të vendimit. Në vitin 2010 gjyqtarët civilë të EULEX-it pranuan një kërkesë prej të paditurit dhe Gjykatës Komunale për të marrë lëndën. Paditësi e kundërshtoi fuqishëm këtë dhe shfaqti të njëjtin qëndrim kërcënues ndaj gjyqtarëve të EULEX-it.

Lënda e dytë⁵⁹ kishte të bëjë me vërtetimin e pronësisë së një parcele atraktive që ishte në pronësi të 3 (tre) individëve. Njëri prej bashkëpronarëve pretendohet se kishte ngritur një biznes dhe po punonte në atë parcelë të tokës, një biznes mbi të cilin edhe dy bashkëpronarët tjerë pretendonin pronësi. Mirëpo lënda ngeci pasi që njëra prej palëve filloi ta kanoste gjyqtarin e Kosovës përgjegjës për atë lëndë. Gjyqtari i Kosovës pastaj kërkoi nga gjyqtarëve civilë të EULEX-it ta marrin këtë lëndë. Ishte konstatuar se atmosfera e përgjithshme që rrethonte këtë lëndë nuk lejonte gjykim të drejtë. Pasi kjo lëndë u morr një gjyqtar civil i EULEX-it e lëndës pjesërisht pranoi propozimin e paditësve dhe urdhëroi një masë të përkohshme sigurie kundër të paditurit. Shqyrtimi i parë në këtë lëndë është caktuar për muajin janar 2011.

Lënda e tretë⁶⁰ kishte të bëjë me anulimin e kontratës së shitblerjes për një patundshmëri atraktive në qendër të Prishtinës. Në kërkesën e paraqitur pohohej se i padituri, Shqiptar i

⁵⁸ Lënda C. Nr. 193/02, Gjykata Komunale në Lipjan

⁵⁹ Lënda C. Nr. 82/09, Gjykata Komunale në Lipjan

⁶⁰ Lënda C. Nr. 2355/07, Gjykata Komunale në Prishtinë

Kosovës, kishte blerë pronën në mënyrë mashtruese prej një anëtari të familjes së paditësit, të përkatësisë etnike Serbe i cili nuk ishte i autorizuar të bënte shitjen. Lënda u vlerësua si e ndejshme dhe rrjedhimisht u morr nga gjyqtarët civilë të EULEX-it pasi që kontesti përfshinte palë me prejardhje të ndryshme etnike, njëra nga palët kishte lidhje me grupe politike me ndikim dhe gjyqtarët e Gjykatës Komunale kishin dhënë dorëheqje nga lënda pas kërcënimeve të pranuar nga i padituri. Gjyqtari konsideroi se autorizimi mbi të cilin ishte kryer kontrata e shitblerjes nuk ishte e vlefshme. Kontratës i mungonte pëlqimi i njëres palë kontraktuese dhe asnjë marrëveshje detyruese nuk ishte lidhur në lidhje me disa pjesë të pronës së diskutueshme. Në dhjetor 2010 gjyqtarët civilë të EULEX-it lëshuan një aktgjykim sipas të cilit kontrata e kontestueshme e shitblerjes u anulua pjesërisht. Zyra Kadastrale e Komunës së Prishtinës ishte urdhëruar t'i ndryshojë librat e saj në përputhje me këtë aktgjykim.

Kapitulli 4: Gjykimi i lëndëve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për lëndët që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (rastet studimore dhe statistikat)

I. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme: baza ligjore, kompetencat dhe sfidat

Baza ligjore për themelimin e DhPGjS në formën e saj të tanishme është Rregullorja e UNMIK-ut 2008/4⁶¹ që ndryshon Rregulloren e UNMIK 2002/13, dhe Udhëzimin UNMIK Administrativ 2008/6.⁶² Ligji parasheh kolegje të përziera në dy shkallë, përkatësisht shkallë të parë dhe ankesë, me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it në secilin kolegji.

⁶¹ Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/4 që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit të datës 5 shkurt 2008.

⁶² Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut Nr. 2008/6 që ndryshon dhe zëvendëson Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut Nr. 2006/17, që implementon Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit të datës 11 qershor 2008.

Vështirësitë përkitazi me gjykimin e drejtë të lëndëve që shpesh kanë të bëjnë me lidhje ndëretnike, që përfshijnë palë jashtë Kosovës, kërkojnë një ndihmë të vazhdueshme ndërkombëtare në këtë segment në zbatimin e drejtësisë në Kosovë. Shumë lëndë pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin bien nën fushëveprimin e kompetencës së DhPGJS-së. Procesi i privatizimit në Kosovë duhet të shërbejë si një bazë e fortë për pavarësinë vërtetë ekonomike; prandaj rëndësia e saj nuk duhet të nënvlerësohet. Për shkak të shumës së parave të përfshira në privatizim, gjithmonë ekziston rrezik i lartë i korrupsionit, faktor i cili gjithnjë duhet të merret parasysh në rastet kur bëhet shqyrtimi i lëndëve individuale.

DhPGJS ka arritur përparim të lartë në zbatimin e standardeve dhe praktikave më të mira Evropiane. Pikat e para të rendit të ditës ishin zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi operativë për përbërjen e kolegjeve të gjyqtarëve në shkallën e parë dhe të dytë, dhe për një sistem objektivë dhe të paracaktuar të caktimit të lëndëve në mes të gjyqtarëve me rotacion, sigurimin e transparencës, të drejtën për një gjyqtar të ligjshëm, dhe një ekuilibër të drejtë të punës.

Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-it 2008/4 parasheh që '[Dhoma e Posaçme do të ketë në përbërje deri në njëzet (20) gjyqtarë, trembëdhjetë (13) prej të cilëve do të jenë gjyqtarë ndërkombëtarë dhe shtatë (7) do të jenë banorë të përhershëm të Kosovës [...]'. Ai gjithashtu parashikon që një ose më shumë grupe prej dy gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe një gjyqtar të Kosovës, secili për të shërbyer në një nga pesë kolegjet me nga tre gjyqtarë, do të themelohet nga Kryetari i DhPGJS për zhvillimin e proceseve gjyqësore dhe gjykimin e kërkesave dhe kundër kërkesave në shkallën e parë.

Që nga hyrja në fuqi e këtyre dispozitave, DhPGJS nuk ka qenë me personel të kompletuar për të mundësuar përbërjen e 5 (pesë) Trupave Gjyqësore të specializuar siç është paraparë me nenin 3.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008 / 4. Prandaj në janar 2009 gjyqtarët e DhPGJS njëzëri ranë dakord për të themeluar një Trup Gjyqësor, duke vepruar

nëpërmjet grupeve të ndryshme të gjyqtarëve në përbërje të ndryshme, gjithmonë të kryesuar me një gjyqtar të EULEX-it.

Më tej, nuk ka mundur të konstituohet as Presidiumi i përbërë nga Kryetari dhe Kryetarët e kolegjeve, të parashikuar në nenin 10 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008 / 6 dhe nenit 3 të Rregullores të UNMIK-ut 2008 / 4. Sipas nenit 10.3 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008 / 6 në rast se Presidiumi nuk është në gjendje të arrijë një vendim në kohë, Kryetari do të marrë një vendim të tillë dhe ta paraqesë atë në Presidium për miratim. Për të balancuar autorizimet që ranë në Kryetarin e DhPGJS për shkak të mungesës së Presidiumit, të gjitha vendimet e mbetura në Presidium u morën me pëlqimin e shumicës së gjyqtarëve të DhPGJS. Vetëm rastet e përjashtimit apo zëvendësimit të gjyqtarëve janë vendosur deri tani nga vetëm Kryetari, të sjella shtesë në rregullat e përmendura për caktimin e lëndëve.

Kjo u formalizua në Rregulloret për Themelimin e një Trupi Gjykues dhe një Kolegji të Ankesave të DhPGJS, për Caktimin e Lëndëve dhe Rregullave Plotësueses të Procedurës, që gjithashtu paraqiti një sistem të rotacionit të caktimit të lëndëve⁶³. Më tej DhPGJS i ndryshoi në mënyrë të rregullt, rregullat procedurale *inter alia* organizimin dhe rrjedhojën e punës në kuadër të DhPGJS, menaxhimin e shkresave të lëndës, rregullat për procedurën në DhPGJS, përgatitjen dhe zhvillimin e këshillimeve dhe seancave dëgjimore etj.

Në fund të dhjetorit 2010 një takim ishte iniciuar ku edhe një herë, përveç tjerash, ishte ngritur çështja e 5 (pesë) kolegjeve të specializuara siç parashihet me ligj dhe Presidiumi. Në janar 2011 u themelua një grup punues për tu siguruar gjyqtarëve të DhPGJS të gjitha alternativat e mundshme për këto çështje. Raporti i vlerësimit është ende në shqyrtim nga gjyqtarët për faktin se gjyqtarë të rinj ndërkombëtare dhe të Kosovës do të emërohen së shpejti.

⁶³ Rregullat janë miratuar nga ana e gjyqtarëve të EULEX-it, gjatë Asamblesë së 4(katërtë) të gjyqtarëve të EULEX-it më 2 mars 2009.

Lëndët nën kompetencën e DhPGJS

Kompetenca primar mbi kërkesat dhe kundërkërkesat e DhPGJS është e përcaktuar në nenin 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2008 / 4. DhPGJS ka kompetencë mbi, *inter alia*, të gjitha ankesat e ngritura kundër një ndërmarrje apo korporate që aktualisht ose më parë është nën autoritetin administrativ të AKM-së. Prandaj kompetenca e DhPGJS përfshin në fakt të gjitha llojet e lëndëve civile në të cilat AKM-ja është e përfshirë ose për shembull, një NSH si e paditur. Andaj, kategoritë më të rëndësishme të lëndëve janë të lidhura me kontestet pronësore (kryesisht në lidhje me pronën e paluajtshme), me mosmarrëveshjet në lidhje me privatizimin dhe kontratat e ndërlidhura me privatizimin dhe me listat e punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuar apo të likuiduar.

Lista e Lëndëve të Punëtorëve


Ajo lidhet me të drejtën e punëtorëve të një ndërmarrje për të marrë pjesë në të hyrat e privatizimit apo likuidimit të saj. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2008 / 4, neni 4.1 (e) DhPGJS ka kompetencë mbi 'kërkesat që përfshijnë një listë zyrtare të punëtorëve të ligjshëm të një ndërmarrje të lëshuar nga agjencia dhe të drejtën për tu zgjedhur të punëtorëve sipas nenit 10 të Rregullores nr 2003/13, e ndryshuar [...], e ashtuquajtura 'Lisat e Lëndëve të Punëtorëve'.

Lënda më e mirënjohur ka të bëjë me NSH "Ramiz Sadiku. Seancat e dëgjimit janë mbajtur gjatë 33 ditëve në mes të marsit dhe majit 2010 (seancat e dëgjimit të tjera më 21 tetor 2010), gjatë të cilave të gjithë ankuesit (rreth 1400) ishin ftuar të paraqesin lëndët e tyre para gjykatës.


Statistikat 2010

Në shkurt 2009, 597 lëndë janë marrë nga DhPGJS 'e vjetër' (të ashtuquajturat Lëndët e Trashëgimit të UNMIK-ut), deri më sot janë vendosur 371 Lëndë të Trashëgimit të UNMIK-ut. Në 2010 DhPGJS ka regjistruar 663 lëndë të reja në të dy shkallët. Përveç kësaj janë regjistruar 591 ankesa kundër Listës së Lëndëve të Punëtorëve. Kjo është

shtesë në 659 lëndë dhe 2684 ankesa që janë tashmë në pritje në DhPGJS nga 01 janari 2010.



Gjatë këtij viti, janë mbyllur 356 lëndë (lëndët e listës së punëtorëve janë numëruar nga ankuesit individual) dhe janë mbajtur 109 seanca të dëgjimit (krahasuar me 11 seanca të dëgjimit të mbajtura në vitin 2009) në Dhomën e Posaçme.



Në periudhën raportuese janë marrë 589 vendime procedurale (në krahasim me 667 të lëshuar në vitin 2009) dhe janë lëshuar 3930 urdhëresa (krahasuar me 964 të lëshuar në vitin 2009). Aktualisht 1136 lëndë në total janë në pritje në DhPGJS.

Viti i Regjistrimit	Lëndët Aktive
2003	1
2004	9
2005	16
2006	44
2007	71
2008	130
2009	277
2010	615

Gjatë periudhës raportuese DhPGJS ka regjistruar 41 Lëndë të Listës së Punëtorëve të reja me një numër total prej 428 ankesa individuale përveç 26 lëndëve me një total prej 2684 ankesa tashmë në pritje në DhPGJS që nga 1 janari 2009. 4 Lëndë të Listës së Punëtorëve me një total prej 100 ankesash individuale janë zgjidhur.

Në vitin 2010 janë pranuar 591 ankesa, ndërsa GJS ka regjistruar 2785 ankesa në 2009. Numri i lëndëve të reja të regjistruara gjatë periudhës së raportimit (41 lëndë) dukshëm është rritur në krahasim me numrin 25 në 2009.

Sfidat

Do të përmenden disa sfida me të cilat përballet DhPGJS: kompleksiteti i kornizës ligjore; mungesa e baraspeshës së plotë të gjyqtarëve të EULEX-it dhe të Kosovës; personeli i pamjaftueshëm⁶⁴ dhe burimet logjistike (p.sh. infrastruktura e dobët, nevoja

për personel shtesë administrative dhe numri shumë i lartë i përkthimeve të mbetura)⁶⁵, shërbimi i dokumenteve për shtetet mos - njohëse⁶⁶. Në të kaluarën, DhPGJS u përball me protestat e shumta për shkak të vonesave në lëshimin e aktgjykimeve. Përveç kësaj për shkak të vazhdimësisë të pazgjidhur midis AKM-së dhe AKP, DhPGJS shpesh është përballur me situata ku të dy agjencitë pretendojnë të drejtën e administrimit dhe të përfaqësimit të interesave shoqërore para Gjykatës.

II. Lëndët e përzgjedhura⁶⁷

Në janar 2010, 691 lëndë ishin në pritje në DhPGJS në të dy shkallët (3345 nëse ankesat në lëndët e listës së punëtorëve numërohen individualisht). Më 31 dhjetor 2010, 1163 lëndë ishin në pritje në DhPGJS (4274 nëse ankesat në lëndët e listës së punëtorëve numërohen individualisht). Në 2010, kolegji i shkallës së parë ka përfunduar 251 lëndë me aktvendime të formës së prerë, 16 prej të cilave ishin aktgjykime. Kolegji i ankesave ka përmbyllur 105 lëndë me aktvendime të formës së prerë, 28 prej të cilave ishin aktgjykime/aktvendime të formës së prerë mbi meritat.

Në vendimet e saja DhPGJS ka adresuar çështje të shumta të rëndësishme ligjore, ku vetëm disa prej të cilave do të jenë të theksuara në këtë raport nga zgjedhja përfaqësuese e mëposhtme e cila përqendrohet kryesisht në Vendimet e Kolegjit të Ankesave (VKA),

⁶⁴ Dhoma e Veçantë është përballur me vështirësi në rekrutimin e gjyqtarëve të EULEX-it dhe të Kosovës që do të plotësonin kushtet minimale. Pas një kohe të gjatë ndërprerje, 3 gjyqtarë të Kosovës (2 për Trupin Gjyqësor dhe 1 për Kolegjin e Ankesave) janë emëruar në korrik 2010 (nga 7 vendet e lira të punës të shpallura).

⁶⁵ Ekziston një numër në rritje i përkthimeve të mbetura prej 6036 faqe në fund të periudhës raportuese. Në 2010, janë përkthyer 4036 faqe të dokumenteve. Lëndët për të cilat shkresat e lëndës janë duke pritur për përkthim, janë ende në pritje në Dhomën e Posaçme dhe kjo përbën një pengesë serioze për qasje në drejtësi.

⁶⁶ Shërbimi i dokumenteve shteteve të cilat nuk e kanë njohur, në veçanti në Serbi, mbetet problem. Sipas Udhëzimit Administrativë mbi Procedurën e Ndihmës Juridike Ndërkombëtare në Çështjet Penale dhe Civile të 30 shtatorit 2009 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, kjo e fundit është përgjegjëse vetëm për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar edhe me vendet që nuk e kanë njohur Kosovën, dhe Serbia. Megjithatë dokumentet e paraqitura për shërbimin e DhPGJS nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë nuk u janë dërguar palëve në Serbi dhe kjo çështje ka ngritur shqetësime në lidhje me të drejtën e palëve për qasje në drejtësi.

⁶⁷ Shumica e aktvendimeve të DhPGJS janë në dispozicion në <http://www.eulex-kosovo.eu/en/judgments/CV-Special-Chamber-KTA.php>

sepse ajo është detyrë e çdo Gjykate Supreme për të siguruar zbatimin uniform të ligjit duke vendosur mbi ankesat në përputhje me ligjin. Çështjet ligjore të vendosura nga Kolegji i Ankesave i DhPGJS prandaj janë me rëndësi të madhe dhe kontribuojnë në institucionin e parimeve bazë.

Përveç kësaj, pasi që rregulloret e aplikueshme dhe urdhëresat administrative përmbajnë dispozita procedurale mjaft të komplikuar, kolegjet e Dhomës së Posaçme kanë lëshuar shumë vendime mbi papranueshmërinë dhe çështjet procedurale të tjera.

Lënda ASC-09-0108, përfaqësimi i një NSh-je në DhPGJS dhe këshilla se si të bëhet ankesa

Në këtë lëndë, kolegji i shkallës së dytë vendosi mbi çështjen nëse AKP, ka të drejtë ligjërisht për të përfaqësuar NSH-në para DhPGJS. Më tej, Kolegji i Ankesave kishte për të qartësuar aspekte të tjera të rolit proceduralë të AKP-së dhe referimin e lëndëve gjykatave të rregullta, si edhe për çështje të vogla procedurale në lidhje me procedurën e ankesës.

AKP-ja ishte thirrur në padi, dhe çështja u referua në Gjykatën Komunale në Prishtinë me vendim të shkallës së parë me datë 24 nëntor 2009. Më tej, u konfirmua se ankesa nga vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë do të shqyrtohet nga Dhoma e Posaçme. Trupi Gjykues deklaroi se ishte e nevojshme për të ushtruar kompetencë mbi AKP-në, në mënyrë që plotësisht të gjykojë kërkesën dhe se Gjykata Komunale e Prishtinës, si gjykatë të cilës iu referua lënda, ishte kompetente për ta vendosur lëndën në mënyrë të paanshme dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008 / 4, neni 15 i Urdhëresës Administrative 2008 / 6 dhe nenet 206 dhe 207 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Sipas ankesës së paditësit, kolegji i shkallës së dytë konstatoi se aktivitetet e AKM-së, duke përfshirë edhe përfaqësimin e NSH-ve para Dhomës së Posaçme, pushuan në qershor 2008 dhe atëherë faktikisht ishin marrë përsipër nga AKP. Duke e pasur parasysh këtë situatë faktike dhe se ekziston një nevojë e menjëhershme për NSH-të që të

përfaqësohen me rregull, dhe duke pasur parasysh se si parim themelor, sistemet ligjore pas sundimit të ligjit nuk do të lejojnë vakum ligjor, tani për tani do të pranohet përfaqësimi i NSH-ve nga ana e AKP.

Lënda SCC – 07 – 0311, vlefshmëria e dispozitave të caktuara në dokumentet e shitjes përgatitur nga Agjencia, njohuri paraprake të mangësive ligjore

Kjo lëndë ka të bëjë me një kërkesë për posedim të tokës subjekt i okupimit të paligjshëm dhe kompensimit. Kolegji i shkallës së parë vlerësoi vlefshmërinë e dispozitave të caktuara në dokumentet e shitjeve të përgatitur nga Agjencia dhe pasojat e ekzistencës së mangësive juridike, kur të dy palët ishin të vetëdijshme për ato para përfundimit të kontratës. Ky vendim mund të jetë me rëndësi të përgjithshme për shkak se okupimi i kundërligjshëm i pronës shoqërore është një fenomen i përhapur në Kosovë, i cila ka gjasa të jetë problematikë gjatë procesit të privatizimit të një NSH-je.

Kolegji i shkallës së parë e refuzoi kërkesën si të pabazuar mbi bazat se ligji i zbatueshëm duhet të verifikohet; në mënyrë që të vendos mbi kërkesën janë nenet 508-515 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore⁶⁸. Padiësi është në pozitën e blerësit që pretendon të drejtën e tij për kompensim. Kompensimi është paraja që qiramarrësi kërkon nga padiësi për mos dërgimin në kompani të posedimit të premtuar të tokës. Humbja e shkaktuar nga hipoteka mbi objektin e blerë është uzurpimi i tokës nga palët e treta (të cilët kërkuan më parë të drejtat e tyre kundër shitësit).

AKM-ja mbron veten duke theksuar një klauzolë të kontratës dhe duke deklaruar se nuk ishte e detyruar për të transferuar token e lirë nga zënia. Kolegji refuzoi këtë argument sepse thelbi i kontratës së shitjes është që shitësi është i detyruar të dorëzoj pasurinë d.m.th transferimin e posedimit dhe jo ‘thjesht’ të drejtën. Blerësi, në parim, ka të drejtë të gëzojë posedimin e lirë të pasurisë.

⁶⁸ Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, OG RSFJ nr. 29/1978, e ndryshuar me OG nr 39/1985, 45/1989, 57/1989

Nga provat e mbledhura Gjykata kuptoi se i padituri, AKM-ja, kishte njohuri për pengimin e posedimit të lirë. Neni 513, paragrafi 2 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve deklaroi të prishur dhe të pavlefshme klauzolën për përjashtimin e përgjegjësisë për mangësitë ligjore për të cilën shitësi ishte i vetëdijshëm, ose që nuk mund të ketë mbetur e panjohur për atë në datën e hyrjes në kontratë.

Por në gjendjen në të cilën që të dy palët e dinin për mangësitë e pasurisë, përgjegjësia do të lëviz nga shitësi te blerësi⁶⁹. Sa i përket kërkesës tjetër të dhënë nuk kishte asnjë provë që shitësi dinte për atë, prandaj klauzola e kontratës vepron. Duke marrë parasysh të gjithë këtë arsyetim, gjykata konstaton se shitësi nuk ka asnjë detyrim në mbrojtjen e paditësit nga okupimi - pra nuk ka detyrim në dorëzimin e tokës - dhe në kompensimin për humbjen e pretenduar.

Lënda ASC-09-0072, pyetjet e përgjithshme në lidhje me pranueshmërinë e një kërkesë

Lënda ka të bëjë me njërin nga pyetjet e përgjithshme në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës. Trupi Gjykues refuzoi kërkesën si të papranueshme, duke argumentuar se paditësi nuk i ka sjellë Gjykatës adresën e të paditurit, nuk ka sjellë një autorizim të duhur dhe nuk ka arritur të sigurojë faktet dhe argumentet ligjore, si dhe një listë të provave. Për më tepër ajo argumentoi se paditësi nuk e ka provuar se ai e ka lajmëruar si duhet Agjencinë për synimin e tij për të paraqitur një kërkesë.

Në vendimin e shkallës së dytë Kolegji i Ankesave konstatoi se paditësi në kohë ka sjellë adresën e të paditurit. Kolegji i Ankesave gjithashtu vendosi që autorizimi, siç parashihet në nenin 24.6, në lidhje me nenet 25, 28.3 (f) dhe 28.4 të Urdhëresës Administrative 2008 / 6, është ndër kriteret e pranimit për një kërkesë dhe autorizimi i diskutueshme nuk ishte kufizuar për përfaqësimin e ankuesit në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

⁶⁹ Neni 508, para 1, fjalja e fundit e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve

Neni 28.2 (f) ndër kriteret e pranimit për një kërkesë, rendit (të gjitha) “... kushtet e neneve 25 dhe 27 ...”, në shikim të parë duke i dhënë përshtypjen se të gjitha elementet e renditura në to mund të çojnë në refuzimin e kërkesës si të papranueshme, në qoftë se nuk sigurohet sipas urdhëresës (shih nenin 28.4 të Urdhëresës Administrative 2008 / 6). Një reflektim më i afërt, megjithatë, tregon se sfera e kësaj dispozite duhet të reduktohet në baza teleologjike. Nëse faktet (të mjaftueshme) dhe / apo argumentet e ligjshme nuk janë paraqitur, apo faktet e pretenduara nuk çojnë në konkluzionin sikurse është nxjerrur nga paditësi, ankesa mund të jetë vetëm subjekt refuzimi si e pabazë, nëse nuk sqarohet sipas kërkesës. E njëjta gjë vlen edhe për listën e provave: Në parim, vetëm faktet kontestuese duhet të vërtetohen nga paditësi. Nëse i padituri nuk i konteston faktet e pretenduara në një kërkesë vendimtare, nuk ka nevojë për të marrë prova. Në rastin në fjalë, i padituri nuk ishte i përfshirë ende.

Sipas nenit 29.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 (në lidhje me nenin 28,2 [e] të Urdhëresës Administrative 2008 / 6), njoftimi me shkrim për qëllim të paraqitjes së veprimit kundër një NSh-je duhet t’i jepet Agjencisë para parashtrimit të kërkesës (referim i trupit gjykues për njoftimin 60 ditë siç është paraparë në nenin 30.2, të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 është i pasaktë, pasi që kjo dispozitë zbatohet vetëm për kërkesat kundër Agjencisë). Edhe pse kriteret e pranimit duhet të jenë të shqyrtuara sipas detyrës zyrtare, në atë fazë të hershme të procedurës (para se i padituri të jetë përfshirë) argumenti i thjeshtë nga paditësi se është dhënë njoftimi i duhur, është - në parim - i mjaftueshëm, duke pasuar të njëjtin model sikurse përshkruhet më sipër. Në qoftë se paditësi pohon se është paraqitur njoftim i duhur, trupi gjykues nuk mund ta refuzojë kërkesën si të papranueshme jashtë kësaj arsyeje. Përveç nëse kërkesa është e papranueshme për arsye të tjera, ai duhet t’i jap të paditurit mundësinë për të marrë një qëndrim mbi njoftimin, së bashku me meritat e kërkesës.”

Prandaj, vendimi i shkallës së parë duhet të hedhet poshtë.

Lënda SCC-10-0082, Pranueshmëria e një kërkesë, nuk ka kompetencë mbi komunitat

Kjo lëndë ka të bëjë me njohjen e të drejtës së posedimit të një parcele kadastrale dhe kompensimin e pasurive të patundshme të vendosur në atë *vis-à-vis* një Komune. Pyetja në këtë lëndë ishte nëse kërkesa e bërë nga një individ i zakonshëm kundër një Komune nuk bie nën kompetencën e DhPGJS. Kolegji i shkallës së parë refuzoi kërkesën si të papranueshme, duke argumentuar se, sipas nenit 28.2 të Urdhëresës Administrative 2008 / 6, një kërkesë do të jenë të pranueshme vetëm nëse ajo është bërë kundër një pale që mund të jetë i padituri në procedurë në Dhomen e Posaçme në pajtim me nenin 5.2 të Rregullores së Dhomës së Posaçme. Më tej neni 4.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2008 / 4 thotë se Dhoma e Posaçme ka kompetencë primare për kërkesat ose kundërkërkesat në lidhje me: [...] c) Kërkesat, duke përfshirë kreditorin apo kërkesat e pronësisë, të bëra kundër një Ndërmarrjeje apo Korporate që aktualisht është ose më herët ishte nën autoritetin administrativ të Agjencisë, kur kërkesat e tilla janë ngritur gjatë ose para kohës kur Ndërmarrja apo Korporata e tillë është apo ishte subjekt i autoritetit administrativ të Agjencisë; ...

Prandaj Dhoma e Posaçme nuk ka kompetencë mbi kërkesat që përfshijnë Komunitat dhe e refuzoi kërkesën si të papranueshme në pajtim me nenin 28.3 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008 / 6.

Lënda ASC-09-0075, pasojat e vendimit të moratoriumit

Kjo lëndë ka të bëjë me pezullimin e procedurës nga trupi gjykues në shembull me arsyetimin se vendimi i moratoriumit do të ndalojë vazhdimin e gjykimit në këtë kohë. Në këtë lëndë Kolegji i Ankesave kishte për të vendosur nëse i padituri – është ende - nën vendimin e moratoriumit, se çfarë janë pasojat, dhe në përgjithësi për pasojat e veçanta të moratoriumit.

Kolegji i Ankesave konfirmoi vendimin e shkallës së parë, duke e hedhur poshtë në vend të pezullimit të kërkesës. Në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës procedurale civile, ‘pezullimi’ apo ‘moszgjidhja’ e procedurave *per definitionem* mund të

drejtohet vetëm nëse ngrihen rrethana të veçanta gjatë procedurës, e cila nuk ka ndodhë para fillimit të tyre. Në veçanti, pezullimi i procedurës duhet të caktohet vetëm në një situatë kur një palë është vënë nën riorganizim gjatë procedurës, ndërsa dispozita e përmendur nuk i mbulon kërkesat e paraqitura, kur një vendim moratoriumi është tashmë në vend (krahasoni ASC-10-0014), dhe është shqiptuar siç duhet. Për sa kohë që moratoriumi është në vend, nuk mund të paraqiten kërkesa me qëllim ndjekjen e nevojave kundër ndërmarrjes e cila është çështje e moratoriumit, kur për çështjen në fjalë që është e bazuar në fakte kanë hyrë në ekzistencë para moratoriumit (pra sigurimin e barazisë së kreditorëve). Këto kërkesa janë për tu hedhur poshtë si të papranueshme. Si rrjedhojë, vendimi i kundërshtuar duhet të ndryshohet në lidhje me refuzimin e kërkesës.

Ky rezultat nuk bie ndesh me nenin 51.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 REG, që ka të bëjë me kërkesat e paraqitura në DhPGJS pas datës së moratoriumit, dhe i liron ata nga kushti i njoftimit të përcaktuar në nenet 29.1 dhe 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12: Kjo dispozitë gjithsesi nuk merr një qëndrim mbi pranueshmërinë e disa kategorive të caktuara të vetë kërkesave dhe në asnjë mënyrë nuk lejon për konkludimin se kërkesat e paraqitura pas moratoriumit janë përgjithësisht të pranueshme, por vetëm vendos një rregull të përgjithshme mbi kërkesat pranueshmëria e të cilave do të përcaktohet me dispozitat e tjera (në mënyrë të veçantë nga neni 30 et seq. Rregullorja e UNMIK-ut 2005/48 lidhur me kërkesat në vazhden e procedurave të riorganizimit, apo neni 39.7 të Rregullores së UNMIK-ut 2001 / 6 për kërkesat të cilat kundërshtojnë vendimet e komisionit të likuidimit gjatë procedurave të likuidimit) .

Lënda ASC-10-0036, kriteret e pranimit, njoftim të Agjencisë

Kjo lëndë ka të bëjë me çështjen e kriterëve të pranimit (njoftim të Agjencisë sipas nenit 29.1 dhe 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, dhe lidhjen në mes të këtyre dispozitave dhe nenin 6.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008 / 4). Gjithashtu duhet të vendos se në të cilat raste Agjencia mund të konsiderohet si përfaqësuese e NSh-së dhe në cilat raste, në vend të saj, duhet të jetë pala.

Në lidhje me sferën e zbatueshmërisë së nenit 30.2 Kolegji i Ankesave konstatoi se, përderisa njoftimi sikurse është parashikuar në nenin 29.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, do të mbrojë vetëm autoritetin e Agjencisë për të përfaqësuar ndonjë NSH në DhPGJS, duke e informuar Agjencinë më parë / në fillim të procedurës në DhPGJS (shih nenin 29.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12), njoftimi 60 (gjashtëdhjetë) ditor sikurse është detajuar në nenin 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 duhet të shihet kundër sfondit që Agjencia, vendimet e së cilës janë (duhet të) kundërshtuar, do të pranohen në një kohë (60 ditë) që të rishqyrtojë këto vendime dhe / ose për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje që më parë, në vend që të paditet në DhPGJS (krahasoni ASC-10-0024).

Sipas formulimit të thjeshtë të nenit 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, kushti i njoftimit me shkrim të paktën 60 ditë para paraqitjes aktuale të kërkesës nuk është i kufizuar në mënyrë eksplicite në kategori specifike të kërkesës. Neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut 2008 / 4 që qeveris kompetencën primare të DhPGJS, në aspektin e tij (a) dhe (b) paraqet (vetëm) këto kategori të kërkesave kundër Agjencisë që të sillen para DhPGJS: Përderisa aspekti (b) mbulon kërkesat kundër Agjencisë për humbjet financiare të caktuara, aspekti (a) merret me kundërshtime të vendimeve ose veprimeve të tjera të Agjencisë, të ndërmarra në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12. Dispozita e fundit e lexuar në lidhje me nenin 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 nxjerr në shesh se vetëm kur të atakohen vendimet apo veprimet e Agjencisë (direkt) mund të justifikohet njoftimi 60 ditor: Vetëm në këto raste Agjencia do të jetë në një pozicion për të parë vendimet e saj nga e para brenda një periudhe kohe të caktuar, si dhe për revokimin e tyre nëse është e përshtatshme, pa qenë subjekt i rrezikut të përballet me veprime të ligjshme. Në të gjitha rastet e tjera nuk ka arsye për dhënien e Agjencisë një trajtim të favorshëm mbi lëndët që mbulohen me nenin 29.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, pasi që ajo mund të hyjë në negociata në emër të një NSH-je në çdo kohë, madje edhe kur procedurat në DhPGJS janë tashmë të pritje.

Rrjedhimisht, neni 6.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2008 / 4 që përmban dispozita të veçanta për kërkesat të cilat atakojnë vendimet apo veprimet e Agjencisë, direkt i

referohet nenit 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, duke nënvizuar se dispozita e fundit vlen për kërkesat sikurse është trajtuar vetëm me nenin 6 të Rregullores së UNMIK-ut 2008 / 4. Si pasojë, sfera e nenit 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 duhet të kuptohet në lidhje me zbatimin në kërkesa të mbuluara vetëm nga neni 4.1 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2008 / 4 (kërkesat për të atakuar vendimet e Agjencisë ose veprimet e tjera).

Kjo nuk ishte çështja në shembull: Padiësi u veçua qartë në mes të dy të paditurve, dhe në mënyrë të qartë shprehu vullnetin e tij për të ndërmarrë veprime kundër AKM-së, por pa atakuar vendimet apo veprimet e tjera të AKM-së. Prandaj, neni 30.2, i Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 që deklaron kushtin e njoftimit 60 ditor nuk zbatohet. Në vend të kësaj, kjo lëndë mbulohet nga neni 29.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2002/12.

Në lidhje me rastin konkret, në të cilin kërkesa është refuzuar pas 15 muaj si e papranueshme, Kolegji i Ankesave konstatoi se njoftimi në Agjenci për qëllimin për të paraqitur një kërkesë është ndër kriteret e pranimit, të përcaktuara në nenin 28.3 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008 / 6. Argumenti i thjeshtë nga padiësi që është dhënë një njoftim i duhur, është - në parim - i mjaftueshëm, siç është deri në diskrecionin e të paditurit për të mos kontestuar faktet ashtu siç janë deklaruar nga padiësi, duke përfshirë edhe çështjen e njoftimit. Me këtë rast, duhet të përsëritet se në qoftë se një padiës pohon se një njoftim i duhur ka qenë i paraqitur, trupi gjyqës nuk mund të hedh poshtë kërkesën si të papranueshme, bazuar në mungesën e dëshmive të njoftimit të tillë. Përveç nëse kërkesa është e papranueshme për arsye të tjera, ai duhet t'i jap të paditurit mundësinë për të marrë një qëndrim mbi njoftimin e kërkuar, së bashku me meritat e lëndës. Pastaj mbetet te i padituri për të kontestuar faktet që përmbahen në padi, duke përfshirë edhe njoftimin e (afatet kohore të) pretenduar. Vetëm në qoftë se i padituri konteston njoftimin, nga padiësi do të kërkohet të provoj njoftimin.

Në rastin në fjalë, i padituri nuk ka pasur ende mundësin për të kontestuar njoftimin. Edhe pse, padiësi (Ankuesi) dërgoi një kopje të njoftimit të datës 7 nëntor 2008, por, që tregon qartë se ajo nuk është paraqitur në kohë. Në këto rrethana nuk është ngritur

nevojë e mëtejme për të përfshirë të paditurin; pas parashtrësës së paditësit tashmë ishte e qartë se jo të gjithë kriteret e pranimit ishin plotësuar në datën e paraqitjes së kërkesës.

Megjithatë, duhet të merret parasysh këtu se AKM-ja ishte në dijeni të kërkesës dhe nuk zgjodhi për të zgjidhur mosmarrëveshjen me paditësit. Duke pasur parasysh se qëllimi i njoftimit është të informojë Agjencinë për kërkesat e mundshme, dhe për t'i pajisur me mundësinë për të ngritur çështjen në emër të NSH-së të përfshirë, *ratio legis* i njoftimit në ndërkohë është përmbushur. Përveç kësaj, duhet të konsiderohet se detyra e një parashtruesi të njoftojë Agjencinë paraprakisht shton barrë shtesë për atë në lidhje me qasjen në drejtësi; dispozita prandaj patjetër duhet të interpretohet në një mënyrë restriktive. Në këtë situatë, Kolegji i Ankesave e konsideron njoftimin e parakohshëm të jetë pa (më tej) rëndësi sa i përket gjykimit të kërkesës.

Lënda ASC-09-0059, vlefshmëria e një shpronësimi para 1999

Lënda merret me çështjen shumë të diskutueshme të akteve kundërshtuese të shpronësimit që kanë ndodhur para vitit 1999. Në këtë vendim Kolegji i Ankesave vendosi mbi kompetencën e DhPGJS për këto kërkesa dhe konstatoi se ajo është brenda kompetencës së DhPGJS për të shqyrtuar vlefshmërinë e çdo akti të shpronësimit i cili është kontestuar brenda një padie kundër një Ndërmarrje Shoqërore ose Publike. Kolegji i shkallës së dytë konsideroi se Rregullorja e UNMIK-ut 2008/4 pranoi kompetencën e DhPGJS për të gjitha kërkesat e ngritura kundër një NP ose NSH-ve, pa marrë parasysh natyrën e tyre ligjore.⁷⁰

Kur të vendos mbi kërkesën e parashtruesit DhPGJS mund po ashtu të vlerësojë se çfarë është vlefshmëria ligjore e një vendim të mëparshëm të autoritetit administrativ, si dhe vlefshmëria e aktvendimeve apo aktgjykimeve të gjykatave, të cilat mund të kenë rëndësi

⁷⁰ Në bazë të nenit 4, para c) i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 Trupi Gjykoës i DhPGJS do të ketë kompetencë primare për kërkesat dhe kundërkërkesat, duke përfshirë kreditorin apo kërkesat pronësore të bëra kundër një ndërmarrje apo korporate që aktualisht apo paraprakisht është nën autoritetin administrativ të Agjencisë, ku kërkesat e tilla janë ngritur gjatë ose para kohës që ndërmarrja apo korporata e tillë është ose ishte subjekt i autoritetit administrativ të Agjencisë.

ligjore në çështje, duke përcaktuar shkallën e fuqisë ligjore të aktvendimit të mëparshëm. Kufizimi nga të ushtruarit e kompetencës mbi çështje si kjo në fjalë do të largonte ata që ishin subjekt i akteve të shpronësimit para vitit 1999, pa ndonjë mjet ligjor të duhur. Mund të supozohet se aktet e shpronësimit mund të kenë qenë të lidhur me diskriminimin para vitit 1999. Kjo duhet të shqyrtohet rast pas rasti dhe gjithashtu duhet të shqyrtohet, në qoftë se këta, prona e të cilëve ishte objekt i shpronësimit që nga atëherë kishte mjete të përshtatshme - brenda kornizës së ligjit të aplikueshëm atëherë - për të ngritur kundërshtimet e tyre kundër shpronësimit. Momentalisht, ligji i aplikueshëm në Kosovë nuk parashikon një mjet ligjor të duhur për të kundërshtuar ato shpronësime jashtë gjykatave të rregullta, duke përfshirë edhe DhPGJS.

Vendimi i trupit gjykues ishte hedhur poshtë dhe lënda është kthyer prapa për rigjykim.

Lënda ASC-09-0035, kushtet për lëshimin e një urdhri gjyqësore paraprak

Kjo lëndë ka të bëjë me kërkesën për një urdhër gjyqësore paraprak për të shmangur ndryshimet në pronësinë e të paditurit të parë (një NSH).

Shkalla e dytë është dashur të vendosë mbi çështjen nëse janë përmbushur kushtet për të lëshuar një urdhër gjyqësore paraprak dhe nëse ishte e nevojshme përfshirja e AKP-së si palë e pavarur dhe nëse jo, cilat janë pasojat ligjore të veprimeve procedurale të mëtejshme të AKP-së. Gjykata gjeti se në mënyrë që të jap një urdhër gjyqësor paraprak pala do të jap prova të besueshme që humbja e menjëhershme dhe e riparueshme apo dëmi do të rezultojë në rast se kërkesa nuk do të jepej. Këto kritere janë të vendosur në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga lart mungon kërkesa do të mohohet. Pasi që në lëndën në fjalë dëmi tashmë ka ndodhur nuk ka asnjë mënyrë që urdhri gjyqësor mund të jepet.

Gjithashtu u vendos që edhe pse i padituri i 2 (dytë) (AKP) nuk kishte *passiva legitimatio* në lidhje me kërkesën në procedurën kryesore, ai kishte të drejtë të parashtronte ankesë, pasi që ka vuajtur ankesën nga vendimi i kundërshtuar. Nuk ka asnjë arsytim të vlefshme ligjore për të thirrur AKP-në si i paditur shtesë në çdo padi në qoftë se kërkesa ka të bëjë vetëm me marrëdhëniet ligjore të një NSH-je me një person tjetër të

zakonshëm apo juridik, pasi që AKP-ja për shkak të mandatit të saj ‘vepron vetëm si një përfaqësues’, në këtë mënyrë në emër të NSH-ve në procedurën gjyqësore, e cila aspak nuk ka ndikim në legjitimitetin aktiv dhe / apo integritetin ligjor të NSH-ve. Kolegji e refuzoi kërkesën për të lëshuar një urdhër gjyqësor paraprak është refuzuar si të pabazuar dhe e konstatoi vendimin e Trupit Gjyqësor pa efekt ligjor për të thirrur AKP-në si *të paditur* të dytë në padi.

Lënda ASC-09-0091, kompetenca e DhPGJS për kërkesat lidhur me saktësinë e pjesës të të hyrave dhënë një punonjësi individual

Çështja e ngritur në këtë shembull ishte nëse DhPGJS ka kompetencë mbi shpërndarjen e duhur të 20% të fondit të privatizimit të një NSH-je të punësuarve të cilët tashmë kanë fituar të drejtën e marrjes të një pjesë të të hyrave.

Trupi Gjyqësor mohoj këtë çështje. Kolegji i Ankesave konstatoi se atëherë kur lënda ishte në pritje në Trupin Gjyqësor, në fuqi hyri Rregullorja e re e UNMIK-ut 2008 / 4. Neni 4.1 i saj përcakton se Trupi Gjyqësor i DhPGJS ka kompetencë primare për kërkesat ose kundërkërkesat në raport me kërkesat që përfshijnë një listë zyrtare të punonjësve të cilët kanë fituar të drejtën të një ndërmarrje të lëshuar nga Agjencia dhe të drejtën e punëtorëve sipas nenit 10 të Rregullores të ndryshuar të UNMIK 2003 / 13. Për më tepër, neni 67 i Urdhërësës Administrative 2të UNMIK-ut 2008 / 6 përmban, ndër të tjera, udhëzime të hollësishme se si të paraqitet një ankesë. Në bazë të nenit 67.6 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2008 / 6 ankesë duhet të përmbajë, përveç çështjeve të tjera, ‘baza të detajuar ligjore dhe faktike për të kërkuar përfshirjen në ose për të sfiduar listën e punëtorëve të cilat kanë fituar të drejtën të themeluar nga Agjencia ose shpërndarjen e fondeve nga xhirollogaria e dorëzuar të parashikuara në nenin 10 të Rregullores së UNMIK 2003/13.

Shpërndarja e pjesës së drejtë e të hyrave nga privatizimi i një NSH punonjësve individual, në bazë të Nenit 10 të Rregullores së UNMIK 2003/13, është një pjesë thelbësore e procedurës së privatizimit. Nga ligji nuk mund të konkludohet se në lidhje

me këtë pjesë të rëndësishme të procedurës së privatizimit, punëtorët nuk duhet të kenë mjete juridik kundër vendimeve të Agjencisë. Agjencia duhet të jetë subjekt i një mekanizmi kontrolli duke përfshirë një mjet juridik në gjykatë kur të llogaris pjesën e drejtë të të hyrave që do t'i shpërndahet punëtorit individual. Prandaj dispozitat e përmendura duhet të interpretohen në mënyrë që edhe ankesat, që kanë të bëjnë me çështjen e korrektësisë të pjesës të të hyrave dhënë një punonjësi individual, janë nën kompetencën e DhPGJS.

Lënda SCEL – 09-0005, barra e provës kur pretendohet diskriminim

Kjo lëndë ka të bëjë me çështjen e barrës së provës kur është pretenduar për diskriminim në një mosmarrëveshje lidhur me të drejtën e ish punëtorëve të një NSH për një pjesë të 20% të hyrave të privatizimit.

Kolegji i shkallës së parë gjeti se ankuesit [...] pohuan se ata kanë qenë të larguar nga puna në periudhën 1991-1999 në bazë të përkatësisë etnike shqiptarë të tyre nga Menaxhmenti i Masave të Përkohshme të vendosura në NSH. Prandaj ata kanë ngritur ankesën e tyre në DhPGJS në pajtim me nenin 10.6 të ndryshuar të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Neni 10.6 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 thotë: ‘Çdo ankesë e paraqitur në Dhomën e Posaçme mbi baza të diskriminimit, si arsye për të qenë i përjashtuar nga lista e punëtorëve të ligjshëm, duhet të shoqërohet me dëshmi të dokumentuara të diskriminimit të pohuar.’ Megjithatë, neni 8.1 i Ligjit kundër Diskriminimit 2004 / 3 shfuqizon barrën e provës, si vijon: ‘Kur personat të cilët e konsiderojnë vetën të shkelur për shkak se kundrejt tyre nuk është zbatuar parimi i trajtimit të barabartë, vërtetojnë para gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent, faktet nga të cilat mund të konsiderohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, atëherë i padituri duhet të provoj se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.’

Ligji nr. 2004 / 3 kundër Diskriminimit i datës 30 korrik 2004 që u miratua pas Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 ishte i zbatueshëm në këtë shembull.⁷¹ Kolegji i Ankesave të DhPGJS -së i është përgjigjur disa pyetjeve themelore për të krijuar kushtet për një gjykim të qëndrueshëm dhe të parashikuar të lëndëve që janë brenda kompetencës së DhPGJS. Ndërsa përballemi me shumë probleme të natyrës ligjore, politike dhe administrative, që nga përfshirja e EULEX-it në fillim të 2009, DhPGJS ka bërë përparim të konsiderueshëm duke sjellë rregullimin e gjykatës në Standardet Evropiane dhe Praktikatat më të mira Evropiane. DhPGJS rregullisht gjykon lëndë e po ashtu do të jetë në gjendje për të trajtuar numrin shumë të lartë të lëndëve aktuale dhe të ardhshme, sidomos lëndët e listës së punëtorëve.

Përfundim: arritjet dhe sfidat në të ardhmen

Ky raport tregon se 2010 ishte një vit sfidues dhe i dobishme për Njësinë e Gjyqtarëve e EULEX-it. Ka një numër të arritjeve që janë për tu theksuar. Procesimi i lëndëve penale të marra nga UNMIK-u është finalizuar në Gjykatën Supreme. Gjyqtarët e EULEX-it në rajonin e Mitrovicës morën përsipër dhe përfunduan një numër të lëndëve penale komplekse, ku shumë prej të pandehurve kanë qenë në paraburgim të zgjatur pasi që aktivitetet normale të Gjykatës ishin ndërprerë në mars të vitit 2008. Deri në fund të vitit 2010, në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës janë lëshuar 27 (njëzet e shtatë) aktgjykime.

Gjyqtarët e EULEX-it vazhduan të mbështesin dhe inkurajojnë gjyqtarët e Kosovës gjatë shqyrtimit të punës së akumuluar të rreth 22.000 ‘lëndëve të pazgjidhura’; - kërkesat për kompensim të paraqitura kundër Forcave të Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), Forcave të Kosovës (KFOR), Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe komunave vendore në 2004-2005, pas ndërhyrjes së NATO-s në 1999 dhe trazirave të marsit 2004. Si rezultat i vazhdueshëm i MUK –ut të gjyqtarëve të

⁷¹ Neni 11 i Ligjit kundër Diskriminimit 2004/3: “11.1 Kur ky ligj hyn në fuqi, ai shfuqizon të gjitha ligjet e mëparshme nga kjo fushë. 11.2. Dispozitat e legjislacionit të paraqitura ose në fuqi lidhur me mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë vlejnë ende dhe duhet të zbatohen nëse janë më të favorshme se dispozitat e këtij ligji.”

EULEX-it, tani ka filluar puna në 'lëndët e mbetura' në të gjitha gjykatat e Kosovës dhe më shumë se 1.500 lëndë janë përfunduar.

Në 2011, gjyqtarët e EULEX-it do të vazhdojnë të mbështesin gjyqësorin e Kosovës në arritjen e zbatimit efektiv të praktikave më të mira Evropiane dhe standardeve të njohura ndërkombëtarisht d.m.th: paanshmërinë dhe pavarësinë e gjyqësorit, reduktimin e rasteve të sjelljeve të pahijshme gjyqësore, përmirësimin e zbatimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në gjykimin e lëndëve civile dhe penale.

Në 2011, gjyqtarët e EULEX-it do të kryejnë funksionet e tyre ekzekutive në rajonin e Mitrovicës, me një fokus të veçantë në rastet e krimeve të rënda të cilat përfshijnë parburgimet e zgjatura. Në ushtrimin e funksioneve të tyre gjyqësore në gjykatat e Kosovës gjyqtarët e EULEX-it do të vazhdojnë tu japin përparësi gjykimeve të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë edhe lëndët e profilit të lartë.

Në 2010 gjyqtarëve të EULEX-it filluan me elaborimin e një strategjie të tranzicionit për të siguruar bartjen graduale të funksioneve ekzekutive të gjyqësori i Kosovës. Janë ndërmarrë hapa për ndryshimin e procedurës për caktimin e kolegjeve të përziera me qëllim për të siguruar angazhimin më aktiv të gjyqtarëve të Kosovës në bazë të nenit 3 paragrafi 7 të Ligjit mbi Kompetencat. Në kryerjen e funksioneve të tyre në vitin 2011 Gjyqtarët e EULEX-it do të vazhdojnë të bashkëpunojnë me kolegët e tyre vendor. Mekanizmi i nenit 3, paragrafi 7 i Ligjit mbi Kompetencat do të përdoret më tej për të rritur përfshirjen e gjyqtarëve të Kosovës në gjykimin e lëndëve, duke lehtësuar kështu dorëzimin gradual të kompetencave të gjyqësori i Kosovës.